

Fatmir Hysi, Helena Kadare, Robert Prendushi, Eno Koço, Namik Dokle, Blerina Shalari, Denis Bizhga, Gëzim Hoxha, Stefan Çapaliku, Armand Broshka, Jetmir Zaganjori flasin për simfoninë “Albanoi”

“Albanoi” e Vasil S. Toles, magjia e një simfonie thellësisht shqiptare

Përgatiti *Andreas Dushi*

Pas një përvojë të gjatë, kompozitori Vasil Sofokli Tole i ofroi publikut një simfoni me asht tërësisht shqiptar. Premiera botërore e “Albanoi” u luajt me datë 9 maj, 2025, në Ditën e Evropës, nga orkestra simfonike e Radio-Televizionit Shqiptar, nën drejtimin e Maestro Eno Koços.

SHËNIME MBI LIBRAT

Përmbledhja me novela “Porta e ngushtë e purgatorit” e shkrimtarit Besnik Mustafaj

Botët që përplasen

Nga *Arta Marku Qëndro* (fq. 6)

Shënime për romanin e Ndue Ukajt “Dritarja e Marin Shkrelit”, traktat prozaik për Kosovën e djeshme e të sotme

Nga *Elvi Sidheri* (fq. 7)

Romani “E zeza dhe e kuqja” i Mehmet Krajës

E zeza para së kuqes: një roman përtej historisë

Nga *Albana Beqiri* (fq. 8)

Studime letrare (të zgjedhura) të Anton Nikë Berishës në 10 vëllime

Botim shumëfish i rëndësishëm

Nga *Gjekë Gjonaj* (fq. 13)

Përkitazi ribotimi i veprës së Márquez-it Përsosmëria dhe magjia e thjeshtësisë në veprën “Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar”

Nga *Enver S. Morina* (fq. 18)




Përkujtohet në Prishtinë datëlindja e Ernest Koliqit

“Shêjzat” - monument kulture e atdhedashurie

Nga *Vehbi Miftari*

(fq. 12)

Më datë 20 maj 2025, në ambientet pranë katedrales “Nënë Tereza” në Prishtinë, te biblioteka që mban emrin e Ernest Koliqit, u përkujtua ditëlindja e këtij të fundit, në një aktivitet ku folën don Lush Gjergji, studiuesi dhe diplomati Vehbi Miftari si dhe, në emër të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Andreas Dushi. Me këtë rast, u realizua edhe aktiviteti i parë i përbashkët mes Bibliotekës Kombëtare dhe Bibliotekës “Ernest Koliqi”, pas nënshkrimit të një memorandumit mirëkuptimi pak ditë më parë.



Një histori e shkurtër e ilustrimit të librave

Nga *Chris Russell*

Përktheu *Jola Tasellari* (fq. 22)

Tri orët e paharruara në praninë e Virginia Woolf-it

Nga *Isaiah Berlin*



(fq. 16)

BIBLIOTEKË

Flurans Ilia (fq. 5)

Nën zërat e Babelit

Petro Çerkezi (fq. 14)

Itineraret e asgjëkundit

Ivan Bunin (fq. 20)

Pranverës, në Jude

Përktheu nga rusishtja: Kosta Nake

Yu Hua (fq. 21)

Histori dashurie

Përktheu nga anglishtja: Kadia Dedja

Arben Meksi (fq. 17)

Karikatura e së shtunës

Bobby Solo, *Elvis Presley italian* vjen në Tiranë së bashku me Marco Zappan

(fq. 9)

Konferenca “Arsimi Katolik në Trevat Shqiptare”

(fq. 15)

“Çështje shijeje” leximi apo paaftësie për të qënë i hapur ndaj ndryshimeve

Nga *Minella Aleksi*

(fq. 10)



Prof. Dr. Fatmir Hysi, Muzikolog

Pas një periudhe të gjatë stagnimi dhe dominimi të muzikës komerciale, arti simfonik — dhe simfonia në veçanti — po rikthehet me një gjallëri të re. Vepra më e fundit e Vasil S. Toles, simfonia ALBANOI, është një shembull mbresëlënës i këtij rilindjeje, duke e vendosur zhanrin në një dritë të re dhe bashkëkohore.

Simfonia të surprizon që në momentin e parë me tingujt e saj kompleksë dhe të papritur, si dhe me qartësinë e konceptit. Ajo digjet nga një zjarr i brendshëm, duke u frymëzuar nga dhe duke iu kushtuar kompozitorëve dhe figurave të rëndësishme kulturore. Megjithatë, ajo shkon përtej thjeshtë homazhit. Në vend që të ndjekë format tradicionale epike apo rrëfimore, ALBANOI sfidon audiencën të kalojë nga dëgjimi pasiv në përfshirje emocionale aktive — duke ftuar çdo dëgjues ta përjetojë muzikën si një udhëtim personal e bashkëkohor.

Forma e disiplinuar e simfonisë, gjuha e freskët harmonike — e ndërtuar në ndërthurjen midis teknikës profesionale të kompozimit dhe idiomave folklorike — dhe orkestracioni i kthjellët dhe kuptimplotë, i japin veprës një energji të gjallë dhe në zhvillim. Ngjyrat dhe teksturat e ndryshme timbrike shtojnë praninë dinamike dhe fuqinë shprehëse të saj.

Me ALBANOI-n, Vasil S. Tole hap një rrugë të re për muzikën simfonike shqiptare — një rrugë që përqafon traditën dhe risinë, dhe riafirmton simfoninë si një medium të gjallë të shprehjes artistike bashkëkohore.



Helena Kadare, shkrimtare

Simfonia “Albanoi” e kompozitorit të shquar Vasil Tole ishte një surprizë tejte e bukur për gjithë artëdashësit e muzikës klasike. E ndërtuar në katër kohë, ajo shtjellonte një udhëtim të tipareve të shqiptarëve të të gjitha kohërave, nga ilirët deri në ditët tona.

Salla e mrekullueshme e koncerteve në Katedralen Orthodhokse, ku u dha premiera, përcolli mrekullisht tek spektoret fatlumë gamën e fuqishme të tingujve muzikorë të kësaj simfonie, të interpretuar mjeshtërisht nga orkestra simfonike e RTSH, nën drejtimin e mjeshtër Eno Koço.

Mbrëmje artistike të këtij niveli, i vijnë jo shpesh publikut artëdashës të Tiranës. Ata morën me vete emocione të jashtëzakonshme plot dritë, që nuk do t'i harrojnë për një kohë të gjatë.

Fatmir Hysi, Helena Kadare, Robert Prendushi, Eno Koço, Namik Dokle, Blerina Shalari, Denis Bizhga, Gëzim Hoxha, Stefan Çapaliku, Armand Broshka, Jetmir Zaganjori flasin për simfoninë “Albanoi”

“ALBANOI” E VASIL S. TOLES, MAGJIA E NJË SIMFONIE THELLËSISHT SHQIPTARE

Përgatiti Andreas Dushi

Pas një përvojë të gjatë, kompozitori Vasil Sofokli Tole i ofroi publikut një simfoni me ashtë tërësisht shqiptar. Premiera botërore e “Albanoi” u lajt me datë 9 maj, 2025, në Ditën e Evropës, nga orkestra simfonike e Radio-Televizionit Shqiptar, nën drejtimin e Maestro Eno Koços.

Kjo orkestrë e themeluar më 16 maj të vitit 1962, rrënjët i ka, në fakt, në vitin 1938, kohë kur u krijua Radio Tirana dhe, pranë saj, u vendos një formacion orkestral që quhej Orkestra e Radio Tiranës, fillimisht nën dirigjimin e dirigjentit italian Umberto Rampi e pastaj, pas '44-ës, nën dirigjimin e Mustafa Krantjës, Bojan Adamiçit etj.

Krijues si Kristo Kono, Pjetër Dungu, Dhora Leka etj ishin ndër të parët që u interpretuan. Pas tyre orkestra simfonike e RTSH ka interpretuar krijimtarinë e pothuajse gjithë kompozitorëve shqiptarë prej At Martin Gjokës, At Fan S. Nolit, Murat Shehut, Çesk Zadejës, Tish Daisë, Tonin Harapit, Kozma Larës, Pjetër Gacit, Feim Ibrahimit, Limoz Dizdarit, Shpëtim Kushtës, Kujtim Laros, Thoma Gaqit, Hajg Zaharianit, Spartak Tilit, Gazmend Mullahit, Thomas Simakut, David Tukiqit, Josif Mingës, Zef Çobës, Aleksandër Peçit, Sokol Shupos, Ermir Dergjinit, Fatos Qerimit, Endri Sinës etj, e deri tek brezat më të rinj. Po ashtu krijimtarinë e krijuesve shqiptarë të Kosovës Rexho Mulliqi, Lorenc Antoni, Rauf Dhomi, Zeqirja Ballata, Fahri Beqiri etj.

Ndërkohë, për t'u rikthyer te premiera e “Albanoi”. Të pranishmit, mes të cilëve kisha fatin të jem edhe unë, shprehën konsideratën e tyre për këtë vepër të jashtëzakonshme, prandaj edhe vendosa që, nëpërmjet fjalëve të tyre, të tejçoja tek lexuesi i “ExLibris” një shije, sado të zbehtë, të kësaj ngjarjeje madhore jo vetëm në jetën e kompozitorit, por në vetë jetën artistike të botës shqiptare, brenda e përtej vetë Shqipërisë.

Një bisedë që pata fatin të zhvilloja me prof. Vason pak kohë më parë (ExLibris, nr. 304), e mbyllëm me fjalinë “Se si do të jetë kjo simfoni shqiptare e shek. XXI, besoj do të flasim përsëri, pas premierës së saj!” Dhe, meqë tani jemi përnjëmend pas premierës, po flasim për të, ama jo me kompozitorin, por me disa personalitete, të fushës ose jo, që e vlerësuan së tepërmi!

Prof. Robert Prendushi, muzikolog:

Urime, urime. Tashma kemi dhe një simfoni që flet me gjuhën e shekullit tonë. Konfrontimi, - venia ngjitur në një koncert me Shostakoviçin (kompozitor i madh i një vendi të madh), me Komp. Tole, kompozitor gjithnjë në rritje, ishte një guxim artistik që u përballue me sukses nga autori, dirigjenti dhe orkestra që e futi ndigjuesin shpejt në një botë të re. Arti ynë ka hy në Europë prej sa kohësh. Simfonia e V. S. Tole asht një tjetër dëshmi bindëse. Të përpiqemi që edhe publiku i gjanë të ndjekë gjithnjë e ma shumë. gjinitë e mëdha të muzikës. E kjo fillon nga shkolla.

Ju lumtë.



Maestro Eno Koço, dirigjenti i simfonisë “Albanoi”

“Albanoi”, është një simfoni me përmasa të mëdha, shkon tek 45 minuta, me kohë të fuqishme. Një vepër, që është udhëtimi i Shqipërisë në këto 2 mijë vjetët e fundit. Vërtet, që nga koha e hershme, se kështu është, është me katër kohë, me katër etapa: I.EPOS, II. ISO, III.KTHESA, IV. Heng

Dhe mbërrin në etapën e sotme. Ka gjendje të ndryshme emocionale; gjendja e kohës së I, shumëkush mund të thoshte ilirët, shqiptarët, arbërorët, pastaj dhe si transformohet dhe mbërrin tek koha e fundit që është shumë dinamike, e sotshme,



që është një aheng, le të themi, është një gjendje shpirtërore e lartësuar. Interpretimi mua më hap shumë punë se kam shumë punë për të bërë me Orkestrën dhe në çdo moment e kam mendjen që si u zgjidh kjo e ajo, por kemi fatin që kemi Blertën e kemi Vason që na mbështesin në këtë punë dhe do të bëjmë më të mirën.



Namik Dokle, shkrimtar, politikan

Në Tiranën tonë mund të ketë shumëçka, por koncertet sinfonike janë të rralla. Prandaj, kur të vjen një ftesë për një koncert të tillë, ndjen ngazëllim. Kështu më ndodhi edhe mua kur mora ftesën e kompozitorit Vaso Tole për të marrë pjesë në shfaqjen e Sinfonisë Nr. 1 të tij.

Ishte një kënaqësi e jashtëzakonshme. Shijua një muzikë serioze dhe shumë emocionuese, përjetuam disa nga momentet kulmore të historisë përmes tingujve të muzikës shumë të bukur, njëherësh edhe tronditëse të Vaso Toles... Rropama e luftës, alarmi dhe thirrja për liri, beteja të humbura dhe beteja të fituara, elegjitet epike për të rënë dhe lirizmi i jetës së përditëshme; tragjikja dhe heroikja, epikja dhe lirikja, të ndërthurura në mënyrë harmonike; të gjitha këto të shprehura me gjuhën e muzikës. Dhe të përcjellura aq bukur nga Orkestra Sinfonike e RTSH, e drejtuar me profesionalizëm të nivelit të lartë dhe pasion emocionues nga dirigjenti i shquar Eno Koço.

Në përfundim të shfaqjes thua me vete dhe me miqtë: Sa bukur! Dhe pyet: Pse kaq rrallë?!



Dr. Blerina Shalari, kompozitore, muzikologe

Kompozitori Vasil Tole zgjoi simfonizmin shqiptar, dhe pikërisht në ditën kuptimplotë të nëntë majit-2025. Përmes udhës së vështirë simfonike, një vepër e re arriti në katedralen “Ngjallja e Krishtit”, vend, i cili ka shuguruar shumë koncerte të vlëra këtyre anëve.

Një simfoni mbetet ngjarje për jetën e një vendi, sidomos kur ai gërryhet përbrenda nga pezulltira jo vetëm kulturore, e ka të nevojshëm një kat'harsis aristotelian, i cili mund të mbruhet e gatuhet hojësisht prej duarve bletore të kompozitorit, ashtu si në këtë rast me profesor Vasil Tolen.

Duke qenë se kompozitorët janë shpirta që e njohin kodin e njëri-tjetrit, nuk ka se si të mos e lexojnë veprën e një miku dhe

kolegu, i cili përmes saj, ndodh që të gjallon edhe ty vetë, e të jep flatra të ulesh e të shkruash frymëzimshëm.

Njëjtë ngjau edhe me simfoninë e kompozitorit Vasil Tole. Titulli i saj programatik “Albanoi”, është një dëshirë më tepër për ta dëgjuar me kërshëri, kjo sepse nuk e di pse, por si krijuese kam etje të shfrenuar për këtë fjalën Albania, Albani, Albanoi, si simfonia, nuk di sepse kam etje të pafund detin e motiveve vallësore shqiptare, të jugut e të veriut, të Tiranës e të Konispolit, dhe natyrshëm i dëgjoj dhe i ridëgjoj katër kohët e simfonisë “Albanoi”.

Në to gjej:-Katër-kohëshin klasik të simfonizmit, programatizmin muzikor që vjen në një të përgjithshme të grimcuar në përveçmëri brenda kohëve, dhe kështu ma behin hap pas hapi, episod pas episodi, tablo pas tabloje motivet atdhesore, vallësore, epike, labe, isojake, fluturake, si temperamentit shqiptaro-ballkanik, dhe me këto ngjyra tabloide, e përforcoj bindjen e një mozaiku kryeneç, të krijuar prej një dore që ka vite që shkruan muzikë.

Simfonia “Albanoi” e Vasil Toles, vjen e kuadratuar me katër-kohëshin ciklik, i cili për nga përmasat e orkestrës, e përballon karakterin simfonik. Njëjtë ndodh edhe me konceptimin kompozicional, ku shkrihen pa u ndjerë, sidomos në kohën e parë “Epos”, gjithë vlimet e motiveve kombëtare shqiptare, pa ndonjë veçanti të gjaktë melodike, por gjithsesi filozofike në shfaqjen e vet, sa konvencionale, po aq edhe universale.

Mund të pretendohet më tepër qartësim tematik, më dramatikisht shtrydhje emocionale të motiveve, të cilat do të nxirrnin në pah më tepër mjeshtëri të burimit krijues.

Koha e parë gjithashtu, mund të ishte më e shkurtër dhe më e prerë, sipas stofit të karakterit shqiptar, por ndoshta kjo mund të ketë ngjarë të zgjatet si ndonjë pasojë e brendshme e kompozitorit Tole, për t’i përngjarë ndoshta Malerit në pasqyrimet e tij të gjera në orkestër, gjë që justifikohet.

Koha e parë e simfonisë “Albanoi” përmbante efekte, ton psikologjik, ritme të njohura, por edhe poliritme. Mendoj se vlen të shkruajmë këtu se shkrimi formal mes temave, dhe parteve lidhëse dhe mbyllëse është diçka e vlerë, gjë që u duk në gjithë veprën.

Pra simfonia në këtë rast tenton bukur t’i largohet klisheve sonateske, të ndikuara ndonjëherë dhunshëm nga striktizmi i formave fanatike të shekullit të tetëmbëdhjetë. Jo formë për hir të formës, por formë për hir të veprës, për hir të mjeshtërisë krijuese.

Koha e dytë e simfonisë “Albanoi”, e quajtur “Iso”, është në fakt një eeee, moderne dhe jo siç e prisja, një eee tipike labe. Këtu kompozitori nuk ka rënë në kurthin e këngëve labe. Edhe sikur të binte, nuk do të ishte mëkat, por shijuesit duhet ta dinë se krijuesi, artisti nuk i tregon të gjithë sekretet. Mbetet diçka për ta zbuluar ai vetë, dëgjonjësi i sprovuar me filozofi tingullore.

Kjo iso, që e mban kohën e dytë të simfonisë në një “arratisje pengmarrëse”, e shtrydh vehten deri në pikën e vlimit, në këtë rast po shënojmë se vlen si shembull krijimi modelimi, isojak modern. Nëse do ta shkruaja unë këtë formë orkestrale me iso, pa frikë do t’jua kisha grabitur këngëve labe, qoftë atë, pra eee-në, qoftë harmoninë e atyre këngëve, që i bëjnë edhe malet të dridhen, por nuk është e tepërt ta pohojmë, se krijimtaria është edhe çështje subjektive, thellësisht individuale, ashtu siç u prir edhe në këtë rast për kompozitorin Vasil Tole.

Koha e tretë,- është një gërshetim burimor vallesh, prej hijes së ullirit të Bilbil Vlorës, që vazhdon tek kadencimet e valles së zileve, e deri tek gjetja shumë e bukur e sfondit të këmborëve të imituara nga perkusioni.

Mendojmë se kjo është koha më e arrirë



Dirigjenti Eno Koco dhe orkestra simfonike e RTSH, premiera boterore e simfonise ALBANOI, 9 maj 2025

e simfonisë, aty ku tema të grish me qartësinë, jo vetëm sepse është e njohur, por edhe sepse njerëzit kanë dëshirë, etje, ta gjejnë vehten këngërisht, edhe tek simfonitë. Sa më e këndueshme vepra, aq më jetëgjatë do të jetë. Kjo më ngjau me kohën e tretë, të vërtetën të simfonisë “Albanoi”.

Koha e katërt; e ul perden e rëndë të dritares simfonike, aty ku orkestra, edhe pa luajtur të detyron si krijues të ndjesh një përgjegjësi të madhe. Ke përpara 52 lojtarë, instrumentistë, aktorë, që duan nektar prej teje, që të mbijetojnë emocionalisht në skenë. Këtë pretendim e pati edhe koha e katërt e veprës “Albanoi”, por sa ia ka dalë, kjo i mbetet kohës.

Pata rast ta dëgjoj në dy versione këtë vepër, në sallë dhe e luajtur virtualisht, dhe kjo virtualja që diskutohet shpesh e goditet keq, nuk ma prishi sprovën që më duhet të kaloja përmes dëgjimit të mprehtë. Thuhet nën zë, se nëse vepra tingëllon, e “robotisur” prej kompiuterit, ajo e ka kaluar tashmë sprovën për në skenë.

Zhurmat për mua nuk janë moderne. Dizonancat e shfrenuara për mua nuk janë bashkëkohore. Në modë, bashkëkohore, është ajo vepër që të rri bukur në shpirt, njësoj si një aromë luksoze, mbi një veshje të denjë.

Githashtu, jemi të mendimit se do të gjenden mundësi të reja kërkimore të kompozitorit, këmbëngulja tek kërkimtaria në harmoni, sepse melosin, ne shqiptarët e gjejmë me tepri tek nektari i çdo krahine. Të gjithë krijuesit, si dhe kompozitori në fjalë, edhe në të ardhmen, nuk duhet të kenë drojë nga zhbirimi më i thellë i temave, të mos trembemi nga një kompleks i krijuar prej shkollës së kompozimit, sipas së cilët i duhet shmangur tonalitetit, se “na del i vjetëruar”, apo i duhet shmangur formës, se na “duhet novacioni”...

Me akademizëm muzikor, le të merren kryesisht teoricienët e muzikës, ose inxhinierët e akustikës. Plani krijues shpirtëror, idilik, pasional, pse jo, sakral, i takon vetëm kompozitorit, dhe ai duhet me patjetër ta përmbushë këtë mision.

Besojmë, se edhe në të ardhmen kompozitori Vasil Tole, do të tentojë përsëri të shkruajë simfoni, sepse është një barrë që mund ta përballojë si krijues, madje edhe ta tejkalojë me forma më demokratike, siç mund të jetë koncerti një kohësh për instrument e orkestër, ose rapsodia, ose muzikali apo sop-opera.

Vlera më e vërtetë e simfonisë “Albanoi” është se ajo foli shqipërisht.

Profesori i shumë brezave, Vasil Tole, me këtë vepër na dha kurajon, se të shkruash simfoni, nuk është një mision i pamundur, edhe pse na duhet të kalojmë shpirtërisht, por edhe trupërisht, përmes kalvarit të Golgotës së krijimit!



Dr. Denis Bizhga, muzikolog

Në datë 9 maj, nga Orkestra Simfonike e Radio Televizionit Shqiptar, u vu në skenë premiera botërore e simfonisë “Albanoi” e kompozitorit Vasil S. Tole, nën drejtimin e dirigjentit të njohur Eno Koço. Në këtë ditë të shënuar, që përkon me themelimin e Bashkimit Europian, Prof. Tole i dhuroi publikut artdashes, si dhe repertorit te muzikës së kultivuar shqiptare, një vepër të përmasave të mëdha. Në fjalën hyrëse Maestro Eno Koço e vlerësoi veprën si monumentale për nga aspekti kompozicional duke cilësuar rëndësinë që krijime të tilla mbartin. Simfonia “Albanoi” ishte ndërtuar në katër kohë, të cilat krijojnë një strukturë të mirëmeneduar. Përkatesisht ato quheshin: Epos, Iso, Kthesa dhe Heng. Ishin një përgjithësim i tipareve dhe gjuhës muzikore shqiptare. Secila kohë i dedikohej disa personaliteteve të artit dhe kulturës shqiptare. Koha e parë i dedikohej shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare.

Koha e dytë i dedikohet profesorit Gjerman, Wolfgang Hufschmidt. Koha e tretë i dedikohet Maestros Eno Koco dhe koha e katërt i dedikohet Prof. Çesk Zadesë. Salla e qendrës kulturore të Katedrales Ortodokse ishte e tejmbushur me një publik të kultivuar vendas dhe të huaj, të cilët prisnin me interes premierën e mbrëmjes. Vepra, nga aspekti kompozicional, ishte shkrim bashkëkohor i mbështetur në idioma folklorike ku shpeshherë evidentohet timbrika epike nga harqet dhe formacionet e tunxhit.

Autori shprehte disa momente solistike me instrumentet e violincelit dhe fagotit, si për t’i dhënë një ngjyrim emocional dhe komunikues veprës. Sigurisht që zhanri i simfonisë është një nga më të vështirët në krijimtarinë e një kompozitori, sepse ka kompleksitet në shkrimin muzikor, por duhet thënë që simfonia “Albanoi” është vepër e një niveli europian me karakter dhe formë. Kjo simfoni shfaq dëshirën për të forcuar identitetin kombëtar dhe për të glorifikuar historinë dhe kulturën shqiptare, si një homazh i fuqishëm për vendin dhe popullin tonë. Simfonia “Albanoi” është jo vetëm një vepër artistike, por edhe një mesazh shpresëdhënës për brezat e ardhshëm, duke kujtuar rëndësinë e ruajtjes së identitetit tonë kombëtar përmes artit dhe muzikës. Kjo pjesë është një dëshmi e përkushtimit të kompozitorit Vasil S. Tole ndaj kulturës shqiptare dhe një thirrje për përbashkim dhe ruajtje të vlerave tradicionale. Me një strukturë të guximshme dhe dinamikë të veçantë, “Albanoi” përçon emocione të thella patriotike, duke përdorur orkestër të gjerë dhe motive melankolike e të ngazëllyera. Prof. Vasil S. Tole e ka ndërtuar këtë vepër me dashuri dhe pasion, duke shprehur krenarinë dhe unitetin kombëtar nëpërmjet muzikës instrumentale.

Akademik Gëzim Hoxha, Kryetar i Sesionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, Akademia e Shkencave

Vepra muzikore simfonike “Albanoi” ishte tërheqëse për mua që nga titulli simbolik i saj që të drejtonte menjëherë drejt rrënjëve historike.

Nuk kisha gabuar. Tingujt e harmonizuar të pjesës Epos të fusnin në fantazinë e thellë të fillimeve historike. Pjesa “Iso” formëson



me tinguj avancimin drejt formacioneve antike.

Vazhdimi me “Kthesa-Valle” është një frymëzim që përputhet me “Rilindjen Ilire” dhe kristalizimin e një bashkësie etnike kompakte me gjuhë, territor, tradita, zakone, folklor dhe muzikë.

Kurorëzimi i simfonisë me kohën e katërt “Heng-Finale” shënon kulmin e një vepre muzikore të mbështetur fort në histori.

Ekzekutimi profesional i kësaj simfonie të V. Toles nga instrumentistët virtuozë të drejtuar nga dirigjenti ynë i dashur Eno Koço, më dha një kënaqësi të veçantë shpirtërore, një ndjenjë të veçantë estetike dhe një lesim ndryshe të historisë “Albanoi” nëpërmjet një vepre shumë të denjë muzikore.



Akademik Stefan Çapaliku,
shkrimtar, dramaturg, Drejtor i
Qendrës së Studimit të Arteve

Shkrimi një simfonie duhet konsideruar si një ngjarje e madhe kulturore dhe ekzekutimi i saj edhe më e madhe.

Rasti i simfonisë së parë të kompozitorit të mirënjohur Vasil Tole është një shenjë e fortë se muzika serioze shqiptare nuk ka vdekë. Ajo është një yll shprese në qiellin e botës muzikore, që ecën denjësisht në gjurmët më të mira të profesorit të vet Çesk Zadeja.

Ekzekutimi i saj prej filarmonisë së shtetit ndën drejtimin e maestro Eno Koços më nxori mallin e kohës kur muzika serioze shqiptare kishte stinët e veta të begata dhe më dha shpresë se një eksperiencë e tillë mund të rifillojë në dritën e estetikave të reja.



Armand Broshka, instrumentist

Simfonia “Albanoi” me katër kohë e kompozitorit Vasil Tole erdhi me një simbolikë të fortë më 9 maj, në ditën e Europës!

Njësoj si arkeologët, historianët dhe gjuhëtarët tanë, në faktet e tyre mbi vazhdimësinë iliro-arbërore-shqiptare të popullit tonë, na kanë renditur mes fjalëve të shumta indo-evropiane shqipe edhe fjalët latine, greke, kelte, slave e osmane, të këtyre perandorive e dyndjeve të mëdha të popujve që kanë shkelur në trojet tona, si fakt i pakundërshtueshëm që ne kemi qenë e vazhdojmë të jemi këtu, po ashtu edhe kompozitori Vasil Tole na rendit si një etno-



Dirigjenti Eno Koco i drejtohet spektatoreve para interpretimit të simfonisë ALBANOI, 9 maj 2025

muzikolog hap pas hapi në të katërta kohët e simfonisë së tij, karakteristikat muzikore e folklorike të popullit shqiptar, si p.r.sh “Iso”-n, “Polifoni”-në apo septimën e vogël, e cila simbolizon vajtimin apo mallin dhe është kaq unike e identitare në popullin tonë. Gjithashtu kompozitori udhëton me tinguj nga kohët e lashta deri në ditët e sotme, duke na renditur si fakte të lashtësisë dhe vazhdimësisë kulturore iliro-arbërore-shqiptare, sistemet modale e tonale të shkallëve specifike muzikore, të gjymta apo të plota, duke nisur nga “Pentatonika” e lashtë, “Diatonika” mesjetare, “Hixhaz” osman, e deri tek “Dodekafonizmi” modern. Fakte muzikore këto po aq të forta e të ngjashme si ato të arkeologëve, historianëve e gjuhëtarëve, të cilat na tregojnë hap pas hapi rrugëtimin kulturor të “Albanoi”-ve nga errësira në dritë, nga vajtimi (dhimbja) në gëzim.

Kohën e parë kompozitori Tole e quan “Epos” dhe ia dedikon shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare. Ky dedikim vjen si një simbiozë midis Kadaresë dhe eposit shqiptar nga ku ai është frymëzuar për të shkruar të gjitha veprat e tij të mëdha të cilat i ndërthur me mitologjitë e përbashkëta të popujve antikë të këtij gadishulli, për të na treguar ne edhe botës se ky popull i vogël në mes të Europës nuk ka ardhur deri në ditët e sotme si një rastësi, por si një bashkëudhëtar i moçëm i qytetërimeve të vjetra evropiane. Gjuha muzikore në këtë kohë është e thjeshtë por heroike, duke i përngjarë “monodisë” si për të na treguar zanafillën, veriun, aty nga ku rrënojat e ashpra të Zgërdheshit na dëshmojnë jetesën e ashpër të kohërave antike nga ku gegët këndojnë edhe sot e kësaj dite në mënyrë monodike eposin e tyre.

Koha e dytë quhet “Iso”. Në këtë kohë dallohet menjëherë jugu, polifonia e shoqëruar me iso dhe vajtimi i cili vjen nëpërmjet septimës së vogël (“lamentit”), karakteristikë e këndimit toskë dhe glisandove të vazhdueshme tek harqet. Kjo gjendje bën që koha e dytë të ketë një tonalitë të theksuar minor e disi dramatik, sikur do të na tregojë se po kalojmë në kohë të vështira, nga lashtësia në mesjetë, aty ku identiteti i Albanoive nis e merr formë të fortë identitare. Rastësi apo e bërë qellimisht, kompozitori këtë kohë ia dedikon profesorit të tij gjerman Eolfgang Hufschmidt, si për të luajtur me simbolikën e polifonisë, e cila në muzikën serioze klasike pasohet nga profesorët tek studentët

si pjesë shumë e rëndësishme e kurrikulave të çdo akademie muzikore në botë, e ku majat e perfeksionimit të saj i përkasin një tjetër gjermani, Johann Sebastian Bach.

Koha e tretë titullohet “Kthesa-Valle”. Në këtë kohë ndjehet ndryshimi i tonaliteteve, nga minore në mazhore, pra nisim të dalim nga dhimbja e të shkojmë në hare, gëzim. Këtë kohë kompozitori ia dedikon maestros Eno Koço (Nderi i kombit). Edhe këtu kompozitori luan me simbolikat, duke qenë se origjina e tij toske përmetare është e njëjtë me atë të nënës së maestros, sopranoja e shquar shqiptare Tefta Tashko Koço, e cila rridhte nga një familje përmetare me origjinë nga Frashëri. Kur bën këtë lidhje dhe dëgjon kohën e tretë, dëgjuesi profesionist por edhe i thjeshtë menjëherë shquan shkallën e pentatonikës, karakteristikë kjo e kombeve të vjetra, e cila vjen nëpërmjet tipologjisë së valles “Pogonishte” të ndërthurur hera-herës edhe me iso. Këto valle kanë një karakter të hareshëm por që nuk janë as në tonalitete minore e as në ato mazhore, pikërisht ashtu siç nis “kthesa” historike, gradualisht!

Koha e katërt titullohet “Heng-Finale” dhe i dedikohet kompozitorit tonë më shquar të shek.XX, Çesk Zadeja (Artist i popullit). Në këtë kohë ndjehet hareja, ahengu. Kompozitori Tole në këtë kohë përdor një gjuhë muzikore karakteristike orientale të makamit “Hixhaz”, me copëza fuge me ornamente të këngës popullore qytetare tironse “Lake pupulake”. Këto copëza të shpejta e të fuqishme fugale ngjasojnë disi me ato kërcime të Sheherzades në përpjekjet për të shpëtuar jetën e saj nga princi, paralelizëm ky i shqiptarëve ndaj perandorisë osmane. Më pas vjen drita, gëzimi, ku gjuha harmonike e melodike ndryshon duke u futur në modernitet (“Dodekafonizëm”), si ribashkim pas shumë motesh i ilirëve Albanoi me Europën.

Si pjesëtar i Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar, kryesisht violinave të para në premierën e kësaj simfonie, mund të them se vështirësitë teknike që hasëm ishin sfidante për ne, sepse kompozitori përdor një shkrim të ngjeshur që i përket gjuhës bashkëkohore muzikore, plot me figura ritmike, pasazhe të shpejta e kapërcime të befta, të cilat të përfshira shpesh herë edhe në poliritëm bënin që vëmendja dhe predispozita e çdo instrumentisti të ishte e lartë e të përfshiheshin në muzikë nga fillimi e deri

në përfundim të saj. Natyrisht që këtyre sfidave u shtohet edhe faktori premierë i veprës së re e të padëgjuar më parë, e megjithatë, instrumentistët profesionistë të orkestrës sonë u impenjuan maksimalisht që kjo simfoni të merrte formën e saj përfundimtare, atë formë që shpesh herë kompozitori Vasil Tole, i ulur në pianon e sallës “Ferdinand Deda” me partiturën përpara, na e konfirmonte me buzëqeshje dhe aprovim çdo ditë e më shumë. Në ditët e sotme, në një botë teknologjike që nxiton në çdo drejtim e që konsumi e krijimi i shpejtë “fast” duket sikur mbizotëron kudo, është sfidë më vete gjetja e kohës, durimi dhe krijimi i veprave të mëdha siç janë simfonitë, akoma edhe më tepër kur ato kanë karakter kombëtar. Kjo gjini muzikore kërkon shumë orë pune dhe bagazh profesional, duke i shtuar këtyre gjithashtu edhe mbështetjen shpirtërore e kryesisht incentivat, porositjet (komisionimet) e shpërblimet financiare në mënyrë që vepra të tilla të mëdha t’i shtohen skenës serioze shqiptare. Gjithsesi, kompozitori Vasil Tole ia doli edhe këtë herë të sjellë një vepër tjetër të madhe në repertorin shqiptar e që u duartrokit fort nga publiku në sallën e mbushur plot të Katedrales Orthodoxke, gjë që e ka dëshmuar edhe në të shkuarën e afërt me operan solemne “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu kryezot i Arbërit” dhe koncertin për violinë dhe orkestrë simfonike, duke dëshmuar se mbetet një krijues aktiv i skenës serioze shqiptar.

Jetmir Zaganjori, kompozitor

Më 9 maj, në Ditën e Europës, në sallën madhështore të Kishës Ortodokse në Tiranë, Orkestra e Radio Televizionit Shqiptar solli një program të veçantë, duke përfshirë Koncertin Nr. 2 për Piano dhe Orkestrë të Dmitri Shostakoviçit dhe premierën e shumëpritur të simfonisë “Albanoi,” një vepër monumentale nga akademiku dhe kompozitori i njohur shqiptar Vasil S. Tole.

Pas më shumë se dy vite pune intensive me emocion, profesor Tole dhe Orkestra e RTSH-së sollën në jetë këtë simfoninë në katër kohë, ku klasikja dhe modernja bashkohen në një rrjedhë muzikore të përpunuar me mjeshtëri. Në këtë vepër, profesor Tole ka ndërthurur formën klasike të simfonisë me elemente të muzikës tradicionale shqiptare, duke krijuar një gjuhë muzikore ku notat flasin shqip. Vepra

është dedikuar personaliteteve kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë pasur një ndikim të veçantë në rrugëtimin artistik të kompozitorit.

Koha e parë, “Epos,” është një homazh dhe dedikim për shkrimtarin e mirënjohur Ismail Kadare, e ndërtuar në formën klasike të sonatës, ku janë të shprehura qartë dhe dy temat. Ajo nis me një hyrje të furishme, ku orkestra luan në fortissimo (FF), duke krijuar një peizazh muzikor të fuqishëm dhe dramatik, të ndërtuar mbi motive të muzikës tradicionale të veriut të Shqipërisë, siç dhe emërtohet “Epos.” Është një mjeshtëri kompozicionale dhe orkestrale, ku ngjyrat e larmishme dhe shpërndarja e tingullit në të gjithë diapazonin orkestral i japin kësaj kohe një dimension të veçantë. Këtë e shohim më qartë tek soloja e cellos (në minutën e 6-të të veprës), ku kemi një ndërtim tematik të thelluar dhe një moment kontrastues brenda kësaj kohe, duke e bërë muzikën të depërtojë qartë dhe fuqishëm në çdo detaj të saj.

Koha e dytë, “Iso,” i dedikohet profesor Ëolfgang Hufschmidt, një figurë që la gjurmë në formimin muzikor të kompozitorit gjatë studimeve në Gjermani. Është një kohë më e shtruar (Largo), ku, siç e ka emërtuar dhe autori, “Iso” jep një peizazh dhe një ndjesi të gjallë të isos shqiptare. Elementet folklorike zënë një vend të rëndësishëm në ndërtimin e saj harmonik dhe kompozicional, duke krijuar një atmosferë që përçon qartësisht frymën e muzikës tradicionale.

Koha e tretë është një nderim për maestro Eno Koço, i cili gjithashtu drejtoi orkestrën gjatë kësaj premiere. Siç e quan dhe profesor Tole këtë kohë, “Kthesa-Valle,” është ndërtuar si një valle simfonike, ku elementet e muzikës tradicionale shqiptare janë të shkrira dhe ndjehen qartazi në çdo moment. Me një fillim energjik në instrumentin e timpanit dhe me pizzicato-t në harqe, që duke u shkrirë së bashku krijojnë një ndjesi ritmike që evokon instrumentet folklorike, kjo kohë shfaq një shkrirje të suksesshme të simfonizimit dhe muzikës tradicionale shqiptare. Elementet tematike ndihen qartë edhe në instrumentet e drunjt, duke krijuar një strukturë të gjallë dhe elektrizuese nga nota e parë deri në të fundit.

Koha e katërt, një finale monumentale, është një dedikim për Çesk Zadejën, të quajtur “profesori i profesorëve” ose ndryshe “babai i muzikës shqiptare,” siç shkruan edhe Akademik Tole në librin e tij “Çesk Zadeja, Jeta dhe Vepra.” Kjo kohë fillon me një tutti të orkestrës dhe zhvillohet në formë pyetje-përgjigje mes seksioneve orkestrale. Duke ndërthurr muzikën tradicionale shqiptare, veçanërisht modet tradicionale, me strukturën klasike, kjo kohë kulmon me një tutti të fuqishëm që përfaqëson një shpërthim emocional dhe muzikor, duke i dhënë veprës një përfundim dramatik dhe një homazh të thellë ndaj figurës së Çesk Zadejës.

Kjo simfoni e shkruar nga Akademiku Tole është një vepër që flet shqip – një trashëgimi e gjallë e muzikës tradicionale dhe simfonike shqiptare, një dialog i fuqishëm mes së shkuarës dhe së tashmes muzikore.



MANTEL MËNDAFSHI

(Prolog)

epet kënga krimb pa flatra
flutur nate ligjërimi vatra
tretet ngadalë larvë pa fjalë

me fjalën frutë frutën farë
avlëmend rrugësh vargu lopçar
dëshmi hapur fijos së fatit
punon vërdatka mëndafshit

fabula fluturës metaforë fekonduar
princ mbret kurorë kurorëzuar
fron i drunjtë kurorëzimi tij
gdhend ngujon kryqëzon histori

planimetria e gjuhës së rrashtë
makiavelizëm i mëndafshhtë
më tej të gjithë e dimë historinë
se si mëndafshi e veshi njerëzinë

MBI QIPARISIN E VJETËR

atje tej te lugina pema përbri
qiparisi i qiellit mbart një kumri
dëgjoje si këndon një ulli i vjetër
lëvozhgën e zhveshur të një bote tjetër

platitur zhegut varg mbi mermer
tingujt e kumrisë hapin një derë
veshur me gjethnajë e shkurre ishte
mbi varre të harruar bri një ullishte

kaq shumë, kaq shumë platitur mbi rasë
të parë e ke qiellin nga tjetër përmasë
rreth malit diejve shtrohet toka përbri
një lum vjen e buron nga gjoksi i tij

hapat i tut e stepet bregut tjetër
asaj çka e quajmë ajme! kohë e vjetër
fillon e gjembon dhimbja e gishtave
si fjalë e çapuar mes shkurre ishte

dregëzat i hap me duar përgjakur
malli përndeuzur përqaftimi përflakur
te kjo varrezë e vjetër nën qiparis
kumria me tinguj një prekje qëndis

dhe lumi vazhdon përqaftimin tjetër
në det derdhet prej kohës së vjetër
rikthehet si fllad te pemët përbri
qiparisi i qiejve mbart një kumri

kumt qiri i ndezur mbi mermer
kjo cigare, e di, duhet ta lësh njëherë
ashtu si i le qytetet, ullinjtë, varrezat,
shkëmbëve me tjetër kumt dorezat

fatit i dole kur u shfaq përball’
fati nuk ishte fat por ishte çakall
zbritur nga ai mal ku dielli teporet
nga djemtë e vrarë lindën shtatoret

varreve të reja te kjo qytezë kjo varrezë
koha përzhitur zhegut nën diell përndeuz
planimetrinë e rrugicave të një qyteti tjetër
këndon një kumri mbi qiparisin e vjetër

I HUMBA SYZET LAURA

(Rerum vulgarium fragmenta)

shpagar shtjellë yjeve
mantel forma e trupit
gji gjineshtrash pyjeve
shparcë shprese bri supit

pas shejzave (Petrarka) i kapur
fija e fatit balonë e blatur
rimës së vargut aurorë hapur
supit zhveshur fjala kryqëzuar



Flurans Ilia Nën zërat e Babelit

ujëvarë gurgull nishanesh rrëzuar
diell pigmentesh veshur me vrik
një rrugë fiorentine syshkruar
pasqyra e kalldrëmit mbi qerpik

i humba syzet Laura, nuk të shoh
sërish shfaqesh në Këngët kurorë
buzë Arno-s i verbër në moh
mbi degë dafinash ti je aurorë

asgjë nga këto nuk do kishte kuptim
po qe se vera e bukur në asht të ikjes
gjoksit tënd frutë do i jepte lulëzim
aktit të vjeshtës me farat e pritjes

thinjesh pluhurit qytetërimit zhytur
mpakur si drita frëngjive të ngushta
veshur me mëndafsh të zbutur
trokthi i dinastive të vyshkëta

Canzoniere gjurmëve të gjumit
si fija e fatit balonë e blatur
dy petale fshehur poshtë kurmit
pesëqind vite rilindje kalëruar

aty ku Petrarka i kapur ka ngelur
aty ku fjala e hapur pat filluar
aty te fundi i verës së shkuar
fara e pritjes vjeshtë e trazuar

këndojnë bri teje shikime kumrish
pesëqind vite pritje ke duruar
i humba syzet Laura, kam frikë
si fija e brishtë e balonës në duar

SI PIKA E RËNË MBI FLETË

statuja poshtë shputave nën dhe
mbi re - syri i saj i gjallë si ne
spërk syprinën e supeve prej lëkure
buzë udhës shikimet çelin bozhure

duar prerë duar gjymtuar duar thyer
duar zgjatuar drejt qiellit ngërthyer
humbur filli i gjykimit të fjalëve tona
këngës së bombave vrik bie jehona

supit mbyllet kilometri i pesëdhjetë
zëri shuhet si pika e rënë mbi fletë
subjektin e krimeve të dhe pa njohura
mure dimri dëshmitë tash të ftohura

pellgjeve të ngrira retinë kthehet pasqyra
bozhure sy-bukura bozhure si dikur te ura
lumi rrjedh dhe shkronjave gurgull u flet
përkundjes si këngë zhveshur përmbi det

të kujtohet mermer nga toka e dalë statuja
për dore kapur mbi ideale gra dhe burra
panteonit të ëndrrave ku perënditet hëna
“Dora e artistit” - kishte thënë dikur nëna

fëmijët dheut kaptuar me koka mbi re
qytetërim varrosur kjo statujë dhe ne
këllqe mbajnë mbi shpatulla kultura
prerë nga bombat poshtë këmbëve te ura

NËN ZËRAT E BABELIT

Ata kërkojnë uniformën
E ushtarit të panjohur
Pasi Paqja u nënshkrua
Në mungesë të trupit

Kërkojnë lugën bishtshkurtër
Logo-n e vakët krahaqafë
Pas murit të çmëdinës
Nën zërat e Babelit

Jashtëtokësorë unanimë
Togëzuar te porta e klikimeve
Pëlqimeve pasi e kryejnë
Me njerzillëk krimin

Mbi lëkurën e brishtë
Të vëllait a motrës së mitur
Që kur lindi refuzoi
Të lind “ashtu si duhet”

Ngjizur opiumit të televizitorit
Kërkojnë të singjashmin e vet
Njëfarë hero i hollivudian drite
Udhëtimeve drejt Bethlehem-it

Me celuloid në dorë
Rreth ekranit bërë kurorë
Shpik përditë të ardhme
Të tashme të pakuptimtë

Ku burri dhe gruaja janë arte
Të së shkuarës qyshkur
Mes tyre zbriti celulari
(Ça je t-u thonë o rrotë k.i?)

Po përpiqem të jap një dorë
Të gjesh vëllain tënd
Këtë “ushtar të panjohur”
Pas kangjellave të Babilonit

Krehur nga motrat e tranzicionit
Kërkojnë me ngulm lugën pa bisht
Harruar në xhepin e uniformës
Si të ishte një karafil i kuq

Vepër arti a ndoshta plagë
Në sepetet e virgjërisë
Sëndukut të rrëfimit, mbyllur
Gjyshja mbartte ftonjtë e artë

VËSHTRIMI GJENETIK I QYTETËRIMEVE

(Epilog)

Ajo nuk është gota jote e sotme
as qelq as vështrim as vitrinë
është zgimi yt
sikur ti zgjatimi i saj
brenda një
“Indicazione geografica tipica”
shkruar te shishja vendi
ku dashuria
mbyllur në qelën e gjuhës
me aktin e puthjes flijimi i buzëve
zgjon diellin e breznive
të vdekurve e të lindurve
që rritën
hapat e tua nga frutat e ndaluara
vështrimi gjenetik i qytetërimeve

Dyert e kopshtit zoologjik hapen por vetëm disa prej kafshëve shtyhen të dalin jashtë. Nuk shkojnë larg gjithsesi, rrotullohen nëpër rruginat e kopshtit dhe sërish, shumë shpejt, kthehen në kafazet e tyre...

Pak a shumë kështu më vjen në kujtesë një skenë nga libri “Bota sipas Garpit” i John Irving (Pegi 2016; përkth. D. Çuli), që dëshmon për ndikimin reflekseve të kushtëzuara, dhe vështirësinë e çlirimit prej tyre. Fundja bota jashtë kafazit është një botë e panjohur, për pasojë zor të orientohesh në të. Ndërsa bota brenda kafazit, një botë që të ka përkthyer për një kohë të gjatë, të ka formuar duke të treguar shtigjet orientuese brenda saj. Ka qenë një botë e ngushtë, sigurisht, por a nuk mësohesh gjithnjë t’i shtrish këmbët sa ke jorganin?

Në ujëra të ngjashme noton Besnik Mustafaj në librin “Porta e ngushtë e purgatorit” (Onufri, 2024). Në novelën e parë e të tretë, “Zbulimi i Amerikës nga shqiptarët” dhe “Zbulimi i Parisit nga shqiptarët”, këta të fundit, shqiptarët pra, përballen me botën jashtë kafazit të tyre që ka qenë i kyçur deri në vitin 1991. Bota jashtë është e madhe, e hapur, e ndërlukuar. Në krye të herës nuk ia kupton dot mekanizmat sepse je formuar brenda një bote krejt të ndryshme: të ngushtë, shtypur nga diktatura dhe mendësia anakronike, me disa rregulla që të janë ngurtësuar përbrenda. Shqiptarët e këtij libri mu dukën mu si statuja allçie. Lënda në fillim ka qenë e lëngshme (enkas) por pasi është derdhur në një kallëp të paracaktuar, ka ngrirë dhe jo vetëm ka marrë formën e imponuar por nuk të lejon mundësi tjetërsimi. Ndryshimet, tani mund të bëhen, pra e drejta ekziston, por janë invazive, për pasojë të dhimbshme, gjithsesi sipërfaqësore. Nëse do të shkosh thellë sipërfaqes duhet kohë, shumë kohë dhe një mund i madh i cili në fillim fare është çoroditës.

Shqiptarët në botën e madhe

Le të hyjmë në hollësi më konkrete:

Alush Bello quhet personazhi e novelës “Zbulimi i Amerikës nga shqiptarët” i cili ka emigruar përtej oqeanit. Sa kohë jetonte në Shqipëri, dhe ka qenë një kohë e gjatë, “për fat ai nuk kishte marrë kurrë ndonjë ftesë e as ndonjë urdhër nga sigurimi për të bashkëpunuar. Gjatë këtyre viteve të lirisë [...] ai kishte pyetur veten shpesh, me njëfarë çudie dhe lehtësimi, se pse kishte shpëtuar, për më tepër pa asnjë përpjekje, prej këtij çarku të lemerishëm. Nuk gjente shpjegim tjetër të arsyeshëm veç fatit. Por, edhe ky shpjegim binte duke sjellë parasysh rrethanat e Shqipërisë së asaj kohe. Sigurimi nuk linte vend për rastësinë hyjnore”.


Ky është, pra, një aspekt i së shkuarës së një shqiptari që pat jetuar në Vlorë dhe pat punuar për një kohë të gjatë si mësues e më pas si drejtor i bibliotekës së qytetit. Politikën s’e kish qasur, madje pa asnjë sens protagonizmi, kur e patën emëruar drejtor biblioteke, nuk i kishte shkuar ndërmend as të shprehte mirënjohje. Fundja nuk e kishte kërkuar një gjë të tillë.

Kohët ndryshojnë, përmbysen dhe Alush Bello kurrë rrugën, dikur as një ëndërr, për në Amerikë. Çfarë bën atje? A e ka gjetur veten? A e ka ndihmuar pasioni i tij, adhurimi për letërsinë amerikane? Mos vallë ia kanë shtruar rrugën shkrimtarët amerikanë që i kish përkthyer në gjuhën shqipe? Gjithsesi, përvoja që kishte, puna si drejtues biblioteke, angazhimi i gjatë në mësimdhënie, njohja e mirë e anglishtes dhe e letërsisë amerikane iu shfaqën si një dritë e ndezur, për një çast: iu paraqit mundësia të fillonte punë në një ndër kolegjet më në zë të qytetit. Por sigurisht, më parë duhej t’i nënshtrohej një testi që

Përmbledhja me novela “Porta e ngushtë e purgatorit” e shkrimtarit Besnik Mustafaj

Botët që përplasen

Nga Art Marku Qëndro



do ta vlerësonte përshtatshmërinë e tij për atë vend pune.

Dhe ja tek gjendet Alush Bello përpara kompjuterit në ekranin e të cilit do të shfaqen pyetjet e njëpasnjëshme të pyetësorit. E para: “Ju jeni...” dhe në vijim 5 emra burrash si alternativa për të zgjedhur, mes tyre vetë emri i Alush Bellos.

Këtu zë fill befasia. Ngrënë krye dilemat e njëpasnjëshme mbi domethënien e një pyetjeje të tillë, absurde. Këtu buis dyshimi se mos diçka që nuk duket fshihet pas asaj që duket. Se diçka me siguri fshihet, diçka duhet të jetë duke u inskenuar, përndryshe pse një pyetje e tillë?! Për ta vënë në lojë? Për ta poshtëruar? Nëse është kështu, nga kush?! Më shumë të ngjarë kishte që Alush Bello të gjendej përballë një komploti të fshehur me kujdes, padyshim, nga FBI-ja. Siç duket po kërkonin t’i caktonin një detyrë të posaçme. Një detyrë që ai nuk donte ta kryente. Nuk e kish kryer në Shqipëri, atëherë pse ta kryente në Amerikë? Kur kish ikur nga Shqipëria kish menduar, veç të tjerave, se po ikte nga një botë që nuk i jepte mundësinë e të qenit siç do të donte; kur kish mbërritur në Amerikë kish menduar se gjendej në botën që i krijonte mundësinë e të qenit siç do të donte. Por në fakt si është Amerika? Bota e re a është në të vërtetë toka e premtuar? A qëndron te Amerika një problem i paparashikuar?

Apo problemi qëndron te Alush Bello? Shqiptarit në Amerikë po i ngatërrohen bota nga kish dalë me botën ku kish hyrë përmes moskuptimesh dhe keqkuptimesh. S’ka si të jetë ndryshe: botën nga ka dalë nuk e ka lënë dot pas, atje larg në pikën e kuqe të kontinentit të vjetër. E po, asnjëherë e shkuara, nuk mbetet atje ku e kur ka ndodhur. Duam s’duam, çdo botë brenda të cilës jetojmë shndërrohet në një botë nga e cila zor se dalim. Sepse ka hedhur rrënjë në thellësi të qenies, duke u shndërruar në një botë të brendshme. Është fjala, pra, për një botë që s’ke çare pa e marrë me vete kudo shkofsh. Për pasojë çdo reflektim bëhet mbi “rregullat” e asaj bote.

Një botë brenda vetes, me “rregullat” e saj, me mendësinë e saj, me mënyrën e saj të perceptimit të realitetit, është edhe ajo e deputetit të parlamentit të parë pluralist shqiptar, rrëfimtari të novelës “Zbulimi i Parisit nga shqiptarët”. Një botë që edhe ai e ka marrë me vete pa e ditur. Asnjë implikim politik në këtë rast, pa ndonjë lidhje të veçantë me diktaturën, megjithatë një botë e ndërtuar dhe e ngurtësuar në një mungesë të theksuar lirie. Pasoja e mendjembylljes, tipike e të jetuarit në izolim kur s’ka çare të mos e përfytyrosh prapamendimin pas çdo fjale, veprimi, qëndrimi krejt të rëndomtë, edhe pse prapamendimi, në të vërtetë, nuk ekziston...

Rruga e kundërt

Sigurisht, jo të gjithë shqiptarët e pasviteve ‘90, për zgjedhje apo për destin, morën rrugët për gjetiu. Si e shohin ata, në këto kushte, nëse jo botën jashtë, mundësinë e reflektimit të dritës së saj në botën e tyre? A e shohin, në fund të fundit? A ju shkon mendja se mund të ndërtojnë një botë më të mirë brenda, për veten, siç e ndërtojnë të huajt në botën jashtë?

Në intermexon “De profundis” që lidh novelat e skajeve është një francez që bën rrugën e kundërt: nga bota e madhe dhe e hapur vjen në botën ende të vogël e të ngushtë të shqiptarëve të fillimviteve ‘90. Ai vjen që të ofrojë ndihma humanitare por konstaton se ata ndihen “aq të pafuqishëm për të ndihmuar veten dhe për të parë më gjerë, sa nuk bënin as përpjekjen më të vogël për të kuptuar se si mund të dilnin nga humnera”.

I mësuar të notojë pa ngurrim në oqeanin e mundësive, i aftë për t’i mbërritur brigjet shpëtimtare edhe në raste aspak të favorshme, francezi tronditet nga dorëzimi tipik shqiptar, nga pafuqia dhe paaftësia e tyre për të bërë diçka për veten. Madje shqiptarët as që e ditkan se çfarë do të thotë të bësh diçka për veten. S’ka çare që ata të mos u ngjajnë zogjve që gjithë jetën kanë “kënduar” në kafaz. Kanë “kënduar” për



maraz e jo për gaz ama, kur dera e kafazit papritmas është hapur ata nuk fluturojnë për ta ndryshuar tingëllimën e trishtuar të këngës. Flatrat e tyre e kanë humbur refleksin e lindur të flatrimit, por më e keqja është se kanë humbur kujtesën dhe tani nuk e dinë më se ekziston mundësia e fluturimit nga humnera drejt qiellit të mundësive...

Në njërën anë janë shqiptarët që reflektojnë për botën jashtë që po e njohin për herë të parë, por gjithnjë me mënyrën e tyre të reflektimit dhe me mundësitë që u lejon vetë bota brenda të cilës kanë jetuar deri në fillim viteve '90; në anën tjetër janë të huajt që reflektojnë për botën tonë, tronditshëm duke mos kuptuar se pse ajo botë nuk shpërthen për të rrokur hapësira mundësie.

Të dy botët, kaq të ndryshme, përplasen.

Shpjegim për autobiografizmin

Kur ndala pak më sipër te historia e Alush Bellos, citova një copëz nga komenti që bën për të zëri rrëfimtari (i njëjti për të tria novelat): "... ai nuk kishte marrë kurrë në jetën e tij ndonjë ftesë e as ndonjë urdhër nga sigurimi për të bashkëpunuar". Déjà vu. Hapa librin "Dhomat pa mure" (Arta Marku / Toena 2021/ f. 87) ku gjendet mes të tjerave një intervistë që pata bërë me Besnik Mustafajn, me rastin e botimit të librit "Bishti i kometës" (Toena 2014). "Nuk kam pasur as nderin që të kundërshtoj bashkëpunimin me Sigurimin dhe as turpin të jem informator. Nuk më është qasur ndonjëherë kush që të më kërkojë bashkëpunim" – më pat thënë ai, kësaj here për veten.

Nuk e theksova këtë përkim vetëm sa për të përmendur elementin autobiografik të përmbledhjes "Porta e ngushtë e purgatorit", tepër të pranishëm, fund e krye, duke e lidhur dukshëm zërin rrëfimtari të tri novelave me autorin e tyre: në novelën e parë rrëfen ministri i jashtëm që gjendet në Amerikë për të marrë pjesë në Asamblenë e përgjithshme të OKB; në të dytën ambasadori shqiptar në Paris që i kërkon mikut të tij francez që gjatë misionit humanitar në Shqipëri, të çojë ndihma edhe në Tropojë për ata që e votuan si deputet në zgjedhjet e para pluraliste; në të tretën deputeti i parlamentit të parë pluralist i cili, në cilësinë e shkrimtarit gjithsesi, udhëton në Paris për të marrë pjesë në një takim shkrimtarësh të vendeve ish komuniste, organizuar nga ministri francez i kulturës, Jack Lang.

Në gjykimin tim, prania e autobiografizmit nuk shkon në favor të kureshtjes së lexuesit lidhur me shkrimtarin por vlen si dëshmi për reflektimin e thellë që kalon përmes përvojave vetjake. Afërmendsh që përvojat vetjake gërshetohen me përvojat kolektive, përbashkuete të shqiptarëve e fillimviteve '90, për të shpjeguar pikërisht kalimin përmes portës së ngushtë të purgatorit, vështirësinë e pastrimit të domosdoshëm para kapërcimit nga bota e mbyllur në botën e hapur, nga izolimi në liri...

Një kapërcim aspak fizik e asfare i jashtëm. Përkundrazi, siç thashë, gjithçka ndodh në thellësi të qenies ku janë lëshuar rrënjët e një bote që gjendet (apo gjendej) brenda vetë shqiptarit, sigurisht pasojë e botës brenda të cilës gjendet (gjendej) shqiptari. Një botë që ishte por me shumë gjasë vazhdon të jetë, pavarësisht sa duket, sepse e shkuara të përndjek, historia është gjithnjë me ty.

"Porta e ngushtë e purgatorit" është reflektimi i radhës mbi raportin e shqiptarëve me historinë, lajtmotivi tipik i krejt veprës së Mustafajt.

Shënime për romanin e Ndue Ukajt

"Dritarja e Marin Shkrelit", traktat prozaik për Kosovën e djeshme e të sotme

Nga Elvi Sidheri

Meqenëse Ndue Ukajn e kam njohur gjer më tani, kryesisht përmes vargjeve e krijimeve të tij poetike, duke u thelluar në poetikën e tij jo rrallë edhe si përkthyes në spanjisht të vargëzimeve të tij në poezi, Dritarja e Marin Shkrelit, do të përbënte për mua njëherësh, një ëndje të veçantë letrare, një kërshe të cytur fuqimisht nga frymëzimi i tij në prozë, e mbi të gjitha, një zbulim e zbulesë njëkohësisht, të universit jetësor, shpirtëror e përditësor të Kosovës së kapërcyellit të shekujve XX-XXI, e sidomos dhjetë viteve vendimtare 1989-1999.

Është fjala për një roman, sigurisht, të përvijuar sipas tipareve thelbësore të një mundimi të këtillë letrar, ku përshkruhen me ndjeshmëri, realizëm e frymë të përkorë narrative, ngjarjet parësore në urën metaforike dhjetë vjeçare, që do t'i shpinte shqiptarët e Kosovës, nga rrëmbimi i dhunshëm i autonomisë së tyre krahinore në gjirin e Jugosllavisë së kalbur e në grahamat e saj të fundit të ekzistencës, deri në ditët pas bombardimeve shpëtimtare të NATO kundër regjimit genocidues të Millosheviçit.

Urë që pastaj merr edhe një zgjatim të mëtejshëm tej kuptimplotë, jetik për arsyen e shkrimit dhe vlerën e patjetërsueshme të këtij romani, duke përfshirë edhe periudhën traumatike të pasluftës.

Një periudhë mendësisht anarkike, gëluese nga mitizime, harresë kolektive e hibridizime plagësh e vragash lufte, me shpërdorime e

makutëri përkohësie tranzicionesh shoqërore, që shuajnë e përthajnë çdo lulëzim të mundshëm të fryteve të haresë së çlirimit.

Marin Shkreli është një djalosh i ri në moshë, që në njëfarë mënyrë, plakët e fishket nga koha e rrethanat, nga shtypja, nga frika e rrënjësor në palcën e shqiptarëve të Kosovës, për shkak të aparteidit e racizmit të skajshëm të ushtruar nga sundimi brutal i Millosheviçit e zagarëve të tij të armatosur anekënd Kosovës.

Atij i rri pezull jeta, rrahjet e zemrës i ngadalësohen, gurgullimat e gjallërisë rinore i meken, e mbase vetëm dashuria i përflaket në vena, si një formë e pagjasë qëndrese ndaj këtyre kohëve të mugëta pasigurie, nëpërkëmbje të miratuar me ligj të qenësisë shqiptare në trojet e veta, e një lufte mizore që ndihet në ajër, e avitet kërcënueshëm, bashkë me pasojat e pastrimit etnik, e dhunimeve masive të femrës shqiptare nga bishat e tërbuara të ndërsyera prej kutërbimeve gojore të Millosheviçit.

E tëra ndërkaq ndërthuret, në mendjen pjellore të Marin Shkrelit, me një prirje të tij flizofike të pashoqe, përkundër gjithçkaje, zymtësisë rrethanore, thatësisë shpirtërore, ngushtësive ekonomike, bjerrjes së pandalshme të çdo të drejte shqiptarësie në Kosovë në këtë dhjetë vjeçar shtypës, trysnive të pashembullta e censurës edhe për t'u frymëmarrë lirisht prej tij e gjithë bashkëkombësve të vet në këtë truall stërgjyshëror.

Ajka e letërsisë botërore, mendjet më gjeniale të poezisë, prozës, filozofisë e letërsisë

europiane në shekuj, nga Dante te Shekspiri, Kavafis, Gëte, Kadare, e në veçanti Emil Zola (me përkufizimin mbresëlënës të qenësisë njerëzore, ku shumëkush denjon veç të na shohë përciptas syprinën, ndokush parathënie, shumica u besojnë kritikëve, e ndoca të paktë syresh, kanë gjasa ta njohin thelbin e përmbajtjes sonë), ravijëzohen në faqet këtij romani, jo vetëm si përforcues të kumteve të tij parimorë.

Ngase Marin Shkreli, e doemos krijuesi i tij si personazh letrar kaq i goditur, i shumanshëm e bashkëkohor, janë pa asnjë dyshim mishërues të alter ego e rinisë kosovare të atyre viteve të zjarra e kaq mbrujtëse për historinë e mëtejshme të Kosovës e banorëve të saj autoktonë shqiptarë, aq shpesh të përballur me mohimin, jo thjesht të rrënjëve të tyre të përligjura historike, por edhe më zhbërjen e plotë e sistematike, të pranisë së tyre fizike në viset e lashta dardane.

Pas dhunës e shtypjes së ardhur me tanke e tyta automatikësh nga veriu e Beogradi, liria do të vijë në formë bombash e predhash nga qielli, pikërisht si një shpëtim e shëlbim hyjnor, për Marinin e bashkatdhetarët e tij të përvuajtur, megjithëse të shumtë do të dergjen të pajetë, të dhunuara të dashurat, gratë e motrat e shumëkujt, të vrrarë fizikisht e shpirtërisht, mijëra e mijëra.

Shpëtimi do të vijë konkretisht e mirëfilli, nga Perëndimi, nëpërmjet Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe avionëve të saj bombardues që do ta shkëmoqnin ngrehinën ushtarake e paramilitare të Millosheviçit, duke ia ngrirë buzëqeshjen në gojë Kasapit të Ballkanit, pa e përmbyllur dot veprën e tij djallëzore të pastrimit etnik të plotë të shqiptarëve nga Kosova.

Njëfarë Zgjidhje Finale, në shkallë ballkanike, që asnjë arsye për zili nuk do të kishte ndaj politikave hitleriane gjatë Holokaustit sidoqoftë.

Megjithatë, ky shpëtim në Perëndim, do të jetësohet edhe nga qindra mijëra refugjatët kosovarë të luftës, që do të vërshojnë në Shqipëri, aty ku sipas ushtarëve, milicëve e paramilitarëve serbë, e kishin edhe vendin, sikurse lexojmë shpesh në këtë libër.

Shqipëria nuk është vetëm shteti amë, koka e dytë e shkabës dykrenare, por edhe perëndimi fizik e faktik për Kosovën, e kaq shumë shqiptarë të Kosovës, aty do ta gjejnë shpëtimin, si Marin Shkreli.


Më tej, paslufta do të shndërrohet në brengë gjithaq të dhembshme, derisa mërgimi, i shmangur me kthimin e rrufeshëm në Kosovë e Prishtinë, në gjurmët e Donikës së shenjuar mizorisht nga traumat e luftës dhe vrazhdësisë së pashembullt të hordhive millosheviçiane, do të bëhet i pashmangshëm për Marin Shkrelin.

Një vizë, radhat në dyer ambasadash, nevoja e domosdoshme për t'u larguar, paçka se jo nga lufta, as nga armët, as nga genocidi.

Tranzicioni, lufta për jetën e përditshme, beteja e përhershme me harresën, plagët e pambyllura të përgjakura që tanimë ballafaqohen me një aktualitet të poshtër, përbuzës e mosmirënjohës, edhe ndaj vetë vuajtjeve, fljimeve e historisë së shoqërisë e popullit shqiptar në Kosovë.

Ky mërgim rishtas, në kohë paqeje, në liri e demokraci të hamendësuar, larg barbarëve (ose ende në pritje të tyre, për ta kujtuar edhe një herë Kavafisin mahnitës), është po aq prekës, shterues shpirtërisht e qenësisht për Marin Shkrelin, lexuesin, e autorin e tij, gjithashtu.

Sidoqoftë, Dritarja e Marin Shkrelit, në larminë e tij narrative, në filozofinë e tij thelbësore, në frymën e përçar, përbën një risi të mirëfilltë në qëmtimin letrar të kësaj ane akoma të errët të hënës kosovare.



Në morinë e romaneve që lexojmë gjatë njetës, shumicën i harrojmë sapo i përfundojmë. Disa të tjerë mbeten në kujtesë si shkrepje të shkurtra që s'prekin dot brenda nesh. Por ka edhe romane (shumë më të rrallë) që nuk i përfundojmë kurrë vërtet. Jo pse nuk u shkojmë deri në fund, përkundrazi, shpesh u rikthehemi, por sepse ata mbeten brenda nesh, duke trazuar heshtur kujtesën tonë estetike. Romani “E zeza dhe e kuqja” i Mehmet Krajës është një prej tyre.

Ai përfaqëson një nga kulmet e prozës bashkëkohore shqiptare, duke ofruar një reflektim estetik dhe filozofik mbi përvojën historike, kulturore dhe psikologjike të shqiptarëve gjatë një shekulli të trazuar. I ndërtuar si ndërthurje mjeshtërore mes letërsisë realiste, asaj psikologjike dhe përmasave filozofike, romani ngre një strukturë rrëfimore të shtresëzuar, ku koha, hapësira dhe ndërgjegjja njerëzore përzihen përmes gjuhës poetike dhe përsiatjesh të thella ekzistenciale.

Pas leximit të kësaj vepre voluminoze, jo vetëm për nga faqet, por sidomos për nga dendësia intelektuale dhe emocionale, krijohet bindja se Kraja nuk ka shkruar një roman në kuptimin konvencional të fjalës. Ai ka ndërtuar një univers të tërë përjetimesh kolektive dhe individuale që shtrihet mbi tri breza në hark njëqindvjeçar. Me strukturë polifonike dhe shkrirje të vetëdijshme të zhanreve, autori arrin të bashkojë rrëfimin intim me historinë kolektive, refleksionin ekzistencial me përmasat mitopoetike të vetëdijes kombëtare.

Ajo që bie në sy gjatë leximit të romanit “E zeza dhe e kuqja” është fakti se autori nuk trembet të kapet fort pas kohës, kujtesës dhe gjakut. Jo për t'i kënduar himne patetike të kaluarës, por për t'i trazuar plagët ende të pambyllura në ndërgjegjen tonë kolektive. Që në fillim duhet theksuar se ndonëse romani përshkohet nga shenja të qarta historike, ai nuk është një roman historik në kuptimin klasik të zhanrit. Më shumë sesa të rindërtojë të shkuarën, ai synon ta shpërbëjë iluzionin e së tashmes. Përtej këtij kuptimi romani duhet të lexohet si një “konstruktion” që ngjiz historinë me ekzistencën e ku e kaluara nuk shërben për të sqaruar të tashmen, por për ta thelluar dhe bërë atë më të errët dhe më enigmatike. Në vizionin krijues të Krajës, historia nuk është narrativë sqaruese, por prani destabilizuese: ajo shfaqet për të dëshmuar se subjekti shqiptar, qoftë ai krajan, shkodran apo universal, është përballur vazhdimisht me zhvendosje të dhunshme të qenies, me pushtime, diktatura dhe pastaj me zbrazëtinë morale që mbetet pas rënies së ideologjive. Te e “E zeza dhe e kuqja” historia nuk është bosht rrëfimor, por trup i heshtur që ndjek lëvizjet e shpirtit; sfond që qëndron pezull mbi fatin e personazheve, i padukshëm por gjithmonë i pranishëm, me një gravitet të brendshëm që nuk ka nevojë për zë, sepse vepron përmes heshtjes.

Një nga elementët më të spikatur të romanit është intertekstualiteti ironik me pikënisje titullin e tij. Sapo e lexon sintagmën e titullit, lexuesi, sidomos ai i pasionuar, përjeton një lloj asociimi të përmbysur me titullin e romanit të njohur të Stendalit “E kuqja dhe e zeza”, por gjatë leximit harrohet krejt ky asociim dhe titulli lexohet e kuptohet si sugjerim i autorit për një rivlerësim kritik të kodit simbolik të historisë dhe identitetit kombëtar shqiptar. Në vend të ngjyrës së kuqe që është e pranuar si simbol i heroizmit dhe virtutit, në plan të parë del e zeza, metaforë e tragjedisë, dështimit dhe errësirës historike. Ky akt ta quajmë parodik nënvizion distancën e autorit nga narrativa heroizuese tradicionale dhe përpiqet të riartikulojë historinë përmes një optike ironike, shpesh groteske. Sintagma “E zeza dhe e kuqja” në të vërtetë është një figurë binare që përfaqëson gjithçka që mbart përplasje: jeta dhe vdekja, flamuri dhe gjaku, dashuria për atdheun dhe dhembja që ai të shkakton, shpresa dhe zhgënjimi. Ngjyrat janë gjithashtu edhe forma të të menduarit politik dhe moral: e zeza është kufiri, hija, vdekja; ndërsa e kuqja është flamuri i munguar, zemra që s'pushon së dashuri. Këto dy ngjyra nuk bashkohen kurrë në ndonjë ngjyrë të tretë, mbeten të ndara si vetë Shqipëria. (Shqipëria e jashtme dhe Shqipëria e brendshme, kështu i quan Kraja Shqipëritë e tij).

Por, përtej këtij kuptimi, e zeza e titullit nuk është thjesht vdekja dhe e kuqja nuk është vetëm gjaku. Ato janë dy ngjyrat e një flamuri

Romani “E zeza dhe e kuqja” i Mehmet Krajës

E ZEZA PARA SË KUQES: NJË ROMAN PËRTEJ HISTORISË

Nga Albana Beqiri

Romani “E zeza dhe e kuqja” i Mehmet Krajës përfaqëson një nga kulmet e prozës bashkëkohore shqiptare, duke ofruar një reflektim estetik dhe filozofik mbi përvojën historike, kulturore dhe psikologjike të shqiptarëve gjatë një shekulli të trazuar. I ndërtuar si ndërthurje mjeshtërore mes letërsisë realiste, asaj psikologjike dhe përmasave filozofike, romani ngre një strukturë rrëfimore të shtresëzuar, ku koha, hapësira dhe ndërgjegjja njerëzore përzihen përmes gjuhës poetike dhe përsiatjesh të thella ekzistenciale.

që nuk mbulon dot gjithë trupin e kombit. Kraja e shtrin metaforën përtej estetikës, duke na orientuar drejt një universi ku tragjedia e tejkalon dhe e shterron mundësinë e ëndrrës.

Thelbi i subjektit të romanit është kufiri, i cili nuk është thjesht vijë ndarëse territoriale, por simbol i thellë i ndarjes dhe sakrificës për një ideologji, një komb dhe një atdhe që do të rrënohen pas çdo brezi. Kufiri i Mehmet Krajës ndërtohet artistikisht si simbol i ndarjes historike të shqiptarëve, ai realisht është një kufi i brendshëm, i lidhur me përvojat dhe vuajtjet e tre gjeneratave të familjes Bogdani: gjyshi, babai dhe i biri, të cilët e paguan me jetën e tyre ndarjen e Shqipërisë dhe pasojat e politikave të jashtme dhe të brendshme që shkatërruan bashkimin kombëtar. Është një kufi që mbetet i ngulitur jo vetëm në hartë, por edhe në kujtesën kolektive të njerëzve që vuajnë dhe sakrifikohen për të ruajtur

dinjitetin kombëtar. Në këtë kuadër, tragjedia e tre breza Bogdanësh është përmbledhja e shumë dhembjeve dhe sakrificave të kombit shqiptar për bashkimin e tij, i cili megjithatë nuk mundi të realizohej. Përgjigja e këtyre sakrificave është tragjikisht ironike: vrasja e nipit nga një oficer i mbetur i regjimit të Enver Hoxhës në vitin 2012 është një akt i dhimbshëm që përforcon idenë e kufirit të brendshëm dhe që fshin çdo mundësi për një të ardhme të përbashkët. Në të vërtetë, trinia e personazheve: gjyshi Halili, i biri Salu dhe nipi është një strukturë ciklike që gërren idenë e vazhdimësisë: breza që vdesin në të njëjtin vend, për të njëjtën ëndërr, në të njëjtin absurditet historik. Gjaku i tyre mbetet dëshmi, por nuk ndryshon dot asgjë. Kjo përsëritje tragjike nuk është vetëm narrativë, por filozofi: shqiptarët e trashëgojnë humbjen si mision kombëtar.




Struktura e romanit ndjek modelin e sagës, por me një rikodifikim të funksionit të saj narrativ. Përmes rrëfimit të jetëve të tre brezave që përmendëm më sipër, autori ndërton një kronikë të ndërprerë të traumës kombëtare, ku fati i individit është i lidhur pazgjidhshmërisht me ndërhyrjen brutale të historisë. Saga e familjes Bogdani zë vendin qendror në këtë strukturë narrative. E përbërë prej burrash që humbin, grash që heshtin dhe hijesh që enden nga një brez te tjetri, ajo përfaqëson një shembull të asaj që mund të quhet “epope e dështimit të ndritshëm”. Kraja nuk e përshkruan artistikisht këtë familje për ta mitizuar atë, por për ta zhveshur nga çdo iluzion. Aty ku të tjerë do të thurnin lavde të kota, ai ndërton figura të thyera që reflektojnë brishtësi ekzistenciale, mungesë shprese e paqe të paqëndrueshme me të keqen që ua ka përpirë të gjitha horizontet. Ndryshe nga sagat tradicionale ku ndëshkimi është shpesh rezultat i fajit moral apo hyjnor, tek Kraja individët janë viktimat të pafajshme të rrethanave të imponuara politike. Kjo e zhvendos romanin nga paradigma klasike drejt një forme të sagës postmoderne (bëhet fjalë për zhvendosje të thelbit nga tragjedia klasike në një tragjedi historike), ku determinimi i fatit nuk vjen më nga rendi metafizik, por nga dhuna e historisë dhe absurdi i realitetit shoqëror e ku shkaqet nuk janë më mitike apo hyjnore, por shoqërore e historike dhe ku përgjigjet janë gjithnjë të pjesshme, të mjegullta ose edhe të pamundura.

Saga e tre brezave nuk është saga e një familjeje, por një formë e shkrirë e historisë personale me atë kolektive e ku brezat nuk janë bartës të mëkateve personale si në sagat klasike, por viktimat të një fati historik të jashtëm, të imponuar nga politika, dhuna dhe ndarja territoriale. Kjo e fundit, ndarja territoriale dhemb aq sa bashkimi apo ribashkimi mbetet synim e ëndërr e përhershme aq sa merr përmasa mitike. E për rrëfimitarin shndërrohet në një ëndërr të aspiuruar: Shkodra!

Te “E zeza dhe e kuqja” Shkodra nuk është thjesht një qytet, por një figurë totemike, një genie që merr frymë nëpër faqet e romanit e që i vështron në heshtje personazhet që zvarriten mes të kaluarës dhe një të tashmeje të brishtë. Shkodra është më shumë se një hapësirë: është ndërgjegje e fshehur, kujtim i përbashkët dhe dhembje që nuk ka emër të përveçëm. Simbolikisht është ëndërr e mëmëdhe imagjinar. Shkodra e Mehmet Krajës paraqitet si një qytet i vendosur në kufijtë e historisë dhe mitit, një hapësirë-magnet që tërheq shpresat dhe rrënon pritjet. E tillë siç e përshkruan Kraja, Shkodra është mit i pamundësisë dhe metaforë e asaj që ëndërrohet por nuk jetohet, prandaj nuk është e rastësishme që të tri gjeneratat e familjes Bogdani (sikurse gjithë krajanët) përfundojnë duke e kërkuar këtë qytet. Figura e Shkodrës në roman nuk shërben thjesht si një sfond gjeohistorik apo si kronotop i zhvillimeve, por shfaqet si organizëm i gjallë e entitet që ngërthen në vetvete kujtesën kolektive me dhembjen e patreguar, duke u përvijuar njëherazi si një kronotop metafizik ku përthithet e mishërohet tragjedia e shqiptarit të shekullit XX.

“Qyteti i heshtun që fle mbi varre,” e quan autori, duke e vendosur atë në një pozicion të ngjashëm me konceptin e Milan Kunderës për Evropën Qendrore: si një hapësirë që mbron



kujtesën përmes heshtjes.

“E zeza dhe e kuqja” është gjithashtu një udhëtim i thellë psikologjik dhe filozofik. I rrëfimtari, i personazheve, i kohës dhe botës që krijon artistikisht autori në “ndeshje” me referencat historike. Dimensioni psikologjik dhe filozofik i romanit është i dukshëm e imponues veçmas në përsiatjet e dendura introspektive, të cilat jo rrallë shndërrohen në refleksione ekzistenciale për natyrën e kohës, ndërgjegjes, egzistencës, ëndrrës, vetëdijes, identitetit dhe shpirtit njerëzor. Kraja përdor një ligjërim thellësisht meditues, i cili përfaqëson një nevojë të vazhdueshme për të kuptuar botën dhe qenien nëpërmjet rrëfimit si dhe për të eksploruar njeriun në thellësitë e tij më të errëta dhe më të larta. Ky komponent e lidh romanin me traditën e romanit modernist dhe me prirjet më të rafinuara të letërsisë filozofike bashkëkohore.

Duke qenë i konceptuar dhe ndërtuar si një roman polifonik te “E zeza dhe e kuqja” rrëfimi përmban siç thamë elementë të sagës epike, romanit psikologjik, përsiatjes filozofike, por edhe të utopisë dhe antiutopisë, të cilat nuk qëndrojnë si shtesa artificiale, por funksionojnë si mënyra të ndryshme të kuptimit të përvojës historike dhe shpirtërore shqiptare. Në këtë kontekst, përmasat utopike dhe antiutopike që ndërthuren në strukturën e romanit nuk janë të ngjizura në kuptimin klasik të këtyre kategorive letrare. Utopia që paraqet Kraja është një konstruksion psiko-sugestionues, një projekt ëndërrimtar vetjak dhe kolektiv i ndërgjegjes shqiptare, i ndërtuar mbi mungesën, dëshirën dhe zhgënjimin. Ajo materializohet në vegimet idilike, të ngjashme me motivet e krijimtarisë gojore, ku Shkodra, si topos mitik, paraqitet si qendër shpirtërore e një identiteti të humbur. Në të kundërt, antiutopia përfaqësohet nga përfytyrimi i errët i botës së përtejme, e ndërtuar si metaforë e tejzgjatur e ndëshkimit moral dhe e zbulimit të së vërtetës së fshehur, si metaforë për shterpësinë morale të shoqërisë, për mungesën e drejtësisë dhe për dëshpërimin që nuk përfundon as me vdekjen.

Utopia dhe antiutopia në romanin e Krajës nuk janë projekte ideologjike siç ndodh zakonisht në letërsinë klasike distopike, por janë përjetime psiko-emocionale, shpesh të fragmentuara dhe të pasigurta.

Në këtë mënyrë, Kraja e zhvendos diskursin distopik nga realiteti tokësor në një hapësirë të tejkohshme dhe të tejasgjësuar, duke theksuar përmasat metafizike të dhembjes dhe zhgënjimit. Ky kthim tek metafora e rëndë e vdekjes dhe e harresës nuk është shenjë e një resignimi letrar, por një akt i thellë kritik ndaj historisë së pasublimuar të një shoqërie që nuk arrin të përballlet me të shkuarën e saj.

Mehmet Kraja e ndërton rrëfimin e romanit mbi një strukturë të veçantë narrative, ku koha shpërbëhet dhe ribëhet dhe ku e tashmja endet gjithnjë në hijet e së shkuarës. Narracioni karakterizohet nga një liri e theksuar lëvizjeje nëpër vetëdijen e personazheve, duke integruar retrospektivën si mjet strukturor dhe duke e ngjizur rrëfimin me reflektime filozofike mbi vdekjen, shpirtin, mallin dhe fatin tragjik të shqiptarit. Prandaj rrëfimtari nuk është thjesht zë që përcejell ngjarjet, por kronikan i një apokalipsi të ngadaltë, i cili vërtet ndodh pa bujë, por rrënon gjithçka.

Romani është strukturuar në nëntë kapituj, të baraslarguar në përmasa dhe përmbajtje, ndarje kjo që funksionon si mjet për të theksuar ritmin e ngjarjeve tragjike që përsëriten nga brezi në brez, pa ndonjë mundësi shpëtimi. Digresionet e shumta nuk janë shmangie, por ura që lidhin artistikisht të kaluarën me të tashmen për të dëshmuar se përpjekjet, luftërat dhe sakrificat e së djeshmes nuk janë kapituj të mbyllur, por tema të hapura që vijojnë të ndikojnë jetët e brezave pasues.

Struktura e romanit ndjek një vetëdije të thelluar narrative. Kraja zgjedh të rrëfejë përmes të vdekurve, zgjedhje artistikisht e guximshme kjo, që e zhvendos romanin nga një narrativë historike në një poetikë të kujtesës së përtejme. Narratori është një shpirt i vrarë në kufi, që sheh dhe kupton më shumë se të gjallët. Ky rrëfim “nga atëbotë” siç e quan autori, krijon një sfond të ngjeshur metafizik, ku vdekja nuk është fund, por vazhdim i pazëshëm i dramës kombëtare. Kjo perspektivë e përmbysur ose jo (lexuesi ka lirinë ta interpretojë) jep narracion me një zë

të rrallë: të qetë dhe të qartë, por thellësisht të trishtuar dhe të përmbajtur.

Ajo që e veçon Krajën në këtë roman është gjuha: e kthjellët, e përpunuar dhe latuar deri në përsosmërinë e filigranit e gjithmonë me një nëntekst të thellë filozofik. Autori nuk e përdor gjuhën për të moralizuar, por vetëm për të nxitur reflektim; as për të ndërtuar heronj klasikë, por vetëm figura që rrëzohen e ngrihen brenda rrëfimit të tyre, shpesh të mbytur nga vetë zëri i ndërgjegjes.

E romanin nuk e bën të veçantë vetëm lënda e tij tematike, por mënyra sesi ajo shndërrohet në gjuhë që s’është më thjesht narracion, por psalmodi. Kraja shkruan me një ngadalësi solemne, me fjalë që rrjedhin të plota, të dendura, nganëherë të ngadalta por mandej shpërthyesë. Ai nuk rrëfen vetëm ngjarje, por e ngarkon çdo episod me frymë përtejkohore, që mund të lexohet njëherazi si histori familjare, si elegji për një qytet e akoma më tepër si kronikë për një popull.

Çelësi i kësaj strukture të përsosur rrëfimore është forma e lidhjes zinxhimore të paragrafëve të gjatë, të cilët kanë një efekt të jashtëzakonshëm në ndërtimin e atmosferës. Ato nuk janë rrëfime të thjeshta, por janë si rrjedha të pafundme që përhapin energji të brendshme që ndjehet organikisht. Në këtë kontekst, romani ofron vizion të thellë mbi përjetimet dhe qënien njerëzore, duke kaluar nga nivelet më të thella të shpirtit te ndjenjat dhe ëndrrat që mbeten të pakapshme dhe të heshtura.

Gjuha në këtë roman kërkon të kapë ato ndjenja të paartikuluara, ato gjendje që rrëshqasin nga fjalët dhe që ndoshta mund të arrihen vetëm përmes një lloj shpërthimi estetik.

Në roman, shumë skena (si ajo e vajtimit të nënës, që shndërrohet në një këngë kozmike) krijojnë një kronotop metafizik: vendi dhe koha nuk janë më vetëm reale, por hapësira të zbrazëta ku njeriu përballlet me vetminë, mungesën e dashurisë dhe misterin e jetës e të vdekjes. Përtej përpjekjes për të artikuluar përvoja e ndjenja që zhvillohen në thellësinë e njeriut, krejt në heshtje dhe që mund të shprehen vetëm përmes një gjuhe që depërton përtej të mundshmes në nivele shumë më të thella, autori arrin ta barazvlerësojë gjuhën me letërsinë. Kapitna e veçantë ku përshkruhet vajtimi i nënës është shembull i jashtëzakonshëm i kësaj gjuhe, e cila përpigjet të kapë momentet e humbjes dhe nostalgjisë që nuk mund të artikulohen lehtë. Sepse, ky vajtim ngjethës nuk është thjesht shprehje e dhembjes për një të dashur të humbur, por para së gjithash përpjekje për të kapur diçka të thellë dhe të paarritshme që është më shumë se fjalë e ndjesi.

Autori e ndërton narracionin duke ndjekur një stil poetik, i cili dominohet nga rrëfimi i rrjedhshëm që ngjason si litani kujtimesh dhe ndërgjegjeje. Sintaksa është e dendur, metaforike dhe plot ngarkesa të gravitetit ekzistencial. Fjalitë nuk funksionojnë vetëm si njësi komunikimi, por vetë narracioni merr trajtën e një rituali diskursiv, që synon të çlirojë zërat e ngujuar në shtresimet historike të ndërgjegjes kolektive. Përmes këtij lloji të shkrimit, Kraja ndërton një dimension të dytë të realitetit narrativ, ku shqetësimi filozofik dhe përjetimi emocional ndërthuren në mënyrë të pazgjidhshme. Çdo njësi diskursive në roman shndërrohet në një reflektim mbi ekzistencën, mbi atë që është e humbur, e jetuar dhe potencialisht e mundshme. Në këtë kuadër, “E zeza dhe e kuqja” mund të konceptohet si një tekst letrar që, nëpërmjet estetikës së vet të brendshme dhe tensionit filozofik që e përshkon, artikulon një dimension qenësor të përvojës njerëzore dhe të subjektivitetit shqiptar, duke krijuar hapësirë diskursive ku këto përmasa jo vetëm që bashkëtojnë, por gjejnë shprehje të thellë dhe autentike.

“E zeza dhe e kuqja” kërkon lexim të vëmendshëm, të ngadaltë dhe të përqendruar, me ndalesa reflektuese dhe ritme të thella meditive. Ai nuk mund të përthihet me një lexim të sipërfaqshëm; përkundrazi, kërkon një përfshirje të plotë, si në nivelin intelektual ashtu edhe në atë emocional. Romani nuk e mbyll historinë e Bogdanëve e as të Shkodrës apo të shqiptarëve në përgjithësi, por përkundrazi, e rihap atë në një mënyrë që vetëm letërsia e mirëfilltë arrin ta bëjë: përmes një rrëfimi që nuk ngurron të përballlet me dhembjen, me humbjen dhe me të vërtetën estetike të artit.

Bobby Solo Elvis Presley italian vjen në Tiranë së bashku me Marco Zappa

Duket se muzika melodioze dhe stili rock i viteve ’70 që ndezën Man-çesterin me zërin e Bruce Springsteen do të përsëritet edhe në Tiranë me kantautorin e famshëm, legjendën e muzikës së lehtë italiane, Bobby Solo. Pas turit të tij në Francë e Luksemburg, në kuadër edhe të javës kulturore italiane, më 3 qershor, ai do të vijë të këndojë për herë të parë në Tiranë së bashku me kantautorin e famshëm italo-zviceran, Marco Zappa.

Bobby Solo është i njohur për zërin e tij të veçantë dhe stilin që shpesh është krahasuar me atë të Elvis Presley-t, duke fituar edhe nofkën “Elvisi italian”. Karriera e tij mori hov në vitin 1964, kur fitoi Festivalin e Sanremos me këngën e famshme «Una lacrima sul viso» («Një lot në fytyrë»), e cila u bë një hit ndërkombëtar dhe një nga këngët më të dashura të muzikës italiane. Kjo këngë u shit në miliona kopje dhe e ngriti Bobby-n në majat e skenës muzikore.

Gjatë karrierës së tij, ai ka marrë pjesë disa herë në Festivalin e Sanremos dhe në kompeticione të tjera prestigjioze, duke u bërë një ikonë e muzikës pop dhe rock italiane. Stili i tij përfshin elemente të rock ‘n’ roll, baladës romantike dhe muzikës melodike italiane. Në një intervistë dhënë qendrës « Shqipëriaë Europiane », organizueses së këtij eventi, ai thotë se mezi pret të vijë në Tiranë që të këndojë këngët e njohura të tij, « Una lacrima sul viso », « Zingara », dhe rock ‘n’ roll, country, bluz. Marco Zappa që do të ndajë skenën me Bobby Solon thotë se është rritur me muzikën e këtij kantautori legjendar dhe ai është i lidhur me Shqipërinë sepse edhe gruaja e tij Elena është shqiptare. Ai do të këndojë këngë që lidhen me vendin tonë, por edhe këngë të tija me një stil të lartë. I njohur edhe si ndjekës i BITELLSAVE, ai do këndojë edhe mjaft këngë të tyre.

Koncerti do të zhvillohet në datën 3 Qershor, ora 21:00 në Pallatin e Kongreseve. dhe do të jetë i ndarë në 2 pjesë- Pjesa e parë nga Marco Zappa dhe pjesa e dytë Bobby Solo dhe grupi.

Një mbrëmje legjendare në Tiranë!

Dy emra ikonë të muzikës europiane, Bobby Solo & Marco Zappa, vijnë për herë të parë në Tiranë për një koncert ekskluziv që bashkon emocionin e muzikës live me historinë e artit ndërkombëtar!

BOBBY SOLO, “Elvisi i Italisë”, sjell në skenë hite që kanë shënuar breza:

• Una lacrima sul viso • Zingara• Se piangi, se ridi

MARCO ZAPPA, një nga figurat më të njohura të muzikës zvicerane, do të ngjallë emocion me tinguj që përziejnë pop, folk dhe frymëzime nga The Beatles.

•

Detajet e koncertit:

Data: 3 qershor 2025

Ora: 21:00

Vendi: Pallati i Kongreseve, Tiranë

Biletat:

Online në: www.myticket.al

Fizikisht në të gjitha pikat e Western Union

•

Një skenë. Dy legjenda. Një natë e paharrueshme.

Mos e humb këtë ngjarje unike që sjell klasin dhe emocionin e vërtetë muzikor në zemër të Tiranës!

Një mbrëmje e veçantë në Tiranë me Bobby Solon dhe Marco Zappa!

—

Ky është një takim i rrallë me Bobby Solon, ikonën që ka formësuar breza të tërë me zërin, fjalën dhe mesazhin e tij. Artistë që kanë ruajtur origjinalitetin dhe fuqinë e muzikës së vërtetë në një botë që ndryshon çdo ditë. Një thirrje për të gjithë ata që janë rritur me muzikën e tyre dhe ju të rinj: Është koha të riktheheni aty ku gjithçka filloi – te tingujt që formuan kujtimet tuaja, te zërat që mbushën jetën tuaj me emocion.

Mos e humbisni këtë ngjarje unike. Festoni artin, nostalgjinë dhe shpirtin e një brezi që ende ka shumë për të dhënë!

Gjendja optimale e qënies njerëzore është në rritje biologjikisht dhe mendërisht në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa rritja fizike është proces i natyrshëm ose i detyrueshëm, rritja dhe zhvillimi mendor nuk është i garantuar. Kërkon rritje dinamike për mendim abstrakt, thellësi emocionale, komunikim kompleks dhe arsyetim moral. Shumë vite më parë më intrigonte pyetja: pse disa lexues pëlqejnë dhe e sfidojnë veten duke lexuar qëllimisht romane trillues të vështirë, me kuptime të maskuara nëpër tekst dhe të paqartë, me interpretim dyshues, etj.. Ndërsa shumë të tjerë nuk i preferojnë të tillë autorë. Sa më shumë dëgjoja frazën “çështje shije, shijet janë subjektive”, aq më shumë anoja nga mendimi se kjo përgjigje ishte jo e duhura, disi spekulative. E konsideroja si përpjekje që orvatej të fshihte paaftësinë ose pamundësinë e tyre për të kuptuar një histori të shkruar me mjeshtëri të lartë trilluese, ndryshe të mirëfabrikuar. Më nxiste pyetjen: Mund të zgjidhet shija?. Gjenetikisht i pabarabartë prej natyre, si individualitet në diversitet, njerëzit dallohen nga kombinimi i tre faktorëve: fondamenti biologjikë, temperamentit emocional ose personaliteti psikologjik dhe kultivimi kulturor. Kur themi fondamenti biologjik nënkuptohet një dhunti që lind me njeriun.

Shija jo vetëm që është një përvojë biologjikisht komplekse, por dhe mjaft imagjinative e psikologjike. Pra pyetja që pason do ishte: çfarë tip personaliteti ke trashëguar? Dhe në varsëi të tij a të mundësohet zhytja në detin emocional të një historie të mirëfabrikuar? Të ka pajisur natyra me “injektorin” që ndez ndjenjat në mendjen e njeriut?

Mendoj se përgjigjet e pyetjeve më sipër na ndihmojnë për të kuptuar se çfarë i bën disa të paktë njerëz që të shijojnë dhe të adhurojnë letërsinë e majave, dhe pse disa të tjerë, shumica nuk e gëzojnë këtë “privilegj”?. Në biseda mbi letërsinë dhe autorët nobelistë, disa bashkëbisedues bëhen nervoz

kur dikush tjetër flet edhe për vlera artistike e filozofike të veprës së shkrimtarit tonë të njohur në botë.

S’më mbetej tjetër vetëm të përsërisja shprehjen klishe: shijet kanë karakter subjektiv.

Veten e gjeja shpesh afër thënies së Umberto Eco-s se: “letërsia lejon një sërë interpretime, por disa janë më të mira se të tjerat”. Pyesja veten: çfarë e kufizon lirinë e lexuesit për të interpretuar tekstin e një tregimi të trilluar, Pse disa bëjnë interpretim shpjegues të tekstit e disa më të paktë interpretim simptomatik të tij. Kur përdor fjalën “simptomatik” kam parasysh që mjeku vendos diagnozë bazuar në nënkuptimet e fshehura, të maskuara dhe të vërtetat indirekte që mbulohen nën simptomat. Interpretimi simptomatik t’i sjellë ato në sipërfaqe. D.m.th që, tekstin letrar t’a kuptosh si një simptomë të çështjeve të mëdha shoqërore e psikologjike të njeriut, që të përballesh me të këqijat dhe të mirat e natyrës njerëzore. Në përgjithësi tekste të tilla provokojnë pakënaqsi të hidhur kundër autorit.

N.q.se shkrimtari u është shmangur të vërtetave të vështira, të dhimbshme, ceneve, plagve dhe hijeve të fshehura brënda nesh, atëhere i ndihmon ato të zmadhohen, të na mbysin me konformizëm dhe një ditë të shpërthejnë pa pëlqimin tonë. Sa më shumë heshtet aq më shumë shoqëria ndjehet e bllokuar në mediokritet. Jo më kot thuhet se vetëm një ndryshim në qëndrimin interpretues të individit mund të iniciojë një ndryshim në psikologjinë e kombit. Herë pas here bisedat me këto tema më sillnin në mënd periudhën e viteve 70-90 të diktaturës komuniste në vëndin tonë, kur lexuesit shqiptarë varësisht nga qëndrimi i tyre ndaj letërsisë së shkrimtarit Kadare, kategorizoheshin në tre grupe,. Një grup i madh ishin ata që nuk kishin marrë mundimin ndonjëherë që të lexonin ndonjë

Çështje shijeje leximi apo paaftësie për të qënë i hapur ndaj ndryshimeve

Nga Minella Aleks



libër të tij. Grupi i dytë më i vogël ishin ata që e kishin lexuar, që nuk e kuptonin, e fshihnin inatin, nuk e pranonin moskuptimin dhe, zemërimin e moskuptimit e shoqëronin me arsyen se, letërsia e tij ishte dekadente, nxinte realitetin e shkëlqyer komunist, denigronte figurën e komunistit dhe të punonjësve të sigurimit, që shkruhej për lexuesin e huaj, etj,etj.. Fushata antishkrimtar përfshiu nga nxënësit e gjimnazeve tek punëtorët e fshtarët, ushtarakët, organizatat e bashkimeve profesionale e ato të frontit demokratik, etj, sipas modelit të fushatave kundër intelektualëve gjatë revolucionit kulturor kinez. Te radha e qumështit romani “Dimri i vetmisë së madhe” ishte shkaku i bisedave gjithëfarëllojshë nga njëri mëngjes deri në mëngjesin tjetër. Ndërkohë ishin më të paktit lexues ata që adhuronin letërsinë e tij, të cilën e vlerësonin pa rezerva, dhe e shihnin si një mjet të fuqishëm emancipues të shoqërisë shqiptare. Kjo situatë mendonjëse më nxiste drejt pyetjes: Përse disa lexues janë të prirur që të adhurojnë letërsinë trilluese elitare e i quajmë lexues të kultivuar, ndërsa të tjerë të shumtë nuk e gjejnë veten të afërt me të? Madje janë lexuesit e kultivuar që pranojnë se në jetën rinore kanë pasur një moment, një roman trillues që u ka ndryshuar jetën. I ka tronditur mënyrën e të menduarit dhe ndryshuar sjelljen me librin. Kur e pohoja këtë fakt për letërsinë e shkrimtarit Kadare, “miqtë e mi” ndrydhnin brënda vetes rezervat e tyre të dukëshme.

Nuk është kot shprehja se, rruga nga faqja e librit në drejtim të zemrës së lexuesit është larg të qenit një vijë e drejtë.

Sipas psikologëve të mekanizmit transformues të trillimit ftesa e shkrimtarit është një kërkesë lexuesit për përfshirje në një proces me dy faza: faza e daljes ose e largimit nga identiteti vetjak dhe faza e dytë, ajo e hyrjes mendërisht në identitetin e personazheve të botës së pretenduar në roman. Si të thuash të “transportohesh” nga një fazë në tjetrën.

Dmth shkrimtari ose është nga ata që të transporton e të mban të zhytur në botë e krijuar prej tij ose është nga ata që nuk njih asgjë më të lart se vetja, mediokër.

Transport që mund të bëhet në dy forma; i drejtpërdrejtë, tekst i thjeshtë, ose forma tjetër, më delikate e më e paqartë, në formë “spiraleje” intriguese, indirekte, jo e drejtpërdrejtë. “Ecja spirale” është tipar i njerëzve të zgjuar, të rafinuar e delikat, veprimet ose mendimet e tyre nuk kuptohen, nuk zbulohen lehtë në shikim të parë. Shkrimtari/e “rafinuar” nuk e quan personin të pa pëlqyeshëm, por tregon detaje fizike e sjellje të tij të papëlqyeshme. mund të përdorin insinuata, metafora, dykuptimësinë, analogjira, aludime, implikime ose sinjale të pathëna për të përcjellë mesazhin ose për të arritur objektivin. Në këtë mënyrë shkrimtari mirëfabrikon ose jo një realitet, imitim ose

simulim të botës reale. Jo i simulimit në kompjuter por, atij që zhvillohet në mendjen e njeriut. Pyetja është: a gënjën trillimi?

Në njëfarë kuptimi, po. Shkrimtarët përdorin gënjeshtër për të komunikuar gjëra të vërteta. Trillimi nuk është një fotografi,” thotë psikologja Djikic, e cila ka eksploruar psikologjinë e fiksionit në Universitetin e Torontos. “Përkundrazi, është një distilim metaforik i sjelljes njerëzore.”Për të na lundruar në botë të reja një vepër trilluese mbështetet në komunikimin jo të drejtpërdrejtë, indirekt. Por nuk na tregon se ku dhe si të zbarkojmë,” thotë ajo. “sepse vetëm ju e dini se ku duhet të mirërriteni”. Ideja paradoksale se fabrikimi ose trillimi artistik mund dhe duhet të jetë më i vërtetë se ngjarjet reale të jetës mbështetet nga shumë psikologë të kreativitetit. Karakteret në një krijim trillues kanë personalitetin dhe shumë tipare të vetat njëlloj si njerëzit e vërtetë në jetë. Ka një ndryshim: në jetën e përditëshme ngjarjet e komunikimet mes njerëzve kanë një ritëm të ngadaltë, zbulimi i tipareve të njerëzve që të rrethojnë të merr kohë të gjatë. Në jetën reale kemi të bëjmë me kohë kalendarike me rrjedhë lineare kronologjike të ditëve dhe stinëve. Koha në trillim manipulohet nga krijuesi, nuk ruan domosdoshmërisht kohën kalendarike. ecën më shpejt, kapërcehet në kohë për të theksuar disa aspekte të historisë.

Në roman ngjarjet e një jete vijnë brënda një kohe të shkurtër, të ngjeshura në disa minuta apo disa orë, aq sa merr koha e leximit. Mënyra sesi një autor e administron kohën e rrëfimit ndikon ndjeshëm në përvojën e lexuesit, duke ndikuar në ritmin, tensionin dhe ndikimin e përgjithshëm të tregimit. Problemi është sesa i vërtetë, sa interesant, intrigues është realiteti që rrëfehët? Shkrimtari përgatit tekstin ose ngjarjen e imituar, dhe e fton lexuesin që të ulet njëlloj si ulet kandidati për pilot në makinën e simulatorit të situatave fluturuese.

Përjetimi është i ndryshëm sepse varet dhe ndryshon tërësisht në bazë të perceptimit personal. Të vërtetat e botës reale përbajnë gjëra nga më të çuditshmet të mundshme, ndërsa trillimi është i kufizuar brënda mundësive që lejon imagjinata e trilluesit. Nëse diçka e pamundur, jo bindëse ndodh ose përfshihet në një histori trillimi, kjo e bën historinë të vështirë për t’u besuar dhe vë në pikëpyetje vazhdimin më tej të leximit. Rrëfimi mund të mos rezonojë midis rreshtave të jetës së lexuesit. Ama nëse diçka e pamundur ndodh në jetën reale, atëherë është e qartë se nuk paska qënë e pamundur. Jeta reale nuk është e kufizuar apo kushtëzuar nga një rrëfim i fabrikuar, thjesht është.

Nga ana tjetër qëndron argumenti se trillimi, ndryshe nga bisedat faktike mund të zbulojë të vërteta më të thella, më bindëse, me shumë nuanca për natyrën dhe përvojat njerëzore. Të tregon se si është jeta

e dikujt tjetër dhe ty si lexues të mundëson të përjetosh gjëra që nuk mund t’i shohësh apo t’i bësh kurrë. Vjen si një pasqyrë për shoqërinë që na tregon vlerat, difektet e rënda dhe potencialin e saj. Romane si “Proçesi”, “I Huaji”, “1984”, “Përbindëshi”, “Nata me hënë”, “E Penguara” etj, me të vërtetat e tyre rreth mbikqyrjes nga autoritetet shtetërore, represionin shtetëror, autoritarizmin dhe rreziqet e konformizmit, e vënë në dyshim statukuonë dhe parashikojnë realitete alternative realisht.

Mjete si simbolizmi, alegoria dhe metafora ndihmojnë në zbulimin e kuptimeve më të thella të të vërtetave të fshehura të trillimit. Asnjë njeri nuk është i përsosur dhe krijimi i personazheve me të meta, shpesh shumëplanëshe, në konfliktet e brëndëshme të karaktereve, me pika të forta dhe të dobëta i duhet shkrimtarit për të eksploruar nuancat e gjëndjes gri të përvojave njerëzore. Në krye të shkrimit shtrova pyetjen se çfarë tip personaliteti ka trashëguar lexuesi. Sepse lexuesi mund të jetë tip empatik apo simpatik dhe ky fakt kushtëzon reagimin emocional të lexuesit gjatë leximit.

Empatia është një kombinim i dijes (mendjes) me ndjeshmërinë (ndjenjat). Mendoj se ka rëndësi të dorës së parë të mbahet parasysh se empatia është tipar i lindur te njeriu dhe që ka nevojë të zhvillohet me rritjen.

Termi “empati” nënkupton aftësi për të kuptuar një person tjetër nga këndvështrimi i tij dhe jo nga këndvështrimi juaj - me fjalë të tjera, për të vënë veten në vendin e tij. E thënë thjesht, simpatia është ndjenja për dikë, ndërsa empatia është ndjenja me dikë. Tip personaliteti simpatik do të thotë të ndjesh keqardhje dhe dhëmbisuri për dikë që po kalon një kohë të vështirë. Dashamirësia e tipit simpatik mbetet deri te keqardhja, nuk prirret me tej drejt njehsimit me karakterin fatkeq në tekst. Nuk arrin nivelin e lexuesit empatik. Jo më kot thuhet se një nga pikat më të forta të trillimit qëndron në aftësinë e tij për të nxitur empatinë, njehsimin në ndjeshmëri të lexuesit me karakterin. Empatia është “Injektori përndezës” që e pasuron personalitetin e njeriut.

I zhytur në një botë imagjinare, lexuesi e shikon jetën nga këndvështrimi i karakterit. Nëse lexuesi nuk bëhet njësh me karakterin, që për humbjen e një të dashuri të vuajnë sëbashku, nuk është në ndjeshmëri me karakterin që përballet me diskriminim, talljen, racizmin, dmth nuk mund të zhvilloj aftësinë për të kuptuar të tjerët, atëhere ka dy mundësi. Ose nuk është tip empatik, natyra nuk e ka pajisur me dhuntinë e “injektorit përndezës të ndjenjave”, ose shkrimtari nuk ka arritur t’i japë lexuesit një histori të mirëfabrikuar. Tregojnë për një rast ku dikujt i shkon një mik, hapet dera, përmallen dhe, kur ulen miku e pyet: “ah, qënke vetëm”?. “Jo, tani që erdhe ti jam vetëm”, dëgjoi dhe kuptoi se zotëria i shtëpisë kish qënë duke lexuar diçka shumë interesante.

Psikologët bashkohen në interpretimin se, arritja e të qenit në ndjeshmëri me personazhin është momenti kur lexuesi është i hapur, intuitivisht ka pranuar të dalë nga realiteti i përvojave të veta dhe përfshihet ose zhytet në realitetin e historisë të cilën e interpreton përmes syve të të tjerëve. Kjo fazë zhytjeje në ndjeshmëri shënon fillimin e zbulimit të vetes, procesin e hapjes ndaj të tjerëve mbasi historitë e trilluara që po lexon rezonojnë thellë me jetën e tij, përjetohen episode keqkuptuese, xhelozish, zilish, lakmive, mosmirënjohëse, etj, ku shpesh has reflektime vetjake penduese për qëndrime dhe sjellje që e turpërojnë ose e bëjnë krenar. Lexuesi në këto situata ndjesish shtrëngon nofullat ose mbyll sytë, ia largon vetes, nuk i do në mendimet e tij, e zemërojnë dhe e mendojnë psikologjikisht, ndihet i/e turpëruar në sytë imagjinare të të tjerëve, s’i mbetet veçse të kuptojë se e keqja, djalli është brënda tij. Sepse do s’do, emocionet që ato

ngjallin në fazë ndjeshmërie mund të jenë po aq të forta e mbase më gërvishëse e brerëse psikologjikisht sesa ato të shkaktuara nga ngjarjet e jetës reale.

Ka gjëra të jetës njerëzore që janë aq të gabuara e aq të neveritshme sa s'mund të mos i kategorizosh si të pabesueshme, fantazira. Në botën reale njeriu bashkëjeton i familjarizuar me to, të cilat brutalisht, në mungesë totale të etikës humane i imponohen njeriut prej llojit të vet, nga një njeri tjetër e që s'i mbetet zgjidhje tjetër veç t'i besoj e t'i pranoj. Leximi i rrëfimeve të mirëfabrikua e bëjnë njeriun lexues të ndryshëm në thelb nga të tjerët. Të ndryshëm sepse e vendos në raport të singertë me të vërtetën e tij dhe të të tjerëve. Vështirë të manipulohet, fiton besim te vetja i "armatosur" me guximin që të jep e vërteta reale. E vërtetë që e shikuar nën optikën e letërsisë së mirëfabrikuar nuk është thjeshtë një mbushje kohe ose "arratisje" nga konvencionaliteti i përditshmërisë, përkundrazi është energji e fuqishme rritjeje mendonjëse. Nuk ka dyshim, thotë Doris Lessing se, letërsia e mirëfabrikuar është më e mira formë në shërbim të së vërtetës.

Nën këtë domethënie, romanet filozofik "I huaji" i Camus ose "Krim dhe Ndëshkim" i Dostojevskit, "Shkretëtira e tartarëve" i Buxatit, "Dimri i vetmisë së madhe e Nata me hënë", vëllimi "Zhurma e erërave të dikurshme", "Pallati i ëndrrave" të shkrimtarëve tanë, etj, por jo te "Alkimisti", kanë qënë ato ku si lexues jam përballur në mënyrë të pamëshirshme me dilemat, instiktet kriminale, konfliktet e brendëshme të karaktereve, dramat dhe të vërtetat e tragjedive më të mëdha të jetës. Kam ndërjër ose përjetuar paradoksin e të vërtetave të mbështjella brënda tregimeve se, brënda rrethit familjar, miqësive, rrethit shoqëror ku punojmë, ka shumë gjëra që janë të pabesueshme, që janë aq të gabuara sa duket të jenë pjellë fantazie, që janë aq të neveritshme sa duhet të kufizohen si të pamohueshme brënda një libri, shumë komplekse, më të thella e intriguase sesa vetë realiteti. Kur mes miqsh kam shprehur keqardhjen që disa prej këtyre romaneve më erdhën vonë në moshë, nuk jam i sigurtë sesa ata e kanë kapur thelbin e domethënies në raport me "të vërtetën e rritjes e të ndryshimit". Nuk e di sesa janë kënaqur ose sa neveri kanë ushqyer kur janë ndeshur me karaktere të cilët i kanë simpatizuar ose urryer, sipas kujtimeve dhe ndjenjave të përjetuar gjatë të përpjetës në jetën e tyre. Kjo s'është në dorën time. Në respekt të së vërtetës duhet të pohojmë dhe të pranojmë dashamirësisht se nuk duhet të ushqejmë animozitet ndaj shkrimtarit që na e dhuron një tregim të mirëfabrikuar, të cilin nuk e kuptojmë dhe nuk e interpretojmë dot jo për faj të tij. Fatkeq është lexuesi që nuk ka aftësinë apo mundësinë e lindur që të çfaq Empati, të jetë i hapur për ndryshim gjatë leximit. Gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut kisha konstatuar se shumica e kolegëve me të cilët komunikojë e mbyllnin telefonin gjatë natës. Nënkuptimi që përcillej ishte i qartë: Keq më vjen, por mos më shqetëso. Ia lejonin vetes këtë komfort. Mbeteshin deri te keqardhja apo dhëmsuria për hallexhiun nevojtar. Ndërsa ata vet kur i zinte halli, e çanin telefonin në çdo orë. Një këshillë pacientëve: Besojini atij mjeku që nuk e mbyll telefonin gjatë natës dhe që në praninë tuaj ju ndihmon për të kontaktuar zyrat e mjekëve të tjerë specialistë për datën e ardhëshme të konsultës me të. Ky mjek është tip me personalitet empatik sepse ka kapacitetin ose është i hapur që të identifikohet në ndjeshmëri me situatën tuaj të dhimbshme. Ai ose Ajo e vë veten në pozitën tuaj të vështirë, futet në lëkurën tuaj, është i prirur realisht të të ndihmoj, është tip personaliteti empatik. Sepse Plus kanë një tjetër vlerë të shtuar: janë lexues të kultivuar të më të mirës letërsi të fabrikuar. Fatkeqësisht janë ndër më të paktit.

SIMBIOZA ATË E BIR

(të pathënat e mia)

Nga Leonard Qyteza

Natyalisht dhe biologjikisht, atë e bir në veçanti, kanë lidhje genetike nga e cila në raste jo fort të shpeshta, sjellin edhe lidhje e marrëdhënie të ngushtë në mes tyre, në atë që njihet si simbiozë apo bashkëjetesë e vazhdueshme ndërmejt tyre si lidhje në mes dukurish të afërta apo edhe qasje thujse të njëjtë për çfarë i merr drejtim jeta e tyre intelektuale, në fushën e shkrimeve letrare e historike, të arteve të bukura apo teatrale. Historia njeh plot sish.

Fëmijët mësojnë më shumë duke i parë prindërit e tyre sesa duke i dëgjuar ata - do të thotë, më shumë kapet mësimi sesa mësohet ai.

Prandaj, ne rëndom e kemi ndigjuar atë fjalën e urtë popullore, në shumë treva të vendit tonë: "Bëm baba të të ngjaj"!

"Për ta rritur një fëmijë në rrugën që duhet të ndjekë, udhëto vetë në atë rrugë herë pas here." - thoshte dikur një burrë me mendë (Josh Billings)

E tash, le të kapemi aty në krye të shkrimit, bash te, "Atë e bir".

Shkodra, në jetën e saj qytetare, simbiozën në fjalë, e ka të dukshme në shumë raste, por për qëllim të shkrimit, po përmendë dy shembuj "Atë e bir", në fushën e studimeve historiko-letrare, binomet, Hamdi e Nexhmi Bushati dhe Gjon e Willy Kamsi, personalitete të epërme të kulturës edhe në vendin tonë, madje, edhe tej kufijve të vendit tonë.

Dy fjalë për Atin dhe Birin, si personazhe.

- **Hamdi Bushati** (Shkodër më 1896 - ndërroi jetë më 10 mars 1983) ka qënë një arsimtar, përkthyes dhe hulumtues i folklorit, toponimisë dhe historisë. Vepra e tij *"Shkodra dhe motet"* në tre vëllime, mundëson informacion të dendur mbi vendlindjen, u botua pas vdekjes. Po të njëjtin fat, pat edhe vepra tjetër "BUSHATLLINJTË" që mbeti në dorëshkrim. Ka përkthyer disa vepra xhepi të Sami Frashërit nga turqishtja në shqip, të botuara më 2004; shumë përkthime të tjera që ka bërë nga turqishtja në shqip janë ende në dorëshkrim.

- **Nexhmi Bushati** (Lindi në Shkodër më 1931 - ndërroi jetë 25 mars 2024)ka qënë mësues herët, që në vitin 1948, më pas, në vitin 1958 mbaron U.T Fakultetin Histori-Filologji në degën gjuhë letërsi dhe jep mësim deri në daljen në pension, në shkollat e mesme të qytetit të Shkodrës. Ka ndihmuar në plotësimin, sistemimin dhe redaktimin e monografisë 3 vëllimshë "Shkodra dhe motet" dhe "Bushatllinjte", vepra të atit të tij.

- **Gjon Kamsi** (Shkodër 1894-1992) ekonomist i naltë, ka qënë mik dhe bashkëpunëtor i Luigj Gurakuqit, At Gjergj Fishta dhe shumë personaliteteve të tjerë. Veprimtaria e tij ashtë zhvilluar kryesisht në gjysmën e parë të shekullit XX në Shkodër, në Tiranë dhe Bari të Italisë, ku botoi në vitin 1940 vëllimin me poezi "Vjersha" të Luigj Gurakuqit.

Burrë me karakter të papërkulur dhe me ndjeshmëri të rrallë qytetare, botoi shumë artikuj dhe studime por la mjaft dorëshkrime që sot përbëjnë një dëshmi të historisë së qytetit të lindjes.

-**Willy Kamsi** (Lindi në Bari, 17 dhjetor 1926 - ndërroi jetë në Shkodër, 24 janar 2017), ka qënë arsimtar, bibliograf, publicist, albanolog dhe diplomat shqiptar. Krahas punës ndër biblioteka Willy Kamsi është marrë edhe me studime historike dhe bibliografike. Ka botuar një seri artikujsh, ka përkthyer vepra dhe ka disa punime të gatshme për botim.



Pasi ceka dy shembuj të jashtëzakonshëm të asaj që më sipër e quajta simbioza - Atë e bir, - dy vehte , që në Shkodër kanë bërë histori familjare në fusha thujse të njëjtë, por nga qasje të edukimit të tyre shkollore e kulturor, të traditës familjare dhe të përkushtimit për të shkuar te e verteta shkencore dhe historike.

Breza të rinj e të reja në Shkodër por edhe ato që janë edukuar në shkollat apo në Universitetin e saj, kanë njohuri të mjaftueshme por edhe ndoshta njohje personale me këto njerëz të shquar shkodranë.

Unë, nuk jam njëri nga ato të rinj e të reja, që i njoha të sipërcituarit nga shkollimi në qytetin tim të Shkodrës, as njohje të afërta personale, por i njoha nga librat e tyre dhe rrezatimi që ato patën në jetën e përditëshme të qytetit tonë.

Njohjet filluan gjithmonë nga Ati, bie fjala, si e njoha Hamdi Bushatin?.

E njoha nga librat.

Vite má parë, lexova një libër të pa ndigjuar kurrë -"Frat i pashallarëve Bushatli të Shkodrës" (At Erasmo Balneo;1756 -1788), Kronikë e gojddhanë, shkruar nga At Zef Pllumi O.F.M., një botim i rrallë sepse sjell një ditar të mbajtur nga At Erasmo Balneo, gjatë kohës së shërbimit edhe si frat, por edhe si mjek personal, pranë pashallarëve Bushatllinj të Shkodrës. Ai mban datën 22 qershor 1788. Dhe pas rreth 250 vjetësh At Zef Pllumi arriti që ta nxjerrë në dritë këtë vepër që flet për Shkodrën e shekullit të XVIII dhe për rolin e anëtarëve të kësaj familje të shquar shkodrane në historinë e këtij vendi. Librin, nga "kronikë e gojddhanë", dhe letërsi historike, e bëjnë të besueshëm edhe 3 dokumenta shtesë të gjetura në Arkivat e Vatikanit të vendosura në fund të librit si Shtojcë. (Botime Françeskane, Shkodër 2017).

E kështu, nga bukuria dhe narracioni i këtij libri unik, kërshtëria më grishi të kërkoj emërmëdhenjtë, vezir të Shkodrës, të gjysmës së dytë të shekullit të 18-të, kështu mbërrita te libri "BUSHATLLINJTË" me autor Hamdi Bushati (Mësues i Popullit), pajisur me shënime, ilustrime dhe një Suplement nga Nexhmi Bushati, do të thotë, "zbulova", Atë e Bir, por edhe një libër të plotë mbi Shkodrën para pushtimit osman të vendit, mbi Balshajt, mbi rrethimet e Shkodrës, mbi pashallarët e parë që sunduan Shkodrën dhe dinastinë e Bushatllinjëve - vezir të Pashallekut që në historinë tonë kombëtare, njihet gjërësisht si " Pashalleku i Shkodrës" në ndarjen

administrative të Shqipërisë nën sundimin e gjatë turk, ose si Pashalleku i Bushatllijve, që ishin, nga Ati te të birtë, dhe sundua për 75 vjet atë pjesë të Perandorisë turke, si të ishte e tyre. Edhe sot, Shkodra ruan ende si trashëgime të ndertimeve unike nga koha e tyre, objekte me rëndësi historike, Ura, Xhaminë e Plumbit, Banjo turke dhe rrugë të karvaneve, por mbi të gjitha Shqipëria, Biblioteka Kombëtare , ruan në fondin e saj, Bibliotekën e Bushatllinjve, një thesar unik, dokumente historike të pashoqe.

Librat janë si gurët kilometrik, të drejtojnë në udhëtimin tënd të pafund drejt dijes, kështu ndodhi edhe kur pas leximit të librit të atit dhe birit "Bushatllinjte", kalova te një tjetër, te monografia e Stavri N. Naçi "Pashallëku i Shkodrës" në vitet e para të shek. XIX, 1796-1831. E kështu, thelluhu e thelluhu, erdhi libri tjetër me autor Fedhon Meksi "Mahmud pashë Bushati"- Skendërbeu i Ri. Libri është një punim shkencor monografik në fushën e historisë për Mahmud Pashë Bushatin, prijës i pashallëkut të Shkodrës në gjysmën e dytë të shekullit XVIII e politikani i parë që tentoi shtetin e parë të pavarur shqiptar gati një shekull e gjysmë para se ai të shpallej në vitin 1912.

Në këtë rrugëtim si shtysë nga Ati, edhe biri, Nexhmi Bushati nuk rreshti pa studiuar dhe shkruar, libra historik, kritikë letrare dhe së fundi librin e vlerë "Qemal Draçini (njeriu, intelektual, martiri)"-përmbledhje shkrimesh, që ndriçojnë jetën dhe *hedh dritë të re në shumë anë të panjohura më parë të shkrimtarit dhe mendimtarit martir.*

Një tjetër binom simbiozatik në Shkodër janë edhe Atë e bir, Gjon e Willy Kamsi, që poashtu, i përkasin një dinastie familjare të vjetër qytetase të Shkodrës në analet sa patriotike, historike, inxhinierike, letrare dhe bibliografike dhe fetare.

Jeta e Gjon Kamsit (1894-1992) është e pasur me aktivitete patriotike, historike dhe të shërbimit në shtetin shqiptar me detyra të rëndësishme në fushat e ekonomisë dhe në ato bankare. Boton në shtypin kombëtar, brenda e jashtë vendit, shkrime me argumenta të ndryshëm, por kryesisht ekonomik e financiar. Boton të parën biografi të plotë të Luigj Gurakuqit, me qëllim "që të mbahet gjallë kujtimi i të mëdhave tonë".

Sot, ne kemi në duar librin e tij postmortum, "Njerëz dhe ngjarje të lirisë së Shqipnisë", përgaditur për botim nga i biri i tij, i ndrituri bibliotekar, publicist, albanolog dhe diplomat shqiptar, Willy Kamsi. Edhe këtu, simbioza Atë e bir, shkëlqen.

Shtysa e shkrimit.

Një ngjarje në Bibliotekën publike "Marin Barleti" me, 3 maj 2025, kushtuar Nexhmi Bushatit "Intelektuali që e dashunoi Shkodrën" qe arsyeja, nisur edhe përkujtimi i këtij burri në 1 vjetorin e ndarjes nga jeta, referimet dhe diskutimet rreth jetës së tij shumëplanëshe në fushat ku ai kontribuoi, më dha shkas të bëj deduksione te simbioza "Atë e bir".

E për fund, duke u lidhur te koka e shkrimit "Simbioza Atë e bir", duhet të evidentoj shkarazi edhe shembuj të tjerë, njerëz të shquar të vendit tonë në shumë fusha të dijes, të artit, të letërsisë, të muzikës, të inxhiniersisë, të mjekësisë e të tjera, që Atë e bir, kanë shkëlqyer.

Ja disa, gjithmonë sipas meje.

- Kristaq e Edi Rama
- Gjovalin e Egon Gjadri
- Kristo e Gjergj Frashëri
- Mustafa e Ermir Krantja
- Zija e Dritan Çela
- Feim e Etrita Ibrahim
- Kiço e Orjon Gliozheni
- Sadik e Buron Kaceli
- Luigj e Nikolin Gurakuqi
- Avni e Inva Mula

E lista vazhdon, se është shumë e gjatë.

Shkodër me, 10 maj 2025.

Në historinë e kulturës dhe të mendimit shqiptar të shekullit XX, revista *Shêjzat* zë një vend të veçantë, si platformë kulturore dhe intelektuale e shqiptarëve në mërgim. E themeluar në Romë më 1957, e botuar deri më 1975 dhe rishtas më pas nga viti 2016 deri më 2023, ajo shërbeu si platformë e fuqishme letrare, kulturore e politike.

Malli për Shqipninë e humbun, dëshira për ta ruajtur gjuhën shqipe si akt qëndrestarie kundër zhbërjes kulturore; nevoja për një forum të lirë intelektual, ku shkrimtarët dhe studiuesit shqiptarë në diasporë do të mund t'i shprehnin lirshëm idetë e tyre; dëshira për ta vazhduar traditën e kulturës shqiptare në gjirin e kulturës perëndimore, të lidhur me frymën e krishterë, klasiken dhe frymën europiane të dijes; mundësia për t'i bashkuar intelektualët shqiptarë në mërgim dhe shpresa që përmes kësaj reviste të mund të mbillej një farë për brezat e ardhshëm, duke mbajtur të ndezur dritën e kulturës shqiptare në errësirën e kohës, i shtynë Koliqin dhe bashkëkohanikë të tjerë ta themelonin revistën “Shêjzat”, një metaforë poetike për yjet që ndriçojnë në errësirë. Simbolika: ta ndriçoonte rrugën e shqiptarëve në mërgim, si dritë shprese, dijeje dhe kujtese kombëtare.

1. Konteksti historik

Revista u themelua në një kohë kur shumë intelektualë shqiptarë, të dëbuar ose të larguar për arsye politike, kërkonin një mënyrë për të vazhduar veprimtarinë e tyre kulturore dhe për ta mbajtur të gjallë gjuhën, traditat dhe mendimin e lirë. Vetë redaksia, në numrin e parë të saj, në gusht të vitit 1957, nënvizonte se revista po botohej për t'i shërbyer kombit në një kohë rreziqesh të mëdha:

Botimi i kësaj së përkohëshme ka për qëllim të kryemit e një detyre intelektuale kundrejt atdheut shi në kohë kur në kuadrantin e historis grepat po shënojnë një ças rreziku jetëshues.¹

Synimi i “Shêjzave” qe, pra, ta nxirrte popullin shqiptar nga një varfëri shpirtnore, që e kishte pllakosur atë nën kthetrat e ideologjisë rrafshuese komuniste (“nji tyrani, djallëzish të maskueme me ngjyrat ma terhjekse”), e cila, duke e varfëruar atë ekonomikisht po e bënte të varur politikisht e të nënshtruar shoqërisht. Si çdo të nënshtruar pastaj po ia varfëronte edhe shpirtin, doket e zakonet, duke e tjetërsuar atë në një qenie të pidentitetit:

Shqiptarizmi kercnohet në palcë nga nji robni dermuese, deri tashti e panjohun, e cila i rrëmben Shqiptarit lirit fillore të njeriut... të drejten me besue në Zotin dhe me rritë fmijt në hir të dokeve stërgjyshore.²

Në këtë kuptim, *Shêjzat* ishin si një “Shqipëri e vogël e lirë” letrare e kulturore. Ato lidhen me një njeri, Ernest Koliqin, e me një mall, atë për Shqipninë. Sikur dihet, poetika e Koliqit qe poetika e mallit dhe këtë ai e monumentalizoi në revistën që e themeloi vetë. Koliqi i konceptoi *Shêjzat* si një revistë kulturore kombëtare e si alternativë të lirë kundër izolimit ideologjik, në një kohë kur Shqipëria ishte e mbyllur nën regjimin komunist dhe liria e mendimit ishte e shtypur. Koliqi e mbikëqyri personalisht çdo numër të revistës, duke përzgjedhur dorëshkrimet, redaktuar tekstet dhe vendosur tonin e saj intelektual.

Revista ishte, prandaj, pasqyrim i shpirtit të Ernest Koliqit: një përzierje e erudicionit klasik, ndjeshmërisë artistike, katolicizmit të butë, dashurisë për gjuhën shqipe dhe një qëndrimi të përmbajtur por të qëndrueshëm antikomunist. Koliqi nuk qe vetëm redaktor. Ai ishte arkitekti i frymës së revistës, e cila në çdo faqe mbante gjurmën e stilit, vlerave dhe vizionit të tij.

¹ Shih tekstin paraprijës: *Mbas udhëheqjes së Shêjzave*, nr. 1., 1957, fq. 1-2.

² Po aty.

Përkujtohet në Prishtinë datëlindja e Ernest Koliqit

“Shêjzat” - monument kulture e atdhedashurie

Nga Vehbi Miftari

Më datë 20 maj 2025, në ambientet pranë katedrales “Nënë Tereza” në Prishtinë, te biblioteka që mban emrin e Ernest Koliqit, u përkujtua ditëlindja e këtij të fundit, në një aktivitet ku folën don Lush Gjergji, studiuesi dhe diplomati Vehbi Miftari si dhe, në emër të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Andreas Dushi. Me këtë rast, u realizua edhe aktiviteti i parë i përbashkët mes Bibliotekës Kombëtare dhe Bibliotekës “Ernest Koliqi”, pas nënshkrimit të një memorandumit mirëkuptimi pak ditë më parë. Ky aktivitet ishte ekspozita, për herë të parë, e një pjese të koleksionit të revistës “Shêjzat”, ekspozitë e cila qendroi e hapur për dy ditë me radhë.

Në vijim, *lectio magistralis* i mbajtur nga Miftari dhe përshëndetja e Dushit, gjatë së cilës u kujtua edhe Willy Kamsi, bibliografi që rregjistroi pasuritë bibliografike të periodikëve kryesorë kulturorë shqiptarë.

Revista shërbeu si një urë lidhëse mes intelektualëve shqiptarë të diasporës dhe atdheut të tyre të izoluar. Ajo botoi artikuj historikë, ese mbi gjuhën shqipe, studime folklorike, analiza letrare dhe poezi. Nëpërmjet saj, u përcuan ide të rëndësishme për identitetin shqiptar, për lidhjen me rrënjët, por edhe për hapjen ndaj botës moderne. Revista botoi krijime letrare të autorëve më të shquar shqiptarë të kohës, veçanërisht të atyre që jetonin jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, iu krijua hapësirë analizave të thella mbi klasikët e letërsisë shqipe, si edhe përkthimeve të autorëve evropianë, duke kontribuar kështu në ndërlidhjen e letërsisë shqipe me atë botërore.

Përmbajtja e saj përfshinte kryesisht ese dhe studime letrare (për autorë shqiptarë dhe të huaj); poezi (të reja dhe përkthime); prozë artistike (tregime, novela, fragmente romanesh); studime historike dhe albanologjike; kritikë letrare; përkthime nga letërsia botërore; kronikë kulturore (informacione për ngjarje në diasporën shqiptare dhe zhvillime kulturore); shkrime politike (shpesh kundër regjimit komunist të kohës në Shqipëri)

Çështjet kryesore qw shtronte revsita qenw origjina e shqiptarëve dhe teoritë ilire; vepra dhe roli i Skënderbeut; historia e Kishës Katolike në Shqipëri; Rilindja Kombëtare shqiptare; gjuha shqipe dhe dialektet; folklori dhe epika shqiptare.

2. Ndikimi i “Shêjzave” në mendimin kulturor dhe politik shqiptar

Qëndrimet e Koliqit dhe të rrethit të tij kulturor qenë qartësisht kundërshtuese, si në planin ideologjik, ashtu edhe në atë kulturor. Rrethi i “Shêjzave”, me në krye Koliqin, u pozicionua fuqimisht kundër shtypjes së mendimit të lirë dhe kontrollit të rreptë ideologjik që regjimi komunist imponoi mbi artin dhe letërsinë, dënoi falsifikimin e historisë kombëtare nga regjimi dhe metodat e dhunshme me të cilat u përdoqën intelektualët dhe kleri dhe kundërshtoi interpretimet ideologjike të kulturës shqiptare dhe përpiqeshin ta ruanin autenticitetin kombëtar. Ata theksonin rëndësinë e fesë, traditës dhe identitetit të thellë kulturor shqiptar. Kwsisoj, “Shêjzat” shërbyen si një platformë kulturore ku mërgimtarët shqiptarë ruajtën dhe zhvilluan identitetin kombëtar në liri, veçanërisht në Itali. Asaj i atribuohet roli i rëndësishëm i afirmimit të letërsisë shqiptare moderne në mjedisin kulturor evropian.

Prandaj, sot kur shënojmë përvjetorin e Koliqit dhe “Ditën e Bibliotekës”, e cila mban emrin e tij, e themi pa ndrojtje: ndikimi i “Shêjzave” në mendimin kulturor dhe politik shqiptar ka qenë i thellë dhe shumëplanësh. Në rrafshin kulturor ajo ndikoi veçanërisht në: ruajtjen e identitetit kombëtar në mërgim dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore shqiptare përmes letërsisë, historisë, folklorit dhe kritikës



letrare; ofrimin e hapësirës për shkrimtarë dhe studiues të mërgatës, si: Martin Camaj, Arshi Pipa, Aleksandër Xhuvani, Karl Gurakuqi etj.; lidhjen me qarqet kulturore italiane dhe europiane dhe ruajtjen e gjuhës dhe pasurisë letrare shqipe, duke e kultivuar shqipen standarde por edhe dialektet, duke respektuar shumëllojshmërinë dhe pasurinë gjuhësore të kombit.

Ndikimi i “Shêjzave” në mendimin politik shqiptar qe po kwshtu i dukshwm. Pa qenë organ politik në vetvete, “Shêjzat” arritwn tw përçonin refuzimin e qartë ndaj ideologjisë përmes një qasjeje kulturore dhe shpirtërore që nënkuptonte lirinë, fenë, dhe individualitetin. Anwtarwt e saj arritwn qw ta krijonin një “Shqipëri tjetër” në diasporë, duke ofruar alternativë ideore ndaj propagandës së regjimit. Revista ndikoi në vetëdijen politike të shqiptarëve në mërgim, duke mbajtur gjallë kujtesën historike, identitetin kombëtar dhe idenë e një Shqipërie të lirë. Megjithëse nuk promovonte një ideologji të caktuar politike, fryma e “Shêjzave” ishte thellësisht pluraliste dhe antitotalitare, duke u bërë një bërthamë për mendimin demokratik shqiptar në përfundim.

Në këtë mënyrë, “Shêjzat” mbetën një urë mes trashëgimisë shqiptare tradicionale, kulturës europiane dhe aspiratës për një Shqipëri të lirë e demokratike, një monument kulture e atdhedashurie e rrallë, e krahasueshme ndoshta vetëm me “Hyllin e Dritës”. Ajo nuk ishte thjesht një revistë letrare; por një mision kulturor, një platformë për ruajtjen e shpirtit shqiptar në mërgim, dhe një shembull i shkëlqyer se si kultura mund të mbijetojë dhe të lulëzojë edhe në kushte të vështira politike.

TAKIME KULTURORE

Pena e Dritës

FTESË

Në ditëlindjen e Ernest Koliqit shënojmë

Ditën e Bibliotekës

Lectio Magistralis

Prof. Dr. Vehbi Miftari
“SHÊJZAT” – Monument kulture e atdhedashurie

Ekspozitë

Ekspozitë e koleksionit të revistës “SHÊJZAT” – nga Fondi i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, kuruar nga Andreas Dushi

Dita e Bibliotekës do të shoqërohet me një program artistik

E martë, 20 maj 2025, në orën 19:00 | Biblioteka “Ernest Koliqi” Prishtinë

Prof. dr. Anton Nikë Berisha është autor i dhjetëra e dhjetëra veprave letrare dhe studimore. Mbi të gjitha është njeri i mirë e i thjeshtë me një kulturë të gjerë, një mik i sinqertë e pastaj një intelektual me përmasa mbarëkombëtare, profesor, poet, prozator, përkthyes letrar e studiues i mirëfilltë, i nderuar nga autoritete shkencore e letrare shqiptare e më gjerë.

Diskursi i tij letrar e studimor është i gdhendur, i thellë, i skalitur e efektiv. Ky nivel arrihet, sigurisht, falë talentit, përkushtimit krijues dhe vetëdijes së lartë për misionin e fjalës së shkruar, por Anton Nikë Berishën si shkrimtar e studiues dhe posaçërisht si intelektual e karakterizon edhe guximi për ta thënë troç atë që mendon dhe ndien, në të gjitha rastet dhe rrethanat.

Profesori ka mbaruar studimet në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, Dega Gjuhë e Letërsi shqipe, pastaj studimet e rregullta pasuniversitare pranë Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe doktoratën shkencore po ashtu në Zagreb (më 1981). Realizoi tri qëndrime studimore në universitetet e Gjermanisë si bursist i DAAD-së dhe i Fondacionit “Alexander von Humboldt”.

Ka punuar disa vite në Institutin Albanologjik të Prishtinës, pastaj në Universitetin e Mynihut dhe në Katedrën e Letërsisë Shqipe –të Fakultetit të Letërsisë dhe të Filozofisë të Universitetit të Kalabrisë.

Ka mbajtur mësim në disa universitete të Evropës, po dhe në universitetin e Prishtinës, Tiranës, Shkodrës, Korçës, Elbasanit, Vlorës etj.

Një punë të rëndësishme ka bërë dhe në fushën e përkthimeve letrare nga disa gjuhë.

Për veprën e tij letrare dhe shkencore janë botuar deri më tani 21 libra e studime nga autorë shqiptarë dhe italianë.

Për kontributin e tij të madh, Anton Nikë Berisha, është shpërblyer me disa çmime. Po përmend vetëm Shpërblimin e dhjetorit të KSA të Kosovës, shpërblimin “Beqir Musliu”, Medaljen Presidenciale të Meritave të Republikës së Kosovës, Dekoratinë Nëna Tereze të Kryetarit të Republikës së Shqipërisë dhe Çmimin kombëtar letrar për vepër jetësore “Azem Shkreli” të Ministrisë së Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës (për vitin 2023).

Me veprat e tij, të botuara e të ribotuara, gjatë gjashtë dekadave të kaluara, Anton Nikë Berisha, jo vetëm se e pasuroi opusin krijues të tij, por gjithsesi edhe letërsinë tonë shqiptare. Ai theu kufijtë gjeografikë, krahinorë e ideologjikë, duke u prezantuar si një studiues me integritet të plotë.

Kompleti i studimeve letrare të zgjedhura në 10 vëllime që doli këto ditë nga Shtëpia Botuese “Faik Konica” e Prishtinës e dëshmon mirëfilli punën e tij të pasur e serioze në fushën e studimeve letrare.

Në Fjalën paraprake të këtij kompleti prof. Antoni shkruan pos të tjerash: “Në vitin e largët – 1968, në revistën atëherë të shquar, “Fjala” të Prishtinës, botova punimin “Analogji e porosive të fantazmave”, ku krahasoja porosinë e fantazmave të tragjedisë “Hamleti” të Shekspirit dhe të “Istori e Skënderbeut” të Naim Frashërit.

Në vitin 1970 botova përmbledhjen me poezi për fëmijë “Kthimi i Skënderbeut në Krujë”, ndërsa më 1978 librin me kritika letrare “Përkime poetike”. Një vit më vonë atë me ese dhe vështrime “Mundësi

BOTIM SHUMËFISH I RËNDËSISHËM Studime letrare (të zgjedhura) të ANTON NIKË BERISHËS në 10 vëllime

Nga Gjekë Gjonaj



interpretimi” (të tria botime të redaksisë së botimeve të Rilindjes).

Në vazhdim botova një varg veprash, qoftë në fushën e studimeve letrare, qoftë romane dhe vepra me përsiatje poetike (poezi).

Në punën time në fushën e artit të fjalës, letërsisë, i jam përmbajtur asaj që thoshte shkrimtari i shquar rus, Anton Çehov: “Të moskënaqurit me vetveten është themeli i çdo talenti të vërtetë”.

Në 25 vjetët e fundit, sidomos gjatë kohës sa punova në Universitetin e Kalabrisë (Itali, nga viti 1993), botova një varg punimesh e studimesh për veprat e letërsisë së arbëreshëve të Italisë, dy studimet monografike për “Mesharin” e Buzukut, studimet për Budin poet e prozator, për Estetikën dhe estetikën e letërsisë, për “Këngën e këngëve”, për “Poetikën” e Aristotelit, për Skiroin, Fishtën, Koliqin, Dushko Vetmon, Martin

Camajn, Azem Shkrelin etj., po dhe për disa vepra të letërsive të tjera si për “Epin e Gilgameshi”, “Pslamet”, “Gjeorgjikat” e Virgjilit, “Silvia-n” e Nervalit, “Princin e vogël” të Ekzyperisë, “Mantelin” e Gogolit, “Sytë e vëllait të përjetshëm” të Cvajgut, “Histori të mërztishme” të Çehovit, për poezinë e poetit italian, Daniele Giancane etj.

Në dy vitet e fundit botova dy vëllime me punime të zgjedhura: “Mbi disa kryevepra të letërsisë botërore (2022) dhe Rreth disa kryeveprave të letërsisë sonë” (2023).


Në këto dhjetë vëllime me studime letrare të zgjedhura kam përfshirë vetëm ato punime – interpretime dhe studime monografike që, sipas mendimit tim, bëjnë pjesën më cilësore të punës sime në fushën e studimit të artit të fjalës, letërsisë, po dhe ku vështrohen disa nga veprat letrare më të njohura në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar. Kam lënë anash, për një arsye ose për një tjetër, një varg punimesh e librash.

Këto punime – interpretime dhe studime monografike janë dëshmi e mënyrave të ndryshme të qasjes dhe të veçimit të cilësive poetike të teksteve të veprave përkatëse; vetëm leximi i vëmendshëm dhe i disa hershëm, njësimi shkallë – shkallë me tekstet dhe me kumtet poetike që dilnin prej tyre, bëri të mundur komunikimin e duhur me to dhe ndriçimin e vlerave kryesore shprehëse poetike.

Në dy vëllimet e para kam vënë studimet për çështjet teorike të letërsisë, të tekstit letrar, të estetikës dhe të estetikës së letërsisë, në vëllimin e tretë ato hulumtuese kërkimore – dy studimet monografike për “Mesharin” e Gjon Buzukut dhe studimin për veprën letrare të Pjetër Budit, për t’u lënë vend pastaj vëllimeve me vrojtime dhe me interpretime për dukuri dhe vepra të autorëve të tjerë”.

Ky botim 10 vëllimesh me studime letrare të zgjedhura dëshmon jo vetëm për punën e rëndësishme dhe cilësore të Anton Nikë Berishës në këtë fushë, po dhe për cilësinë dhe pjekurinë e studimeve tona letrare në përgjithësi.

Botimi “Studime letrare të zgjedhura” do të jetë i mirëseardhur për të gjithë ata që duan të dinë më shumë për çështje teorike të letërsisë, për estetikën e veprës letrare, për veprimtarinë e disa nga shkrimtarët më të shquar – shqiptarë dhe të huaj – për interpretimin e disa nga kryeveprat e letërsisë sonë e të letërsive të tjera.



KAFE NË JUVENILIA

(Kujtimi i fundit me Ismail Kadarenë)

Te Kafe Juvenilia – ora kishte një plagë të fshehtë drite, që pikonte nga balli i Historisë. Ishim pesë vetë, por në tavolinë endeshin pesë silueta të tjera; një e Historisë, një e Lavdisë, një e Penës, një e Pavdekësisë dhe një e Heshtjes - të gjitha në një bronxërim të padukshëm, që madhëstohej e merrte frymë mes nesh. Kadareja nuk fliste, fjalët i dilnin me vështirësi nga goja; kishin ikur, si zogj pa peshë, që kishin kaluar përmes mureve, perandorive, diktaturës heshtjeve familjare dhe hartave që refuzojnë të thinjen. Gruaja ime herë buzëqeshte duke bërë fotografi, herë mbante filxhanin thua se lexonte profecitë nga hijet ballkanike. Dy botuesit pranë, mbanin në vështrim diçka nga e ardhmja e letrës;

një murmurimë dorëshkrimesh të pabotuara dhe romanesh që flenë në raftet e heshtura të natës. Bëmë fotografi. Blici - një prekje përjetësie; çaste që nuk kanë frikë nga vdekja. Pastaj erdhi kafa e hidhur - e hidhur si pemët që rriten pa rrënjë në tokë, si fjalët që duhej t'i fshihehin çensurës për të mbijetuar. Shfletoj librat e tu, si të kërkoj zërin tënd; kurse zëri im humbet në faqet që lamë hapur, në rrugët e pashkelura, në bisedat e pafundme, në kafen e hidhur në një tavolinë pranë liqenit vjeshtor, diku në vendlindjen tonë te kopshti i Luksemburgut apo në Kafe Rostand. Tani që ike, Ismail, karrigia jote mbeti bosh - por zëri yt mbush sallat, zemrat dhe shpella të zeza mërie të fshehtë dije: të përkujtojmë me seriozitetin e ëndrrës, atje ku gjithçka është e mundur - edhe pavdekësia e një pasditeje të thjeshtë në një kafene të Tiranës.

9 prill 2025

Fragment nga poema: KAOS

IV

Këtu nuk ka qiell. Këtu nuk ka kohë. Vetëm rrënoja dhe hi që bie si borë. Kurse fëmijët luajnë me kukulla prej kockash, që kanë për sy dy gëzhoja.

Zjarri nuk është prej bombash dhe flake. Janë zinxhirë të padukshëm sistemi. Janë zyra diplomatike, ministri krimi, kopje e regjistrit me vulë: “vdekje sipas marrëveshjes”.

Këtu digjen marrëveshjet para se të nënshkruhen. Digjen emrat në karvanët e refugjatëve. Digjen sytë që panë vdekjen dhe u mbyllën fort — jo nga gjumi, por nga pikëllimi.

Zjarri ka formë. Klithmë vajtimi. Vesh kostum, mban mikrofoni, dhe premton paqe me faturë vdekjeje.

Në rrugë britmat s'kanë gojë. Flakët ngatërrohen me mjegull mashtrimesh, dhe bota bëhet një zinxhir ku çdo hallkë thotë: “Ligji jam unë, kështu e dua botën!”

Por brenda zjarrit valon një flamur,



Petro Çerkezi

Itineraret e asgjëkundit

një njeri mban një libër. Është Dhjatë Nuk digjet. Është poezi. Është zjarrfikës.

Brenda zjarrit lind një lule e kuqe një grua shtrëngon dorën e birit së saj të vdekur dhe thotë: “jo, nuk do të harroj kurrë, biri im!”

Brenda zjarrit lind një hero një i ri refuzon të marrë armë. Këtu nis mrekullia.

Zbresim më thellë në zjarr jo për të gjetur shpëtim. Por për të shuar flakën e urrejtjes sepse atje, në të kuqen më të thellë të ferrit, klith dhe kalitet kujtesa.

Dhe kujtesa, kur këmbëngul, do të bëhet bërthama fjalësh që ende i përtypin rrotat e tankeve: dhe bombardues të rëndë: jetë, njeri, paqe!

Shkurt 2025

SHKELA NJË LULE

Shkela padashje një lule, një përkëdhelje e thyer nën hapin tim – dhe prilli mori një krisje.

E mora në pëllëmbë, me heshtjen që rëndon më shumë se një britmë. Lule kadife, si psherëtimë lëngimi nga gjoksi i tokës, me kokën varur lamtumirë e trishtë pa fjalë.

Ah, the ti. Vetëm një “ah”, por ajri u shqye, si një letër që nuk mbërrin kurrë tek marrësi.

Shikimi yt u bë pasqyrë reje, dhe befaz... u kujtove për atë zog të rënë nga foleja – si një ligjërim i ndërprerë në mes.

E ngrite me duar të vesitura nga dashuria, e vendose mbi degë – si të mbillje një filiz shprese në trungun e jetës.

Lulja... dhe zogu. Që atëherë, zogjtë këndojnë ndryshe – me ligjërime që tingëllojnë si triumfe, nota pemësh që dirigjojnë stinët.

Shkela një lule, dhe mendova: për ata që kurrë nuk do t'ia ndiejnë aromën, për ata që s'mund t'ia dhurojnë më së dashurës, për ata që i shkelin barbarisht si hiç, për ata që i flakin nga ballkoni

dhe s'dinë ç'është një lule dhuratë, dhe për ata që, me buzëqeshje në shpirt, thonë: “faleminderit... që lulëzove.”

Lëkura e saj – mbeti ngjitur në thembrën time, si një faj që nuk fshihet kurrë: i butë si kënga e zogut, si lot nga sytë e së dashurës.

Prill, 2025

POETI BJOND I PËRMETIT

Mikut tim Bardhyl Londo

Ulur këmbëkryq shkruan mbi shkëmbinjtë e Vjosës, me një cigare në buzë dhe një trëndafil në vesh me duar që kapeshin me vetëtimat, dielli binte mbi flokët e tu bjonde dhe hija jote bëhej urë për ëndrrat që hidheshin mbi humnera.

Poet, mik, bashkëudhëtar, pikturoje një Itakë që nuk e pushtove kurrë. Uji i lumit rridhte, Aaos ushtonte. si mendimet e tua, thellë, në kërkim të deteve të panjohura atje ku dashuria dhe njeriu mbulojnë lakuriqësinë me çarçafë ngjyrë hëne.

Fjalët e tua ishin anije ngarkuar me dritë, errësirë, krisma dhe trandafila, njerëz që përloteshin, dashuri që luftojnë me vdekjen dhe stuhitë, dhe ti, poeti bjond i Premetit, na çove në ranishte plot guacka të thyera me flakërime mirazhesh.

Në brigjet e Vjosës zëri yt dëgjohet ende, era shpërndan të qeshurën si lule qershie, dhe gurët kujtojnë hapin tënd kur shkruaje poezinë më të bukur për dashurinë, sikur të bisedoje me vetë perëndinë.

Tani udhëton pa valiçe e bagazhe, pa letër dhe bojë, ulesh këmbëkryq mes maleve të larta duke thithur cigaren e yllit të mbrëmjes dhe ne vimë pas teje duke qëmtuar fjalë simbole për të ndërtuar Itakën tonë me mbeturinat e hulumtimeve të tua.

Natën e mirë, poeti biond, Vjosa të dha lamtumirën me valët e turbullta, trandafilat e Përmetit që mbolle nëpër libra u bënë një lumë i dytë kurse qershitë presin ndanë udhe të kthehesh që të çelin dhe heshtja jote jehon nëpër zemra si këngë e përjetshme.

2024

PUTHJA

Më jep një puthje, tha ai. Dhe puthja mbeti pezull, si një peshk pa ujë përpëlitur pa frymë në një zall mërzie.

Era e mbështolli si një sferë e padukshme, E fshehu në një çast që nuk erdhi kurrë. Ashtu si streha e kapelës së Melania Trump ishte zgjeruar, po i bënte hije qiellit dhe gëlltiti fytyrën e saj.

i fshehu sytë e qeshur, i fshehu buzët trandafil maji, fshehu mëkatën. Flatër e rrëmbyer nga era.

Puthja mbeti pezull, jetim në një natë pa gojë, një zog pa ligjërim, një celular që nuk do të bjerë më kurrë, mesazh që humbi pa u lexuar.

Shkurt 2025

ITINERARET E ASGJËKUNDIT

Koha si bishë e uritur na ngre gracka, e mira ime dhe s'kemi sy të admirojmë bukurinë (ah, bukuria, e dhunojmë si plangëprishës) nuk janë gracka iluzive, po kthetra vetmish mbi lëkurën e grisur me tatuazhe dhimbjesh forma meduzash me koka gjarpërinjsh që ulërijnë pret një dhe mbijnë shtatë të tjera nga akrepat e orës ngulur në mish si kama gjaku tashmë ujit kopshtin e shkretë të ndërgjegjes me trungje pemësh si statuja të djegura nga zjarri planetar i mëkateve njerëzore nesër në mesditë, tha do ti bie këmbanës në kamanoren bonxore të diellit por atje s'egzistonte këmbanë vetëm katedralet e reve

që shtyheshin nëpër qiell me gjëmime shurdhuese dhe lulekëmbanat që flladiteshin nga era indiferente pa fuqinë transformuese të një rendi të ri pa status mërzie për të vrrarë xhelatin demonjak të frikës do të marr arratinë tha ky truall skëterre s'më mban më

eja të pres thërriste një zë sirene ndoshta nga ana e përtejme e lumit nga anija e Ulisit apo nga bota e përtejme eja të pres të pres të pres ushtonte zëri gaz a vaj i një sirenë (ah sa magjishëm këndonte) me zjarre pasionesh si hi vullkanesh të shuar ditari i padeshifrueshëm i ditëve pa itinerare në mëngjes priste në stacionin e trenit në mesditë u ngjit në ballkonin e një reje në mbrëmje ishte varur në gojën e arushës së madhe duke trazuar prushin e yjeve për të gjetur Itakën e ëndrrës dhe surprizonte të paarritshmen duke numëruar minutat që binin si pika shiu mbi tokën e djegur toka e premtuar e utopisë deti trokiste si sahat pasionesh tik-tak tik-tak si hapa nimfash që kishin braktisur kaltërsitë dhe çapiteshin shkujdesur mbi asfaltë qytetesh eunukë treni që priste i zgjaste shinat mbi ballë hodhi spirancën e kujtesës në ujërat e akullta të adolehencës më nuanca të purpurta dhe fjeti mbi shtratin e zhgjendrrës me itinerare absurde në gjeografinë e asgjëkundit

2024

DESHA TË ISHA SHI

Qiell i murmë Vesonte qetësisht Qëndrova nën një pemë Dhe ëndëroja të isha Shi i beftë

Të të rrëmbeja ombrellën ylberore Të të laja me puthje Të të përqafoja me gishta erërash Në një vals ëndërrimi

Desha të isha një shi i vrulltë
Ardhur në rrugën tënde
Nga ky qiell i largët
Mërgate.

2025

BOTË E PALËVIZËSHME

Kaloi nxitimthi me një përshëndetje të thatë
siç kalon egoizmi krenaria boshe dhe narcizmi
dhe lavdia e zezë dafinë lëkurëvoshkur
në një takim incidental në prag të verës
dhe hyri në oborrin katastrofik
të një agimi tempullor pa ju dridhur qerpiku
me grigjë kuajsh krifëkërleshura
premtimet flatra të thyera fluturakësh
dhe një qiell pa temperament që s'u premtoi
fluturimin
një Minotaur ulërin nga labirinthet mistike
dhe bota zhytur në makthe e zhgjendra
në cilin kënd të mërisë na kanë zënë pritë
një sërë shqetësimesh afatshkurtra
na mbështetën me kurriz
në murin e zbardhur të pasigurisë
qëndroi mes të shtënash dhe buzqeshjesh
ironike
me sytë rebregosur
me kompromiset të ngatëruara dhe biletë
udhëtimi
në xhepin e pardesysë evropiane
maska modelore e një refuzimi digjte me sy
cinikë
kurse heshtja kafshonte fytin e të mundshmes
dhe rezistencën e materies akumuluar
në ngjarje me kode ieroglifesh të padëshifruara
në lëvizje kaotike parashikime bastardësh
të një kohe demode luxuri palaqosh me
papijon
dhe pa me dëshpërim se ishte i rrethuar
nga një botë e palëvizëshme inerte
e vetmja gjë që ndryshon është veshja që i
mbulon.

Vjeshtë, 2024

NË BINARËT E PIKËLLIMIT

Shihte binarët krahë të shtrira në hapësirë
pa asnjë mundësi bashkimi
treni i natës kishte kaluar si bishë e zezë
duke uluritur pa ndaluar në asnjë stacion
ylli i mëngjesit ngrohu sigurinë e tij të vjetër
ndizte cigaret njerën pas tjetrës
thua se donte t'u premtonte edhe pak jetë yjeve
gjithë trenat kishin ikur drejt Oksidentit
kurse ai rrinte ende në stacionin e pritjes
si një murg që e ka braktisur perëndia e vet
me një besueshmëri të panevojshme
i zhytur në falje humbake
mbi paterica iluzionesh të vjetra
ballkoni i një ylli i varej mbi kokë
thua se ishte ylli i fatit që s'donte të emigronte
e të zhdukej pas vargmaleve të një bote tjetër
mbrëmja erdhi duke vozitur krejt vetëm
në një det sigurie inekzistente
njelmësia i digjte buzët e zemrës
mëngjesi po zvarritej si një tren pa orientm
mbi binarët e pikëllimit

IDHULLI I DASHURISË

Idhulli i dashurisë sime jeton nëpër pasqyra
Në ujëra, në re, në puthjet e diellit
Hyjnia e dashurisë sime është e fejuar me
blatime prilli
Mos ja prekni degët, do të lëndoni pafajësinë
Mos i trëmbni zogjtë e ligjërimit, pylli i dehur
do të marri flak
Fytyra e saj dallgëzon një det me pulsime
vetëtimash
Vetmitë e mia shtegtime të çmendura në
hartografinë imagjinare të befasisë
Moshë ime matet me kalendarin ekuatorial të
erosit
Përqaqimi i saj është mitra e kashtës së
kumtërit
Përqaqim vetëtimash, në një trup mikpritës
jaseminësh
Të gjitha portat hapen, peizazhe të pikturuara
idilike
Një mur pasqyrash ku frika thyen kokën
Idhulli i dashurisë ka kujtesë lulërie
Ka tokë ku përjetësia ndërton bazilikan e saj
Dhe një valle rebele që e detyron Akeronin të
ndërrojë shtrat

NËNA QËNDIS

Nëna qëndis në ditë me mjegull
E netë me hënë
Me fije ari dhe fije vetëtimash

Nga gishtat e saj të shpuara
Rrjedhin pika gjaku
Dhe mbijnë zambakë
Gishtat u bënë mikrogrami lëndinash
Mbi peisazhin dimëror

Nëna qëndis
Kopshti hyri në dhomë
Pranvera var kurtinat në dritare
Dielli rri përballë dhe i përkëdhel dliresisht
Pastaj var bandat me drerë e sorkadhe në mur
Dhe një copë behari në tavolinë
Te jastëkët në krevat në baullen e ëndrrës
Dhe në sëndukun e pajës

Vjeshta u zgjua. E shtroi në qilim
Dhe kominezonin e prillit në kurm

Nëna qëndis
Po jashtë shfryn e shkrepëtin
Si t'i përballosh ulkonjat e këtij dimri epokal
Që vetëm një bajame guxon t'i sfidojë

NUSJA E DËBORËS

Pjalmi i luleve
Fustani nusëror i dëborës
Fërgëllon e vërtitet magjishëm
Atje ku shuhet të gjitha ngjyra
Kurse një dorë ngulmuese
Skicon një siluetë të brishtë delikate
Si një nuse dëbore

Shkalla ku kapem për t'u ngjitur
Tek dliresia është prej reje
Reja rrokulliset dhe humbas
Në kataraktin e një zhgjendre

Dita adhuron të kaltrën
Dhe unë ngjitem sërish në qiellin blu
Drejt një horizonti ku verbëron
Dielli mbi dëborë

Fustani nusëror i dëborës i shqyer i baltosur
Eci në një qytet të përhumbur
Mes braktisjes dhe tundimit
Endem në labirinte dedalike
Një vello e argjendë më blatohet
Më thekë brishtësie si thika të kamufluara

Një Minotaur më përgjon
Dhe pergameni i dyshimit pikon
I padukshëm të helmojë çastet
Dita e ngrirë si shkretëtirë boshe
Në retinën e një dite pafytyrë

Borëron në malet e mia
Nën një diell përvëlues
Në zenith të pikëllimit universal
Libri i dashurisë shfletuar vrullshëm
Ka ngrirë monumental në faqen e të ikurve
Nusja e dëborës shkriu
Dhe mbiu një manushaqe e venitur
Dhe pjalmi i luleve spërkat stinët shterpa.

2025

SEFERI NË KORÇË

Në Korçë era sjell kantata mbrëmësore,
pemët pa kujtesë hedhin gjethet
Unë eci rrugëve dhe nuk e di ç'kërkoj
Imazhe hënash të thyera rrokullisen mbi çati,
dhe shiu shkruan me ngjyra të venitura
në muret e konsullatës së mbyllur.

Seferis ecën me një dritë letre mirësie,
Ku është? Si ta kapim ylberin që i rri mbi supe,
Si ta kapim rrufenë që nuk ka fole
mes pemëve që pëshpërisin vargje,
në rrugët që përkulen për ta dëgjuar
pulsime zemre vjeshtrave të përfllakura.

Një natë e mermertë qëndron para tij,
një mal gjigand na bllokoi kujtesën
e frikshme harresa statujë që fshin çdo gjurmë.
Kurse ai shkruan me vështrimin e hidhur,
një vijë blu mbi malin e Moravës.

Një diell i plasaritur noton në gotën e tij,
në një kafene që nuk ka çati,
në një oborr ballkanas që nuk ka horizont
dhe tingujt e fjalëve luajnë fshehurazi
me kalimtarë të pushtuar nga letargjia.

Korça zgjohet si një poezi e vjetër
si një dashuri që shkrepëtiu vrullsem dhe u
harrua.
Dhe Seferis, statujë dhe njeri endet atje,
largohet në heshtje, duke lënë pas si vegim
një trandafil hënë, një tingull nostalgjik lire
dhe hapa, manushaqe malli mbi dëborë.

KONFERENCA “ARSIMI KATOLIK NË TREVAT SHQIPTARE”

Në ambientet e universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë”, zhvillon punimet konferenca “Arsimi Katolik në Trevat Shqiptare”, organizuar nga Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar. Në këtë konferencë, preken çështje shumë të rëndësishme nga pikëpamja historike dhe ajo e prespektivave të edukimit përballë sfidave të djeshme, të sotshme e të nesërme.

Synimi kryesor i konferencës mbete vënia në dukje e kontributit që shkollat e krijuara pranë kishave kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë në formimin e shoqërisë shqiptare, duke ruajtur të paprekur misionin parësor: formimin e individit për të krijuar identitetin vetjak brenda kombit të tij.

Në këtë konferencë marrin pjesë studiues nga disa institucione akademike si Akademia e Shkencave, Universiteti i Tiranës apo Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Në vjeshtë, organizatorët do të kujdesen që të gjitha aktet e konferencës të botohen në një vëllim të veçantë, i cili do të ofrohet në dy formate, online dhe i shtypur.



KONFERENCË

Arsimi Katolik në Trevat Shqiptare

Historia, ecuria dhe sfidat

24 maj 2025 | Ora 10:00

Universiteti “Zoja e Këshillit
të Mirë”, Tiranë

Më kujtohet se në vitin 1933 Virginia Woolf ishte ftuar të kalonte natën në shtëpinë e kushëririt të saj të parë, H. A. L. Fisher, që atëherë ishte drejtues i New College. Zonja Fisher më tha se nuk e kishte shumë për zemër, pasi e konsideronte disi arrogante, por Herbert Fisher-i kishte një vlerësim të madh për të, përveç lidhjes së afërt familjare. Darka u shtrua në banesën e drejtuesit dhe të pranishëm, përveç mysafires së nderit dhe mikpritësve – z. dhe znj. Fisher – ishin edhe John Sparrow, asokohe anëtar i All Souls (ashtu si edhe unë), Richard Crossman, për të cilin znj. Fisher kishte shumë simpati, C. S. Lewis, që nuk e duronte shoqërinë e grave dhe nuk i pëlqente veçanërisht shkrimtarët, si dhe një pedagog i letërsisë klasike nga Brasenose College, i quajtur Alan Ker që, në mos gaboj, ishte mik i familjes Fisher.

Virginia Woolf, që ishte pa dyshim gruaia më e bukur që kisha parë ndonjëherë – atëherë e ndoshta edhe më vonë – dukej tepër e shqetësuar dhe e hutuar; nuk është se përplasej me mobilitet, por lëvizte drejt tryezës me një pasiguri të dukshme. Unë isha ulur në të majtë të Fisher-it, ajo në të djathtë e tij. Zonja Fisher, e rrethuar nga Crossman-i dhe Lewis-i, qëndronte në skajin tjetër të tryezës. Mary Fisher (që më vonë u bë zonja Bennett), vajza e Fisher-it, e cila ra plotësisht nën magjinë e kushërirs së saj, si edhe shoqja e saj Rachel Walker, ishin gjithashtu të pranishme.

Zonja Woolf dridhej nga nervozizmi dhe kur fqinji i saj në tryezë, pedagogu nga Brasenose, e pyeti nëse edhe zoti Woolf do të vinte, nuk u përgjigj fare. Me sa duket, arsyeja ishte se Leonard Woolf-i ishte i bindur se Fisher-i kishte qenë, të paktën pjesërisht, përgjegjës për shpikjen e “Black and Tans” për të shtypur kryengritjen irlandeze të vitit 1921 dhe ai nuk pranonte të ndodhej në të njëjtën dhomë me një anëtar kaq të lig të kabinetit të Lloyd George-it.

“Bën ndonjë shtëtitje, Virginia?” - e pyeti Fisher-i disi me dëshpërim.

“Po, bëj. Jo shumë në Londër. Më tepër në fshat”.

“Çfarë të bie më shumë në sy kur shtëtit?”

“Mendoj... më së shumti dhitë në shpatet e kodrave, duken kaq kishtarë”.

Ndërkohë, në anën tjetër të tryezës, shoqëria fliste me zë të lartë se sa shumë u pëlqente Uppingham-i (nuk garantoj saktësinë e kujtesës sime për fjalët e thëna). “Mua më pëlqejnë shkollat me shpirt të fortë, - tha Crossman-i, - jo ato me njerëz të lëbyrshëm e të artit – kur isha në Winchester kishte disa, por jo shumë. Eton-i, natyrisht, është shumë më keq”. Znj. Fisher, mendoj, ra dakord.

Lewis-i tha se e kishte të vështirë të jepte mësim tek introvertët në Magdalen. “Të lëbyrshëm e të dhënë pas artit, shumë mirë the: Betjeman, Pryce-Jones – kuptova se nuk kishin aspak një kuptim të vërtetë për prozën apo poezinë, qoftë moderne apo klasike, u ndjeva shumë i lehtësuar kur u larguan”.

Zonja Woolf u tendos nga toni, zëri i lartë dhe ato që po thuheshin, dhe Fisher-i u përpoq me shpejtësi të ndërhynte. Filluan të flisnin për njerëz që kishin njohur, për udhëtime në Itali dhe gjëra të ngjashme – nuk mbaj mend çfarë thanë vajzat e reja. Pastaj kaluam në sallinin e pritjes, ku ishin mbledhur jo më pak se dyzet a pesëdhjetë studentë dhe të diplomuar të New College-it, të konsideruar të përshtatshëm për të parë dhe për të dëgjuar shkrimtaren e madhe.

Ajo qëndronte përpara tyre, e heshtur, e tendosur, me shikimin ngulitur në një pikë të largët, e paafte të nxirrte zë – ishte pak si një ekzekutim, ose ndoshta si një peshkop tepër i ndrojtur, gati të bekonte një klasë djemsh shkollorë apo studentësh. Më në fund foli.

“Ka ndonjë këtu që ka lexuar Jane Eyre?” - tha ajo, duke parë nga tavani, pastaj nga

Tri orët e mrekullueshme në praninë e Virginia Woolf-it

Nga Isaiah Berlin

dritaret, duke u përpjekur të mos shikonte askënd në fytyrë. Një djalosh ngriti dorën. “Mund të ma tregoni subjektin?” - tha zonja Woolf.

Djaloshi bëri ç’mundi, iu deshën rreth dhjetë minuta për ta përshkruar. “Po Lartësitë e stuhishme, e ka lexuar ndokush?” Përsëritja e së njëjtës procedurë. “Po Guri i hënës?” Edhe atë e kishte lexuar dikush.

“Ju pëlqen të lexoni romane detektivësh?” - pyeti ajo. Për këtë pati përgjigje të përziera. Pastaj, dukshëm e rraskapitur, tha: “Nuk mund të vazhdoj të flas kështu, më vjen shumë keq. Le të përzihemi si qenie njerëzore.”

Dhe kështu bëmë.

Ishte afër orës dhjetë kur zonja Fisher njoftoi se po shkonte për të fjetur, porse ata që dëshironin mund të qëndronin. Fisher-i e pyeti zonjën Woolf nëse i pëlqente Handel-i, Mozart-i, Haydn-i, Beethoven-i. Ajo tha se i pëlqente të gjithë. “Ç’tjetër shije kaq katolike!” - tha ai.

Pas kësaj u shpërndamë në grupe të vogla dhe ajo bisedoi me shumë dashamirësi në një cep me dy a tri vajza të reja – ndoshta edhe me kushërirën e saj, Mary-n – dhe më pas të gjithë shkuaam për të fjetur.

Shumë më vonë, mendoj në vitin 1938,

zonja Woolf më ftoi për darkë në shtëpinë e saj në Tavistock Square. Në kartolinën që më dërgoi, ajo shkroi: “Nëse troket në derëzën time gri, do të ta hap unë.”

Përveç meje, të vetmit persona të pranishëm ishin Leonard-i, Ben Nicolson-i dhe Sally Graves, mbesa e Robert Graves-it, që atëherë ishte e martuar si zonja Chilver, e cila më vonë u bë drejtore e Lady Margaret Hall në Oksford – zonja Woolf, siç dukej, kishte një pasion për të dhe e kishte marrë në pyetje (siç më tha vetë zonja Chilver) për të kuptuar nëse kishte shumë dashuri të lirë mes të rinjve: a njihej lezbizmi? Dhe të tjera si këto. Më duket se ajo duhet të ketë marrë në pyetje edhe mbesat e saj për këto gjëra – kishte ndjesinë se dinte shumë pak për botën bashkëkohore në Angli.

Filloi të përshkruante një vizitë te një nga princeshat mbretërore – mendoj se ishte princesha Beatrice – që kishte bërë në studion e Duncan Grant-it, dhe sa e këndshme kishte qenë kjo ngjarje. Leonard-i, i cili me dorën që i dridhej po përpiquej të ndizte sobën me gaz, tha: “Nuk e kuptoj pse të duket e tillë – familja mbretërore është tamam si gjithë të tjerët, nuk ka asnjë ndryshim mes tyre dhe njerëzve të zakonshëm.” “Gaboresh, Leonard”, -



i tha ajo. - “Janë krejt ndryshe. Krejt të mrekullueshëm. Krejt të jashtëzakonshëm. Aspak si njerëzit e zakonshëm. Atëherë u ndjeva shumë e emocionuar dhe nuk turpërohem për këtë”.

Pastaj iu kthye Ben Nicolson-it – gjithnjë kishte dikë që, me sa dukej, i pëlqente ta ngacmonte – dhe i tha:

Pastaj ajo iu kthye Ben Nicolson-it – gjithmonë kishte dikë që i pëlqente ta ngacmonte – dhe tha: - Ben, na trego, të lutem [ai ishte Asistent Përgjegjës për Pikturat Mbretërore], a duhet të veshësh pantallona të shkurtra deri poshtë gjurit kur shkon në Pallatin Buckingham apo në Windsor? A përkulesh shumë poshtë? A bie në gjunjë? A flet ndonjëherë pa të folur më parë? A guxon të bësh ndonjë pyetje? Kur largohesh nga Mbreti, ecën mbrapsht? Dhe kështu me radhë.

Ben-i u përgjigj si munda, pa buzëqeshur, me solemnitetin që e karakterizonte dhe më në fund, shpërtheu:

“Gjithmonë më ngacmon, Virginia. S’do ta harroj kurrë kur e pyete të shkretin Hugh Walpole nëse makina e tij ishte e veshur me ar.”

Pastaj ajo u kthye nga unë.

“Ç’libër ishte ai me të cilin hyre brenda?” E pashë.

I thashë se ishte libri i Henry James-it për Hawthorne-in.

“Pres të mos kesh lakuriq nate në kampanoren tënde, zoti Berlin”, - më tha ajo. - “E shoh qartë këtë – nuk më dukesh si njeri i interesuar për ëndrra apo për fantazi. Apo je?”

Nuk mbaj mend si iu përgjigja. Mbase belbëzova nga frika e pranisë së saj. Ajo përcillte praninë e gjeniut dhe biseda e saj – të cilën nuk kam shpresë ta riprodhoj – ishte plot me imazhe dhe analogji të mrekullueshme, dhe ishte më magjepsëse për ta dëgjuar se ajo e kujtdo tjetër që kam takuar ndonjëherë – vetëm Pasternaku i afrohej.

“Henry James-i, - tha ajo, - tani natyrisht që të gjithë e lexojnë, por kur e njoha unë s’ishte veçse një përbindësh i ngrirë nga pleqëria. Nuk lexoj shumë romane moderne, madje as ato që botojmë vetë, unë dhe Leonard-i. Stephen Spender-i na tha sa i mrekullueshëm i dukej In a Province i Laurens van der Post-it – e botuam ne, e di. M’u duk krejt i ndershëm, por mrekulli? Jo. E ke lexuar Murder in the Cathedral? Apo e ke parë? Mua më pëlqeu goxha”.

“Unë dola në mes të shfaqjes, nuk e duroja dot”, - tha Leonard-i. - “Tom Eliot-i është shumë i errët për mua. Gjithë ajo marrëzi fetare”.

Nuk kujtoj më asgjë tjetër, por kalova tri nga orët më të mrekullueshme të jetës sime në praninë e kësaj shkrimtareje që nuk ishte fort simpatike dhe sigurisht, jo shumë e sjellshme, por jashtëzakonisht e dhuruar – një shkrimtare gjeni, siç e konsideroj ende dhe gjithnjë e më shumë, sa herë që rilexoj veprat e periudhës së saj të mesme.

Përktheu Bujar Hudhri



Karikaturë nga Arben Mexsi



Ndoshta, çdo gjë është e paralajmëruar! Është e thënë! Është e shkruar! Që në zonat më të errëta të zanafillës, që në detajet më të prekshme të qenies. Tek vepra **“Kronikë...”** për ta shenjtëruar aktin e çvirgjërimit deri në përmasa të paprekshmërisë hyjnore, pengimi i mortit tashmë “është thënë”, është shkruar dhe është e pamundur të ndalohet. Secili fenomen e qenie, gjithsecila dukuri e ngjarje ka epilogun, parathënia e të cilës është shkruar shumë herët, që në zanafillë.

Rileximi i një vepre letrare në kohë pafundësisht të largëta, na bënë përgjegjës për përkushtimin që kemi ruajtur për këtë krijimtari, e mbi të gjitha për vlerat që ka një vepër. Duke i ikur profesionalizmit përkatës, në veçanti teoricioneve letrar, Ne si lexues ndërhyjmë tek ta për t'i kuptuar. I kthehemi të kaluarës së largët. Fillimeve. Që në mesin e shekullit XIX. Citojmë. Në vitin 1843 kritiku francez Hippolyte Babou në debatet njohëse për realizmin dhe romanin shkruan: *“Analistët arrijnë ta japin idenë e tërësisë me anë të numërimit të detajeve”* dhe se *“analisti i vetëdijshëm e çon kultin e detajit po aq larg sa antikuari.”*¹

Njëzet vite pas botimit të romanit *“Kolonelit s'ka kush t'i shkruaj”*, pesëmbëdhjetë vite pas botimit të romanit *“Njëqind vjet vetmi”* dhe vetëm një vit pas botimit të romanit **“Kronikë...”**² Gabriel García Márquez merr çmimit Nobel për Letërsi kur tashmë ishte nderuar me çmimin e Legjionit të Nderit nga presidenti Fransua Miteran, me urdhërin Felix Varela nga Fidel Kastro, me çmimin Aguila Azteca në Meksikë etj.

Kronologjia e ngjarjes dhe botimet e veprës **“Kronikë...”** në shqip

1951 (20 janar) Në qytetin bregdetar të Manauere (Sucre), ndodh vrasja e Cayetano Gentile, i akuzuar për përdhunimin e Margarita Chicha Salas...

1979 Gabriel García Márquez filloi ta shkruaj **“Kronika e një vdekjeje të shpallur”**

1979-1981 Nga viti 1979 kur nis për ta shkruar **“Kronikë...”** deri në vitin e botimit 1981 Gabriel García Márquez përveç që shkruan shënime e shkrime javore gazetareske dhe bëhet pjesë e realizon projekte kinematografike shkruan tregimin *“Maria dos Prazeres”* (1979), *“Udhë të mbarë, zoti president”* (1979), *“Pajtohem me qera për të parë ëndrra”* (1980), *“Shtatëmbëdhjetë anglezë të helmuar”* (1980) dhe *“E shenjtë”* (1981)

1981 Gabriel García Márquez botoi romanin **“Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”**

1984 Gabriel Garsia Markes **“Kronikë e një vdekjeje të shpallur”** (novelë), Revista “Nëntori”, Mars, prill, nr. 3 e 4

1986 Marquez, Gabriel Garcia “Gjethurinat”, *“Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë”*, *“Një histori me paskuinë”*, **“Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”**, Naim Frashëri, Tiranë

1987 Film *“Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”* (regjizor: Francesco Rosi)

1987 Eligio García Márquez *“Vdekja e tretë e Santiago Nasarit”*

1988 Gabriel Garsia Markes **“Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”**, “Rilindja”, Prishtinë

1994 Reyes Palencia paditi nobelistin Gabriel García Márquez dhe vëllain e tij Eligio, sepse e kanë vënë protagonist në romanet **“Kronikë e një vdekjeje të parathënë”** dhe *“Vdekja e tretë e Santiago Nasarit”*. Palencia konsideron që është dëmtuar “nderi dhe dinjiteti i tij”.

2000-2022 Gabriel García Marquez, autori kolumbian i *“Njëqind vjet vetmi”* dhe fituesi i çmimit Nobel të vitit 1982 është shkrimtari më i përkthyer në gjuhën spanjolle në shekullin e XXI duke e kaluar edhe Servantesin...

2007 Miguel Reyes Palencia botoi *“E vërteta: 50 vjet më vonë”*

2007 G. G. Markez **“Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”**, Botimet ABC, Tiranë

2011 Gjykata e Lartë e Barranquilla, në Kolumbinë veriore, vendosi në favor të shkrimtarit në vitin 2011, duke hedhur poshtë ankesën e Reyes

2025 G. G. Márquez **“Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar”**, Onufri, Tiranë

Koha e kujtesës, periudha e shkrimit dhe **“strategjia e narracionit”**

Biografët shkruajnë se Márquez *“në vitin 1981 kërkon strehim në ambasadën e Meksikos. Kthehet në qytetin Meksiko. “Kjo “ikje” u jep kundërshtarëve të tij shkas për komente negative, të cilët nuk humbasin rastin të thonë së bëhet fajlë për një reklamë të inskenuar, për një truk,*

Katërdhjetë e një vite ndërmjet botimit të parë në shqip (1984) dhe të fundit i përkthyer nga Aurel Plasari. Nga “Kronikë e një vdekjeje të shpallur” përmes të “paralajmëruar” në “Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar”. Dromca dhe skica gjurme nga një lexim i përditësuar i ripërkthimit dhe ribotimit të veprës së Gabriel García Márquez “Kronikë...” pa pretenduar tërësinë, por vetëm “numërim të disa detajeve”...

Përkitazi ribotimi i veprës së Márquez-it

Përsosmëria dhe magjia e thjeshtësisë në veprën **“Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar”**

Nga Enver S. Morina

për **Kronikën e një vdekjeje të paralajmëruar**, që sapo kishte dalë në qarkullim.

Kjo shpirtëligësi tregon shkallën e armiqësisë absurde, e cila, me kalimin e kohës, shkakton përzierjen e shkrimtarit në politikë. Sepse deri tani Garsia Markesi nuk kishte reklamuar asnjë libër të tijin para dhe pas botimit dhe ndjehej i qetë kur thoshte se nuk e kishte të nevojshme ta bënte një gjë të tillë. Brenda një kohe të shkurtër u shiti i gjithë tirazhi i botimit të parë të romanit **Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar**, i cili numëronte mbi një milion kopje.”³

Sipas njërit nga biografët, vepra e të cilit është përkthyer dhe është botuar edhe në shqip, Dagmar Ploetz *“ky mund të ishte romani i tij i parë.”* E tërë historia e këtij “rrëfimi të rrëfimit”, paralelizmat në mes të të vërtetës dhe kohës së shkrimit (27 vite më parë), tronditjes nga një ngjarje, betimi i shkrimtarit dhënë Nënës së tij, është një uverturë komplekse që na dridh për një citat të gjatë si një hyrje dhe

epilog për romanin në tërësi. *“... Garsia Markesi kishte shkruar vetëm pak tregime, kur e tronditi një ngjarje e përgjakshme brenda rrethit të tij familjar. Një i ri, ditën e martesës së tij, e ktheu mbrapsht të shoqen, të prindërit e saj, pasi nuk e gjeti të virgjër. Vëllezërit e vajzës, për të çuar në vend nderin e familjes, vranë atë që dyshohej për shnderimin e motrës së tyre. Garsia Markesi, i cili e njihte viktimën, ishte indinjuar shumë për këtë vepër dhune të freskët. Në të njëjtën kohë, i riu shkrimtar u ndje veçanërisht i zhgënjyer nga fakti se kjo ngjarje përmbante shumë elemente makabre, si dhe shumë nga karakteristikat e tragjeditë të lashta.*

Kur deklaroi se donte ta shkruante këtë histori, e ëma e detyroi të betohej se nuk do të shkruante asgjë, për sa kohë do të rronte nëna e të vvarit. Kështu, qysh në fillim, kjo temë qe një tabu për të. Dhe kur, pothuajse tridhjetë vjet më vonë, mësoi se nuk qëndronte më ky kusht, e kishte rrëfyer historinë në rrethet e miqve të tij, në kërkim të të

*fshehtës kolektive për këtë fatalitet individual, ku gjëja e vetme që kishte nevojë ende për t'u gjetur ishte mënyra shprehëse e të shkruarit, pra, e strategjisë së narracionit.”*⁴


“Trillimi i mënyrës së të rrëfyerit është shumë i afërt me realitetin”, thotë Ploetz për të zbërthyer në plotëni afrinë në kohën dëshmitare dhe në kohëreale të të gjithë kapitujve, pesë sa janë. Sipas edhe vet Márquez-it nëse Edipi mbret ishte një nga veprat më të mira policore të letërsisë botërore, çfarë mund të themi për **“Kronikën...”** përveç që është një nga rrëfimet më intriguese ceremoniale në heshtjen dhe pjesëmarrjen në krimin e paralajmëruar që nga nata e martesës, më parë dhe më pas, siç thuhet po aq fajtor sa vrasësit mund të jenë edhe shikuesit që nuk ndërhyn. Arsyetimi real si një nënshtrës rrëfimi imagjinar. *“... fshati e dinte se Santiago Nasari duhej të vdiste, dhe ai vetë ishte i vetmi që nuk dinte”* është një nga “krizat” e një morali dhe indiference që duhet të vinte.

Dëshmitë për rrëfimtarin dhe perifrazimet stilistike

Në pjesën e parë tregojnë e ëma e Santiago Nasarit (Plasida Linero), kuzhinierja (Viktoria Gusman), zonja e shitorës (Klotilde Armenta), motra e rrëfyesit (Margoti), vëllai i rrëfyesit (Haimeja) dhe e ëma e rrëfyesit (Luisa Santiaga). Rrëfyesi në fillim tregon për takimin me nënën e Santiagos në moshën *“e rrënuar nga vitet e mbramë të plegërisë”* për *“të rindërtuar prej aq ciflash të hallakatura pasqyrën e thyer të kujtesës.”*⁵

Ta kthesh në shtëpi, ta mbash për vete apo ta vrasësh si te *“Kënga e Isuf Agës”* e baladave tona rapsodike të hershme është intrigë përngjasimi me dilema e drejtëzgjdhjes me Kanunin e Nderit! Më i vërbër ishte Santiago Nasari, ishte Anhela Vikario, ishte Bajardo San Romani, ishin vëllezërit Vikario, ishin edhe personazhet që dinin së vrasja do të ndodhte?! Enigma vazhdon, edhe në shekullin XXI. Edhe pas përfundimit të leximit të romanit. Edhe pas vdekjes së shkrimtarit. Dosjet teorike të kritikës letrare imagjinative të rileximit hapen dekada më pas. Kush është ai që kishte shtënë poshtë portës një letër në zarf që *“nuk u identifikua kurrë...”*?! Pafundësia e një ëndërrimi të thënë e cila përherë nuk do të ndodh, ose në fjalinë e drejtë të ligjërimit, asnjëherë nuk do të ndodh. Në të vërtetë enigma do të mbetet e përhershme e aktit të ç'virgjërimit te Anhela Vikarios e parathënë për një vrasje të domosdoshme, sa që, siç thotë vet Santiago Nasari *“më zë të lartë”* se *“Nuk do t'u mjaftojë jeta për ta treguar.”* (f. 22) *“Leximi i figurës-personazh është punë deshifrimi intuitiv, që do të thotë se ne, si lexues jo vetëm e shikojmë por edhe e plotësojmë, e ndriçojmë atë, do të thotë që leximi i nënshtrohet parimit të përshtatshmërisë.”*⁶

Dëshmitë për rrëfimtarin për ndërtimin sa më të saktë të kronikës janë të shumtë në “pjesën e dytë”: udhëtarja Magdalena Oliveri, letrat e nënës së rrëfyesit, rrëfimet e Anhela Vikarios, të thënat e Mercedesit, bisedat me Santiago Nasarin... Dilema e vdekjes dhe vrasjes ringritet vetvetiu në thellësinë e kuptimit të personazheve me aktin “e marrjes” së nderit nga Santiago Nasari “e dhënies” nga Anhela Vikario. Të shijosh dashurinë me mëkat!? Dashuria e fshehtë në mëkatet e zbuluar për nderim!? Në krejt këtë “përzierje të domosdoshme” të marrëdhënies, aktit, dashurisë, nderit, mëkatit,



çështja ngritet jo tek vdekja sepse atë e kanë nënshkruar vet autorët e aktit të marrëdhënies por tek ndalesa, ndihma për të ndaluar vëllezërit Vikario. Në çështjen e nderit askush nuk mund të ndërhyjë sepse mungesa e zbrazësia do të jetë e tmerrshme mëpastaj.

Perifrazimi stilistik mahnitës siç di vetëm Márquez-i të “*dielën e nëmur*” në “*dasmën e pafat*” kur tashmë “*gjëma ishte konsumuar*” bëhet pyetësor enigmatik se “ç’karta luajti Bajardo *San Romani*”?! dhe se “ç’karta luajti *Santiago Nasari*”!? ... Një figurë e gjetur letrare është analogjia e semantikës diskursive të një krahasimi në vete si metaforë dhe njësi gjeografike: “*...ndërtimi i një hekurdhe në brendësi të vendit për ta tejkaluar shpejtësinë e lumit.*” (f. 30) Monumentaliteti magjik krijues i Márquez-it lartësohet edhe më këtë metaforë brilante ku vëllezërit Vikaria bënë që “*... thikat të këndonin në gur*”. (f. 56)

Përmes një fjalie Márquez-i përshkruan tërë karakterin dhe marrëdhëniet e dy vëllezërve binjakë. Ndryshueshmëri ngajshmërie të të kundërtave. “*Jo vetëm ishin shumë të ndryshëm, së brendshmi nga sa dukeshin të ngjashëm së jashtmi, por në çaste vështirësish të papritura kishin karaktere të përkundërta.*” (f. 63 e 64) Nderi duhet të mbrohet. Ata që kanë cenuar nderin duhet të ndëshkohen. “*... i vuri thikën në dorë dhe e ngriti pothuaj me pahir për të vënë në vend nderin e humbur të motrës.*” (f. 66), sepse “*...nderi nuk pret.*”. Nderi sikur është një nga krijimet më të paprekshme hyjnore të cilën bota moderne sot e ka kthyer në përditshmëri të lojërave pa kufij, në përkujdesje të Vëllait të Madh.

Nëse më shumë se dymbëdhjetë veta e dinin se çdo të ndodh, janë dhe të tjerë që hyjnë tek lexuesi me një përshkrim siç di vetëm Márquez-i “*... në shitore hynin e delnin klientë të shtirur që blinin qumësht pa pasur nevojë dhe pyesnin për ushqime imagjinare vetëm për të parë në ishte e vërtetë që binjakët po prisnin Santiago Nasarin për ta vrarë.*” (f. 68)

Sa më lehtësi dhe thjeshtësi ngritët pena e Márquez-it për të lartësuar “thellësinë” e një ngjarjeje të cilën don ta trajtojë. Në rrjedhën e diskursit markezian vjen tregtia e skllëvërve dhe jeta e shkurtër bashkëshortore e Anhelas, fatkeqësia e saj. “*E ndjeva veten që kisha dalë nga pasqyra.*” (f. 70)

Rregulli i fshehtë i autorit dhe hollësi që “nuk do të sqarohen kurrë”

Fillimi i çdo pjese. E pranon epilogu i çdo pjese që të jetë në fillim? Të jetë nismëtare e lajmërimit të një vrasjeje? Një sfidë e unit të shkrimtarit. E pritjes së lexuesit. Ka një rregull të fshehtë që i takon vetëm autorit. Analogjia e rendit për të ndryshuar njësinë e kohës dhe njësinë e hapësirës është ngërthyer dhe mbërthyer në njësinë e veprimit të njëjtë. Nderi dhe ndëshkimi. Trillet e autorit sikur i ngjajnë trilleve të Santiagos të shndërrimit të petkave të mulateve duke ia këmbyer identitetin atyre përmes plaçkitjes.

Për të qenë kronika sa më e vërtetë shkrimtari “e ndihmon” rrëfimtarin me personazh të tjerë, të dhënat e të cilëve e bëjnë lexuesin të besoj. “*Këtë e pranonte edhe im vëlla.*...”, thotë rrëfyesi.

Nëse dilemat e rrëfyesit përmes shkrimtarit janë ngrirë në roman që në kohen e shkrimit dhe janë arkivuar përgjithnjë në kohen e botimit, 23 vjet pas dramës, Ne lexuesit përherë duhet lexuar si për herë të parë. Kjo vjen e bëhet, sipas rrëfyesit, më enigmatike kur disa hollësi “*nuk do të sqarohen kurrë*”.

Derisa virgjëria si gravurë e qendisur në ciklët e thellësisë së përjetimit të Artit të Shtatë përmes dramaturgjisë regjizoriale ka përfshirë edhe anët më intime të njohjes përmes ndëshkimit pa gjyq, hetuesia dhe avokatët janë lënë menjanë, janë “trajtuar” përmes ideolatrisë së filozofëve të hapësirave klasike të përngjasimit. Gërshtëtimi mes një hetuesi të gjykatës së drejtësisë dhe rrëfimtarit hetues për krijimin e një vepre letrare te “***Kronikë...***” ndeshet tek fjalía e autorit se i pari “*qe njeri i dhënë me mish e me shpirt pas letërsisë*” dhe i paragrafit pasues që është një nga perlat me monumentale të krijimtarisë imagjinative dhe të realizmit magjik të Gabriel García Márquez-it: “*Padyshim kishte lexuar klasikët spanjollë dhe disa latinë, si dhe njihte fort mirë Niçen, që ishte autor në modë mes juristëve të kohës së tij. Shënimet në anë fletësh, dhe jo vetëm nga ngjyrat e bojës, dukeshin si të shkruara me gjak. Aq ia kishte marrë mendtë enigma që i pati rënë për short sa shpesh u hallakat në përsiatje lirike në kundërshtim me rreptësinë e detyrës së tij. Sidomos nuk iu duk kurrë legjitime që jeta të përdorte aq*

rastësi, të cilat nuk i lejohen as letërsisë, për t’u kryer pa pengesa një vdekje aq të lajmëruar.” (f. 106)

E tërë vepra sikur qendron në mesin e luhatjeve epike të pafajësisë se Santiagos, nderit te Anhelas dhe poshtërimit të vëllezërve Vikario! Klithja a perifrazimi anash është një tjetër fakt hetues se në çfarë përmasa ndodhi e tërë rrëfimi markezion: “*Jepmëni një paragjykim dhe do të lëviz botën*” (f. 107), se më çfarë magjie realiste të dilemave anonime të një krimi të lajmëruar dhe i cili në vitin 1981 botohet roman dhe një vit më pas autori nderohet me çmimin më të madh letrar me “Nobelin për Letërsi”!

Komploti i madh letrar në diskursin imagjinar “Na tha mrekullinë, por jo shenjtorin”

Kush është Cayetano Gentile në veprën e Márquez-it? Në rrjedhë të kësaj, po Santiago Nasari është më të vërtetë burri shenjtori? Derisa ngjarja ka ndodhur më të vërtetë enigma qendron tek personazhi “Gabriel García” që nuk përmendet në vepër! Shkrimtari përmes rrëfimtarit ka ndërtuar kronikën “e mundshme”. Rrëfimtari ka motër, vëllezër, nënën, familjarë. Mrekullia kishte ndodhur. Ç’virgjërimi i Anhelas? Mungon shenjtori! A fshihet “rrëfimtari” pas Anhelas dhe e gjithë vepra është shfaqësim!? Këtu qëndron filli i një rileximi të ri, njëherazi është pikënisje e vdekjes së letërsisë në të gjitha përmasat e saj, për të mbetur libri në memorien e historisë së civilizimit! Në gjithë brendësinë e veprës mungon “shenjtori”, i vërteti i çvirgjërimit të Anhelas. Ka mjaftuar vetëm “një marrëveshje” mes personazhit Anhelas dhe shkrimtarit që do të përjetësohet në një vepër! Fjalët magjike të shoqeve të deklaruar në procesverbal: “*Na tha mrekullinë, por jo shenjtorin*” (f. 106) a s’është komploti më i madh letrar që ka ndodhur përgjatë diskurseve të historisë letrare?! Ky është nënteksti! Kjo është intriga enigmatike e thënë përmes një vepre. Ky është akti monumental. Kjo është madhështia e rileximeve të veprave të Márquez-it që ndriqojnë botën e sotme dhe shndrisnin imagjinatën e mesazheve më të lartësuara të civilizimit botëror! Megjithatë ky është vetëm një kumt të cilin vetëm letërsia dhe libri ka fuqinë të na jap. A është gjallë Santiago Nasari i vërtetë? Ai i cili fare nuk kishte të bënte me Anhelan? Është vepra “***Kronikë ...***” që e mbështjellë me finesë filigrani rrëfimtarr...

Ngjarja ka ndodhur në vitin 1951. Márquez-i 23 vjeçar. Plus 27 vjet. Vepra është shkruar në përputhshmëri me vitet?! Është botuar një vit më pas, në vitin 1981. Cili është “Santiago Nasari” i vërtetë?! Po ta kishte titullin vepra me emrin e Santiago Nasarit, a do të ishte një trill tjetër i shkrimtarit?! Apo një afri në labirinthin e së vërtetës letrare dhe imagjinatës së reales! Sikur arsyetimi vjen e bëhet shpjegim i nënës së rrëfimtarit që të mos e shkruaj veprën para moshës a periudhës së harresës dhe kredo e un-i të shkrimtarit në gërshtëmi me realitetin imagjativ. Prandaj vepra është lexim i një enigme të pafund e cila përsëritet në realitet sa herë që të hesht koha e marrëzisë! Në botën ballkanike, në hapësirën tonë te demosit edipian të lirisë së veprimit, çmenduria e arsyeton tërë rrjedhën e një shoqërie jo vetëm në krizë kulturore, por edhe në krizë shëndetësore dhe mbijetëse, pa delirin e një mirëqenie të nderuar dhe na mëson se shekulli XX mbante në vete barrën e të gjitha shtresave të një civilizimi qeniesor të papërsëritshëm!

Personazhi është edhe figurë edhe sistem shenjash. Bashkëjetojmë me ta për t’i lavdëruar dhe nemur, për t’i mohuar dhe lartësuar. Santiago Nasari vritet. Në titull zbutet. Vdekjeje! Ndërhyrja e banorëve tek vëllezërit Vikario është e pashmangshme në realitet por është e pamundshme shpirtërisht, sepse jemi të gjithë me ata të dy. Edhe vet viktima. ***Shënjesit*** janë në shesh. Flasin. Përgatiten. Janë betuar. ***I shënjuari*** bashkëjeton me të gjithë si përherë. Është i pranishëm me tërë qenien, pa më të voglin dyshim. ***Shenja*** tashmë ka dëshmuar. Në gjithë këtë dramë dilemat e së vërtetës mbetën në sytë e lexuesit të ardhshëm, sepse akti i çvirgjërimit do vjen e bëhet i parëndësishëm, sepse dashuria do të përmirësohet “duke u ndryshuar”. Jashtëtokësorët ushqehen me prekje, është thënë. Këngëtarët në një shoqëri në krizë vlerash nuk dëgjohet për shikohen. Përmes imazhit arrijnë trashëgimtarët. Të gjitha këto me marrëveshje të nivelit tjetër inteligjentë. Universi don sakrifica dhe blasfemi të tjera, aq sa një ditë, në një kohë, të matur me vitdrite, vetmia nuk do të këtë kuptim për një

përgjigje të shkrimtarit, pas njëqind vite zbrazësi të gjyshit të gjyshit tim!?

Të rralla janë veprat në të cilat është kaq aktive pjesmarrja në krijimin e ngjarjeve të rrëfimtarit, dëshmitarëve, akterëve se sa tek “***Kronikë...***”. Cila është prova tek “***Kronikë...***”? Është heshtja e opinionit apo ç’virgjërimi do hakmarrje!? Më shumë se kaq sikur vepra e tëra është shfaqësim i publikut spektator prandaj *Edipi mbret* për Garsia Márquez-in “*ishte një nga veprat më të mira policore të letërsisë botërore.*”⁷

Parafrazimi i një shpjegimi të poezisë “Populli nuk është 007” gjatë rileximit të “***Kronikë...***”, si analogji, mu ngjall dilema, pse duhet të ketë çështje të mëdha për të cilat nuk di lexuesi?

Kurrë mos thuaj kurrë (...)
E vërteta lind me vdekjen e çështjes së madhe gjithmonë vonë
*gjithmonë pas njeriut.*⁸

Duke lexuar Chartier për romanin dhe plagët e një vrasjeje

Tej limiteve të tregimit dhe brenda gjatësisë së nisjes së një romani qendron novela e cila si një zhanër “i përzirë” në prozë na vë në medysheje ploteninë dhe mungesën e përcaktimit të saktë në botimet shqip... Dostojevski ka shkruar edhe tregime, por është i njohur me romanet e tij. Cvajgu ka shkruar edhe biografi por është i njohur me novela. Po Heminguej, Kadare a Markezi? Edhe nxënësit mund ta din se Borhesi nuk ka shkruar roman apo drama për teatër! E kundërta Bodleri ka shkruar edhe tregime. Po Çehovi e Dostojevski? Hygoi a Becketi? Përherë më ka intriguar përcaktimi i saktë i prozës së Heminguejit “*Plaku dhe deti*” dhe “***Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar***”!?

Perre Chartier në faqe 13 e 14 ka cituar disa fjalorë e enciklopedi. I kthehem shekullit XVIII dhe i afrohemi kësaj përgjigje: “*Histori të sajuaara me aventura të ndryshme, të jashtëzakonshme ose të mundshme të jetës së njerëzve.*”⁹

Tendenca e romanit modern, siç thotë Chartier “*Synimi për të shprehur totalitetin e reales*” vjen e bëhet imanencë e pesë kapitujve rrëfimtarr, e pesë pjesëve “rrënuese” përmes ingranazhit të detajit në variacionet e strukturës kohore, në harkun e rrjedhës së ngjarjes prej pak orësh tek “***Kronikë...***”. Prandaj te “***Kronikë...***” te botimi i parë në shqip i shënohet novel.¹⁰ Çështja e zhanrit, dyzimi dhe ngrehina për një përcaktim sa më të përafërt sa është paradoksale është edhe dekonstruktive, duke e thelluar kështu edhe dilemat për një zhanër të pastër, në limitet e emërtimit tipologjik, në imtësitë e detajit!

Të pakta janë veprat letrare të botës moderne si tek “***Kronikë...***” që gjrindet brenda prozës të shpërthejnë edhe jashtë tij deri të kërkesa për gjykim dhe e kundërta anasjelltas dilema e kritikës dhe lexuesit se kush është autori, “shenjtori” që çvirgjëroj Anhelan! Aposteriori i një akti çvirgjërimi bëhet premisë për t’u kthyer përherë tek personazhet dhe vendi i ngjarjes reale. Dhe tek shkrimtari. Më shumë se sa akti i turpërimit është mungesa dhe dilemat e emrit dhe pafajësia e brendshme e Santiago Nasarit. Turpi bie mbi Bajardon i cili apriori fare nuk ka të bëj me dy personazhet kryesor “të cituar” për veprën e tyre?! Për Santiagon dhe Anhelan. Përkundrazi i pari mendon për dasmën e tij dhe është i pranishëm ndërsa e dyta i ka dërguar me mijëra letra.

Mjeshtëria e shkrimtarisë është mister! Më vetëm një fjali na vënë në dyshim! Kur e rilexova ligjëratën e Márquez-it¹¹, te 8 dhjetorit 1982 u zbrapsa nga akuzia imagjinare ndaj një personazhi në vetmi i cili i ka shpëtuar aq lehtë jo vetëm gjyqit por edhe lexuesit. Si një plagjiaturë moderne në vete kur inteligjenca artificiale po ndërton trurin e asgjesë dhe të askushit, anonimiteti dhe ecejakeja e përsosmërisë së zbulimeve njerëzore e ka tejkaluar shpejtësinë e dritës, në pikën pa sipërfaqe dhe në hapësirën e pa kohë, heq dorë nga Gabriel Garsia imagjinar dhe i kthehem Márquez-it monumental, i cili tashmë qëndron me dhjetëra vepra të tij në vendin e merituar në Bibliotekën time të cilën një ditë do e lë për ta parë në ëndërr, për t’i takuar të gjithë personazhet tej veprimit të tyre sepse shkrimtari kolumbian ka “refuzuar fundin e njeriut” dhe Ne kemi “miratuar” rileximin e ardhshëm të veprës së tij. Përkthyesi Aurel Plasari na ka bindur dhe apriori e ka thënë në një intervistë në vitin 2014.¹²

Gjykimi “në vetmi” dhe magjia e realizmit hispano-amerikan

Nuk ka paqe për krijimtarinë e Márquez-it! Ajo ngërthen në vete magjinë artistike të një realiteti me plot dhembje dhe një pritje për t’u gjykuar “në vetmi”, krejt kjo në epilogun e diskursit të dy profesioneve nga më panteonike të gjysmës së dytë të shekullit XX: mjeshtërisë së shkrimtarisë së pari si fund dhe gazetarisë së dyti si fillim në një sinkroni diakronike të rrallë apriori për historinë e “një personazhi” fitues të çmimit Nobel për Letërsi. Duke i nënkuptuar, i njohur dhe i lexuar “takimet” dhe bisedat e shkrimtarit Gabriel Garsia Márquez për Ernest Heminguejin (bëri vetvrasje), me Fidel Straston (përkundër qindra atentateve në tentativë vdiq në fron), me përkthyesen në shqip Mira Meksi (njëra nga tre përkthyesit e “*Njëqind vjet vetmi*” dhe edhe përkthyesja e veprës postmortem “*Shihemi në gusht*”) a nuk mund të rikthehemi përherë thënies së autorit në parathënien e “*Dymbëdhjetë tregime pelegrine*” se “*...Kujtimet e vërteta më ngjanin fantazma të memories, ndërsa kujtimet e rreme ishin aq bindëse, sa kishin zëvendësuar realitetin.*”¹³

Duhet të kalojnë 27 vite që Márquez-i të “hap plagën” e një vrasjeje. Duhet një post mortum që bota të njoh një vepër tjetër të Márquez-it (“*Shihemi në gusht*”). Duhet të heshtesh për të shthurur medoemos vetminë. Shenjtëria e tij magjike vulosi pavarësinë monumentale të veprës së tij artistike. Intimitetet kanë ardhur dhe janë bërë çështje në veprën e Márquez-it. Shkrimtari rrëmon një dukuri “të pamundur” për t’u gjykuar, rrënon aktin e një gabimi të shënjtëruar dhe jetëson përmes fjalës e gjuhës në përsosmëri “në paprekshmëri” veprën e tij.

“*Në romanin “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar” (1981) shtrohet problemi i papërsëritshmërisë së jetës unikale njerëzore. Për këtë shkrimtari sërish i drejtohet historisë së qytetit Makondo, zgjedh mënyrën detektive të rrëfimit për të qenë sa më komunikativ. Ngjarjet përshkohen nga dramaciteti i fuqishëm, karakteristikë e jetës së vendeve amerikano-latine, të njerëzve me gjak të nxehtë.*”¹⁴

Magjia e realizmit i ndërtuar mbi diskursin e një realizmi magjik nga prozatorët hispano-amerikan, shumica prej të cilëve përmes gjuhës spanjolle, ka një ndikim të thellë tek ata të cilët kjo krijimtari tashmë bënë një jetë të përhapur dhe të dendur. Argjentinasi Borhes, Sabato e Kortasar, guatamalasi Asturias, kubani Karpentieri, meksikani Rulfo, e të tjerë dhe së fundi meksikani Fuentes, peruani Llosa e kolumbiani Márquez, tre prej të cilëve janë nderuar me çmimin Nobel për Letërsi (Asturias, Markes e Llosa) me prozën e tyre kanë arritur të shndrisnin me margaritarë magjik të një letërsie origjinale për nga format e arrira e më të lartësuara letrare. Gabriel Garsia Márquez-i përmes prozës së tij monumentale e çthurë një aoreolë panteoni rrëfimtarr për brezat që e duam magjinë e krijimtarisë letrare.

Prill-maj 2025, Prishtinë

- Chartier, Pierre “*Hyrje në teoritë e mëdha të romanit*”, Onufri, Tiranë, 2015, f. 140
- Në këtë shkrim pasi vepra e Markesit nga botimi i parë është përkthyer në tri variante titulli e kemi shkruar vetëm “***Kronikë...***”
- Ploetz, Dagmar “*Gabriel Garcia Marquez*”, Onufri, Tiranë, 2001, f. 113
- Ploetz, Po aty, f. 115
- Márquez, G. G. “*Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar*”, Onufri, Tiranë, 2025, f. 10 (më tej faqet e cituara nga ky botim brenda tekstit)
- Dado, Floresha “*Figura-Personazh që ‘shihet’ përmes fjalës*”, Onufri, Tiranë, 2023, f. 330
- Ploetz, Po aty, f. 116 (në citat thuhet se “*detektivi zbulon sepse vrasës është ai vetë.*”)
- “*Populli nuk është 007*”, Gazeta javore “ZËRI”, Prishtinë, 9 maj 1998 dhe tek libri “***Rr’nimi i Arbërit***”, Buzuku, Prishtinë, 2021, f. 75-78
- Chartier, Pierre Po aty, f. 13
- Gabriel Garsia Markes “*Kronikë e një vdekjeje të shpallur*” (novelë), Revista “Nëntori”, Mars, prill, nr. 3 e 4, 1984
- Spahiu, Avni “*Nobelistët e letërsisë*”, Kosova PEN Center, Prishtinë, 2022, f. 481-485
- Për njohjen “e parë” dhe marrëdhëniet me shkrimtarin Márquez, për censurën, për “vetëpërmbytjen” e përkthyesit, për redakturën e revistës “Nëntori” të vitit 1984, për heqjen “e fjalëve të pista” nga “***Kronikë...***”, dhe të tjera përgjigje “të panjohura”, mund të lexoni intervistën tematike te përkthyesit Aurel Plasari dhënë mediave në vitin 2014 “*Si e shpëtova Gabriel Garcia Marquez-in nga censura*”
- Márquez, Gabriel García “*Dymbëdhjetë tregime pelegrine*”, Onufri, Tiranë, 2017, f. 10
- Doksani, Jorgji-Doksani, Agim “*Letërsia botërore e shekullit XX*”, Eugen, 2008, f. 155

“Atë ditë të largëta në Jude, të cilat më Alanë të çalë e të sakatuar për gjithë jetën, ishin periudha më e lumtur e rinisë sime,” - tha një burrë i gjatë dhe i hollë, me fytyrë të zverdhur, me sy kafe të ndritshëm dhe flokë të argjendtë me kaçurrela të bukura i cili ecte me një patericë sepse ajo këmba e majtë nuk i përkulej te gjuri.

*

Atëherë mora pjesë në një ekspeditë të vogël me qëllim që të eksploroni brigjet lindore të Detit të Vdekur, vendet legjendare të Sodomit dhe Gomorrës, qëndrova në Jerusalem duke pritur shokët e mi që ishin vonuar në Konstantinopojë dhe bëja udhëtime te një kamp i beduinëve në rrugën për Xheriko, te sheiku Aid, të cilin ma rekomanduan arkeologët e Jerusalemit dhe që ndërmorën për ekipin gjithçka të nevojshme për ekspeditën tonë dhe që e udhëhoqën personalisht atë.

Herën e parë shkova tek ai të negocioj me shoqëruesin, ditën tjetër ai erdhi vetë me mua në Jerusalem, pastaj fillova të shkoj në kampin e tij i vetëm, bleva një pelë të mrekullueshme vrapimi prej tij dhe shkoja mjaft shpesh...

Ishte pranverë, Judea ishte zhytur në një shkëlqim dielli të gëzueshëm, po më kujtonte kënga e këngëve:

Dimri tashmë ka kaluar,
Lulet sapo kanë mbirë,
Koha për këngë është zgjuar,
O pëllumb sa më vjen mirë
Që zërin tënd e ke bashkuar
Me aromat që pa gdhirë.

Atje, në rrugën për në Xheriko, në shkretëtirën shkëmbore të Judesë, gjithçka, si gjithmonë, ishte e vdekur, e egër, e zhveshur, e verbuar nga vapa dhe rëra. Por edhe atje, në ato ditë pranvere shkëlqimtare, gjithçka më dukej e gëzuar dhe pafundësisht e lumtur: për herë të parë isha në Lindje, pashë një botë krejt të re para meje dhe në këtë botë pashë dikë të jashtëzakonshme: mbesën e Aidit.

Shkretëtira e Judesë është një vend i gjithi i varur drejt luginës së Jordanit, kodrat, kalimet, ndonjëherë të gurta, ndonjëherë me rërë, aty-këtu rritet në vegetacion i ashpër, i banuar vetëm nga gjarpërinjtë, thëllëzat, heshtja e zhytur në përjetësi. Në dimër, atje, si kudo në Jude, bie shi, fryjnë erëra të akullta; në pranverë, verë, vjeshtë – e njëjta qetësi e rëndë, monotone, por vapë diellore, gjumë diellor.

Në gryka ku gjenden puse, gjurmët e kampeve të beduinëve janë të dukshëm: hiri i zjarreve, gurët e rreshtuar në rrathë ose katrorë ku janë fiksuar çadtrat... Kampi ku shkova unë, në të cilin Aidi ishte sheik, u paraqit pamja e mëposhtme: një masë e gjerë ranore midis kodrave dhe në të një kamp i vogël çadtrash të bëra prej shajaku të zi, njëngjyrësh, drejtkëndore dhe mjaft të errëta me zezonën e tyre mbi rërën e verdhë.

Duke kaluar, vazhdimisht shikoja pargje me bajga që digjeshin përpara disa çadrave dhe midis tyre kishte kudo grumbuj me qen, kuaj, mushka, dhi, deri tani nuk po kuptoja si dhe ku ushqeheshin të gjithë këta, shumica fëmijë, gra e burra të zhveshur, të dobët, flokëkaçurrelë, disa të ngjashëm me ciganët, të tjerët me zezakët, edhe pse jo buzëtrashë...

Ishte e çuditshme të shihje sa trashë ishin veshur burrat, pavarësisht vapës: një këmishë kubike deri në gjunjë, një xhakë të pambuku dhe mbi të një veshje e gjatë dhe e rëndë, e gjerë te shpatullat me lesh larush, me vija dyngjyreshe, bardhë e zi, në kokë një arafat, një lloj shamije e verdhë me shirita të kuq, e lëshuar mbi supe, e varur edhe në faqe dhe një mbulesë e dyfishtë mbi kokë gjithashtu larush, një pajisje leshi me dy ngjyra.

E gjitha kjo ishte krejt e kundërt me veshjen e grave: shalle kubike hedhur mbi kokë, fytyrëzbuluar, në trup vetëm një këmishë kubike me mëngë të ashpra që zbriste pothuaj deri përdhe. Burrat kishin



IVAN BUNIN

Pranverës, në Jude

Përktheu nga rusishtja: Kosta Nake



këpucë të rëndomta me pafta hekuri, gratë barisnin zbathur dhe të gjitha kishin këmbë të mrekullueshme, të shkathëta dhe të djegura nga dielli, si qymyr. Burrat pinin duhan me llulla, gratë po ashtu...

Kur arrita te pika e kampit për herën e dytë, pa shoqërues, më pritën si mik. Çadra e Aidit ishte më e madhja dhe atje gjeta një ansambël të tërë pleqsh beduinë të ulur rreth mureve prej shajaku të zi me dyshtemë që ngrihej në hyrje. Aidi doli jashtë të më takojë, u përkul dhe vuri dorën e djathtë në buzët e veta dhe në ballë.

Duke hyrë në çadër para tij, prita derisa ai u ul në qilim në mes të çadrës, pastaj bëra atë që bëri ai me mua, ajo që duhej gjithmonë: e njëjta përkulje duke vendosur dorën time të djathtë te buzët dhe balli, e bëra disa herë, në përputhje me numrin e të gjithë atyre që ishin ulur, pastaj u ula pranë Aidit dhe, duke u ulur, bëra të njëjtën gjë përsëri, sigurisht ai u përgjigj me të njëjtën mënyrë.

Fola vetëm unë me mikpritësin, shkurt dhe ngadalë: ky ishte zakoni dhe unë nuk isha shumë i përgatitur për të biseduar arabisht në atë kohë, të tjerët pinin duhan dhe rrinin të heshtur. Ndërkaq, prapa çadrës po përgatitej ushqimi për mua dhe mysafirët.

Zakonisht beduinët hanë hibis, mustaqe misri të ziera në qumësht dhije. Por trajtimi special i mysafirët është harufi, një dash i pjekur duke hapur një gropë në rërë dhe duke djegur shtresa bajgash mbi të. Pas saj dashi shoqërohet me kafe, por gjithmonë pa

sheqer.

Dhe ja, të gjithë u ulën dhe hëngrën sikur nuk kishte ndodhur asgjë, edhe pse në hijen e tendës së shajakut ishte një zagushi e nxehtë skëterrore dhe ishte thjesht e frikshme të shikoje në dyshtemën e hapur gjerësisht: rëra në largësi vezullonte aq shumë sa dukej sikur do të shkrihej para syve tanë. Sheiku më thoshte në çdo fjalë 'havaxha' - im zot, dhe unë i thoja atij shumë i nderuari sheik Bedavi (që do të thotë, biri i shkretëtirës, një beduin.)

Me që ra fjala, e dini si quhet Jordani në arabisht? Shumë thjesht: Sheriat, që do të thotë 'një vrimë në ujë'. Aidi ishte rreth 50 vjeç, jo i gjatë, kockëmadh, shumë i dobët dhe shumë i fortë; fytyrën e kishte ngjyrë tulle të pjekur, sy të tejdukshëm, gri, depërtues; një mjekër ngjyrë bakri me vija gri, të ashpër, të vogël, të pastër dhe mustaqe të rregullta po ashtu – beduinët gjithmonë i rregullojnë të dyja; i veshur si gjithë të tjerët me këpucë të trasha. Kur ishte me mua në Jerusalem, ai mbante një kamë në brez dhe një pushkë të gjatë në dorë.

Mbesën e tij e pashë atë ditë kur isha ulur në çadrën e tij si 'mik': ajo kaloi afër çadrës, me trupin që e mbante drejt, me një teneqe të madhe me ujë mbi kokë, që e mbante me dorën e djathtë. Nuk e di ç'moshë kishte, mendoj se nuk ishte më shumë se tetëmbëdhjetë vjeçe, por më vonë mësova një gjë: ishte martuar katër vjet më parë, dhe po atë vit kishte mbetur vejushë pa fëmijë dhe ishte vendosur te çadra e dajës, duke

qenë jetime dhe shumë e varfër.

“Shiko, shiko, Shulamif!” – mendova. (Mbi të gjitha, Shulamithi ishte sigurisht e ngjashme me të: “Vajza të Jerusalem, unë jam e zezë dhe e bukur.”) Kur e kaloi çadrën, e kthehu kokën lehtë dhe m'i hodhi sytë, ata sy ishin jashtëzakonisht të errët, misteriozë, fytyra e saj pothuaj ish e zezë, buzët lela, të mëdha, atë moment më rrëmbeu me shumicën e tyre...

Sidoqoftë, ajo ishte vetëm! Gjithçka ishte mahnitëse: një dorë e çuditshme, e zhveshur deri te supet, që mbante një bidon teneqeje në kokë, lëvizje të ngadalshme e përdredhëse të trupit nën këmishën e gjatë kuike, gjoks të plotë që e ngrinte këmishën...

Dhe ndodhi që shpejt pas kësaj, e takova në Jerusalem te porta Jaffa. Ajo po ecte nëpër turmë drejt meje dhe këtë herë po mbante diçka të mbështjellë me kanavacë në kokë. Kur më pa, ndaloi. U vërsula drejt saj.

“Më njohe?”

Ajo më goditi lehtë në sup me dorën e majtë që e kishte të lirë dhe qeshi:

“Të njoha, havaxha.”

“Ç'po mban kështu?”

“Kam djathë dhie.”

“Për kë?”

“Për të gjithë.”

“Domethënë shet? Atëherë më sill edhe mua.”

“Ku?”

“Këtu, në hotel. Jetoj te porta Jaffa, një shtëpi e gjatë dhe e ngushtë, e bashkuar me shtëpitë e tjera, por në anën e majtë të atij sheshit të vogël nga i cili del rruga 'Mbreti David', një rrugicë e errët, e mbuluar me kanavacë dhe me një qemer guri të lashtë midis zejtarëve dhe dyqaneve.

Pa u tutur ajo më priu drejt shkallës së ngushtë e të pjerrët prej guri të asaj shtëpie, duke u përkulur lehtë prapa, duke tendosur trupin e saj të përdredhur, duke ekspozuar dorën e saj të djathtë e cila mbante rrotën me djathë në kanavacën e vendosur mbi kokën me një shami kubike, kështu që qimet e saj të zeza ishin të dukshme në sqetull.

Te njëra nga kthesat e shkallëve ajo ndaloi: atje poshtë thellë, prapa dritares së ngushtë mund të shihej pishina e lashtë e Profetit Ezekiel, ujin jeshil i të cilit dukej si pus në sheshin e një shtëpie fqinje me mure të fortë me dritare me kangjella, i njëjti ujë në cilin u la Barsafia, gruaja e Uriahut, dhe e gjeti lakuriq mbreti David.

Duke pushuar ajo vështroi jashtë dritares dhe, duke u rrotulluar, më pa me një surprizë gazmore me sytë lozonjarë. Nuk munda t'i rezistojta puthjes së krahut të saj të zhveshur dhe ajo më pa në mënyrë pyetëse: puthja nuk është pjesë e zakoneve të beduinëve.

Duke hyrë në dhomën time, ajo vuri bohçen në tavolinë dhe shtriu pëllëmbën e dorës së djathtë drejt meje. Vendosa disa monedha të vogla në dorë, pastaj, i ndezuar nga eksitimi, nxora dhe i tregova një stërlinë floriri. Ajo e kuptoi dhe uli qerpikët, përkuli kokën e saj si pohim dhe mbuloi sytë me anën e brendshme të bërrylit...

“Kur do të më sjellësh djathë përsëri?” – e pyeta duke e shoqëruar te shkallët gjysmë ore më vonë.

Ajo tundi kokën ëmbëlsisht:

“Nuk është e mundur shpejt.”

Dhe më tregoi pesë gishtat e dorës: pesë ditë.

Dy javë më vonë, kur po largohesha nga Aidi dhe kisha përshkuar goxha rrugë, një krismë ushtoi pas meje dhe plumbi goditi gurin përpara meje me një forcë të tillë sa që filloi të lëshojë tym. E ngrita kalin galop duke u mbledhur mbi shalë, një e shtënë tjetër u përplas dhe diçka më fshikulloi fort nën gjurin e këmbës së majtë. Vazhdova me galop gjithë rrugës deri në Jerusalem duke parë çizmen që po lëshonte gjak si shkumë... Ende sot çuditim si gaboi Aidi dy herë. Vras mendjen se ku e mori vesh që kisha blerë djathë prej mbesës së tij.

1946

Vjeshta e vitit 1977 la gjurmë te dy të rinj. Një ditë kur dielli po shkëlqente, ata hipën në një autobus rrapëllitës dhe udhëtuan për në një qytet njëzet kilometra larg. Djali bleu biletat, ndërsa vajza u struk pas një shtylle betoni pak larg stacionit. Pluhur dhe gjethe që binin fëfëllinin rreth saj dhe uturima e telave elektrikë mbyste mizërinë e zhurmave në rrugë. Emocionet e vazhës në atë moment ishin aq shterpë sa një faqe në një nga librat e saj shkollore. Ajo hidhte sytë herë pas here te dera e ngushtë e stacionit të autobusit, me një shprehje të patrazuar në fytyrë.

Djali u shfaq, me një çehre të prishur e të zbehtë. Edhe pse e dinte shumë mirë se ku fshihej vajza, ai e shmangu vështirimin nga ajo dhe në vend të kësaj, eci në drejtim të lumit, duke hedhur sytë me nervozizëm majtas-djathtas. Pas pak ai arriti tek ura dhe ngurroi i hutuar përpara se, më në fund, t'i ngulte sytë në drejtim të vazhës. Kur vuri re se ajo po e shikonte, ai i hodhi një vështrim hakërrues, por kjo u duk se nuk pati asnjë efekt. Ai u kthye me neveri dhe qëndroi aty ku ishte, duke e injoruar atë. Por ishte i sigurt që ajo po e shikonte gjatë gjithë kohës dhe ky mendim e alarmoi. Vetëm kur u sigurua që nuk kishte njeri përreth, u kthye.

Ajo nuk e kishte idenë që ai ishte në një gjendje kaq të frikshme mendore; në vend të kësaj, u ndie e prekur nga pamja i djalit të zbehtë që ecte drejt saj në diell. Atë e pushtoi një regëtimë ngazëllimi dhe u shfaq një buzëqeshje në fytyrë. Por kur mbërriti pranë saj, ai ishte bërë tym. “Ende të vjen të qeshësh?” - i foli harbutërisht.

Buzëqeshja e saj e ëmbël u shua që në vezë. Pamja e tij ishte aq e rreptë, sa ajo e pa me ankth, duke shpresuar të sqarohej.

“Sa herë duhet të ta them?” - tha ai. - “Mos më shiko. Bëj sikur nuk më njeh. Pse vazhdon të shikosh? Ti më luan mendsh”.

Ajo nuk kundërshtoi dhe thjesht u kthye prapa. Shikoi te një pirg me gjethe të verdha të vyshkura në tokë dhe dëgjoi teksa tingujt dilyn nga goja e tij.

“Pasi të hipim në autobus, gjej një ndenjësë dhe ulu. Nëse nuk shohim asnjë që njohim, do të ulem pranë teje. Nëse është ndonjë që njohim, do të qëndroj te dera. Mбай mend të mos më flasësh”.

Ai i dha asaj një biletë dhe u largua – përsëri drejt urës, jo te salla e pritjes.

Rreth dhjetë vjet më vonë, vajza – tani në fund të të njëzetave – u ul përballë meje teksa binte muzgu jashtë apartamentit tonë dhe perdet e hapura kornizonin dritën e diellit që po venitej. Po thurte një shall ngjyrëqielli. Shalli ishte më i gjatë se ajo, por vazhdonte ende ta thurte. Isha unë që e kisha shoqëruar vjeshtën e vitit 1977 në atë qytet njëzet kilometra larg. Ishim pesë vjeç kur u takuam për herë të parë dhe kjo njohje, më në fund, na shpuri – pas një procesi të gjatë e rraskapitës – në institucionin e martesës. Ne patëm përvojën e parë seksuale afër fundit të të gjashtëmbëdhjetave dhe shtatzënia e saj e parë ndodhi gjithashtu në atë kohë. Qëndrimi i saj ulur ishte përsëritur pafundësisht për pesë vjet, kështu që si mund të kishte pasion në vështirimin tim kur e shikoja? Për një kohë të gjatë, do të më ndiqte pas kudo që shkoja, dhe kjo më futi në një depresion të thellë. Gabimi im më i madh ishte se në vigjilje të dasmës sonë nuk e kisha kuptuar se gjithë jetën do ta kisha si bisht nga pas, dhe kjo ishte arsyeja pse kisha ngecur në një rutinë të tillë. Tashmë, teksa ajo thurte shallin, mbaja në dorë një letër nga autori Hong Feng. Karriera e tij e shkëlqyer ishte një frymëzim për mua dhe ndjeva se nuk kisha më arsye të vazhdoja një jetë aq bajate sa një gazetë e vjetër.

Kështu, ashtu siç po e riciklonte ajo pozicionin e saj ulur, unë riciklova fjalët që i kisha thënë më parë, duke i përsëdytur se njohja e dikujt në fëmijëri ishte diçka e tmerrshme. “A nuk mendon se kemi krijuar shumë familjaritet?” - e pyeta prapë.

Por ajo vazhdonte të m'i ngulte sytë pakuptueshmërisht.

“Jemi njohur që kur ishim pesë vjeç”, - vazhdova. - “Njëzet e ca vjet më vonë, jemi ende bashkë. Si mundet ndonjëri nga ne të presë nga tjetri që të jetë në gjendje ta frymëzojë për ndonjë ndryshim?”



Në momente të tilla ajo do të dukej gjithmonë e dërrmuar.

“Për mua, me kohë ke qenë si një copë letër e bardhë që mund të lexohet me një shikim. Dhe për ty, a nuk jam njëlloj?”

Kur lotët filluan t'i rridhnin në fytyrë, mendova se dukej thjesht qesharake.

“E vetmja gjë që na mbetet, - vazhdova, - janë kujtimet e së kaluarës, por shumë kujtime e bëjnë të kaluarën tonë të duket si mëngjes – gjithmonë e parashikueshme”.

Përvoja jonë e parë seksuale, siç thashë, ndodhi afër fundit të të gjashtëmbëdhjetave tona. Atë natë pa hënë, ne ishim shtrirë të ngërthyer në një përqaftim në barin e fushës sportive të shkollës, të paralizuar nga frika. Në një rruginë jo shumë larg që aty, njerëzit ecnin me fenerë në duar, zërat e tyre të mprehtë si kama në ajrin e natës, dhe disa herë ishim bërë gati të largoheshim të panikosur. Kur e kujtoj atë skenë sot, e përfytyroj se kjo ndodhi sepse ajo më përqafonte aq fort, sa tani nuk mund ta kuptoj sa patetik mund të kem qenë dukur atëherë.

Sa herë që mendoj për atë natë, ndiej lagështinë e pikave të vesës në bar. Kur ia rrëshqita dorën brenda pantallonave, nxehtësia e trupit të saj më futi të dridhurat. Gishtat e mi u zhytën më thellë, dhe unë fillova të ndiej një lagështirë pikërisht si ajo në bar. Në fillim nuk kisha ndonjë qëllim të veçantë në mendje dhe thjesht doja ta ledhatoja pak. Më vonë ndjeva një dëshirë të fortë për të hedhur një vështrim – doja të dija se si dukeshin gjërat. Por atë natë pa hënë, ajo që nuhata kur u epova më afër ishte thjesht një aromë e lehtë. Aroma që përhapej nga ai vend i errët dhe i lagësht nuk ngjante me asgjë që kisha nuhatur më parë, por nuk ishte as aq ndjellëse sa e kisha imagjinuar. Megjithatë, nuk më ndaloi të vazhdoja përpara dhe ta kryeja atë veprim. Dëshira ishte ngjinjur, për të më lënë veçse të tronditur nga ankthi, dhe në ditët që pasuan mendova për forma të ndryshme vetëvrasjeje ose arratisjeje. Kur shtatzënia filloi t'i binte në sy, dëshpërimi im u bashkua me zemërimin që kisha shijuar vetëm disa minuta lumturi marramendëse. Atë ditë vjeshte të vitit 1977 e shoqërova në atë qytet njëzet kilometra larg me shpresën se gjithçka do të rezultonte të ishte një alarm i rremë.

Frika e saj nuk ishte aq therëse sa imja. Kur i rekomandova të bënte një kontroll, ishte ajo që sugjeroi atë spital të posaçëm dhe qetësia e gjakftohtësia e saj më stepën disi. Mua ajo godinë më joshite thjesht për faktin se përfaqësonte një nivel minimal sigurie që do të na lejonte ta mbanim të fshehtë çështjen. Por ajo vazhdoi të entuziazmohej për vizitën në atë qytet

pesë vjet më parë dhe unë u xhindosa nga përshkrimet për rrugët e tij dhe nga shpjegimet e saj lirike rreth anijes së çarmatosur që ishte ankoruar në breg. Nuk po shkonim atje për t'u argëtuar, i thashë, por për një kontroll të mallkuar, një analizë që do të përcaktonte nëse do të mund të vazhdonim të jetonim apo jo. Nëse analiza vërtetonte se ajo ishte vërtet shtatzënë, thashë, do të na përjashtonin nga shkolla dhe prindërit e secilit nga ne do të na nxirrnin nga shtëpitë. Thashethemet rreth nesh do të përhapeshin si pluhuri që shtillej në rrugë. Në fund nuk do të mbetej gjë tjetër veçse... “Të kryejmë vetëvrasje”.

Ai kërcënim me siguri e shkurajoi atë. Çehrja ime, më tha ajo vite më vonë, ishte mjaft e llahtarshme dhe parashikimi im për të ardhmen tonë të zymtë e tronditi. Por edhe në këtë gjendje të paqetë ajo nuk ishte kurrë vërtet e dëshpëruar. Të paktën prindërit e saj nuk do ta dëbonin nga shtëpia, besonte ajo, edhe pse pajtohej që do ta ndëshkonin. “Ndëshkimi është më mirë sesa vetëvrasje”, - më tha ajo përdëllueshëm.

Atë ditë isha personi i fundit që hipi në autobus. E pashë nga larg teksa ngjitej në autobus, dhe ajo vazhdonte të kthehej e të më shikonte. I kisha thënë të mos vepronte kështu, por paralajmërimet e mia të vazhdueshme kishin rënë në vesh të shurdhër. Autobusi ishte gati duke u nisur kur hipa unë. Nuk u drejtova menjëherë për te ndenjësja pranë saj, por qëndrova te dera, sytë e mi hetonin fytyrat njëren pas tjetrës dhe duhet të kenë qenë të paktën njëzet njerëz që i kisha parë përpara. Kështu që qëndrova i mbërthyer në vendin tim, ndërsa autostrada me gropa luante pambarimisht me autobusin tonë. Ndihesha sikur isha kallur brenda një shisheje që tundej vazhdimisht. Më vonë e dëgjova atë të më thërriste – një zë që më kalli frikën. I indinjuar nga mungesa e taktit, e injorova vendosmërisht, duke shpresuar se do ta qepte gojën. Por, pavarësisht kësaj, përpjekjet e saj të lodhshme për të më tërhequr vëmendjen vazhduan. Gjithçka që mund të bëja ishte të ktheja kokën në anën tjetër, duke e ditur që ngërdheshja ime duhej të ishte po aq e shëmtuar sa shkurret e dendura anës rrugës.

Por fytyra e saj ishte e tejmbushur me naivitete teksa hiqej sikur ishte e habitur që kishte rastisur që ne të dy të merrnim të njëjtin autobus. Kur më ftoi të ulesha në ndenjësën boshe pranë saj, nuk kisha zgjidhje tjetër veçse të bindesha. Sapo u ula ndjeva trupin e saj të ngjishej pas meje. Ajo kishte shumë për të thënë, por unë nuk ia vura veshin fare dhe m'u desh të vazhdoja të pohoja me kokë për të dhënë përshtypjen që

po e ndiqja çfarë po thoshte. E gjithë kjo më pezmatoi dhe kur ajo qetësisht e mblodhi dorën rreth gishtave të mi, ia shtyva tutje. Më marrosi fakti që vazhdonte ende kështu. Vetëm atëherë e kuptoi sa i xhindosur isha. Ajo ndaloi së foluri dhe natyrisht, hoqi dorë edhe nga përpjekjet për kontakt fizik. U kthye në anën tjetër, duke u ndier si e keqtrajtuar dhe filloi të vëzhgonte peizazhin e zhveshur. Por nuk heshti për shumë gjatë, sepse kur autobusi u drodh teksa kaloi mbi një gungë, ajo ia dha një të kakarisure dhe më mërmëriti te veshi: “Bebushi e ndjeu këtë.”

Shakaja e saj vetëm më nxiti edhe më shumë. “Mbylle gojën”, - murmurita, me dhëmbët shtrënguar.

Më vonë pashë një radhë anijesh të ankoruara në breg. Dy prej tyre ishin çmontuar dhe dukeshin si guaska të mjerueshme dhe vetëm njëra ishte e pacenuar dhe e padëmtuar. Disa zogj gri luhateshin mbi algat e detit në breg.

Sapo autobusi mbërriti në stacion, dy të rinjtë dolën jashtë. Trupat e tyre u mbuluan nga pluhuri që ngriti një kamion kur kaloi aty.

Djali, i irnuar, bënte përpara pa thënë një fjalë. Vajza e ndiqte nga pas, duke ia hedhur sytë me frikë profilit të tij. Në vend që të drejtohej direkt për në spital, djali u kthye në një rruginë dhe vajza bëri të njëjtën gjë. Ai nuk ndaloi deri në gjysmë të rrugës. Atje ata panë një mesogrua teksa afrohej dhe pastaj doli në rrugë.

“Pse më thirrë?” - ulëriti djali.

Vajza, e lënduar, e shikoi. “Kisha frikë se do të lodheshe duke qëndruar gjatë gjithë rrugës në këmbë”.

“Sa herë të kam thënë: mos më shiko!” - briti ai. - “Por ti vazhdoje të më shikoje, të më thërrisje në emër dhe të më shtrëngoje dorën”.

Dy burra iu qasën nga fundi i rruginës. Djali nuk tha më asgjë dhe vajza s'bëri asnjë përpjekje për të mbrojtur veten. Burrat i shikuan me kureshtje teksa kalonin. Djali u nis drejt fundit të rruginës dhe pasi ngurroi paksa, vajza e ndoqi pas.

Ata ecën në heshtje përgjatë rrugës. Edhe pse nuk ishte më i mllëfosur, djali dukej gjithnjë e më nervoz teksa i afroheshin spitalit. Ai i hodhi një vështrim vazhës, e cila tashmë po shikonte drejt përpara dhe nga shprehja e hezitimit në sytë e saj kuptoi që spitali duhej të ishte shumë afër.

Ata arritën në hollin e spitalit, ku gjetën zyrën boshe dhe shkretane të regjistrimit. Djalit tashmë e lëshuan nervat aq keq, sa marshoi jashtë drejt e në oborr. I mbërthyer nga frika se mund të mbahej për t'u marrë në pyetje, ai thjesht nuk ishte i përgatitur të rrezikonte. Asaj do t'i duhej të përballlej e vetme me rreziqet, tek e la atë të lirë t'ia mbathte. Në momentin që vajza iu bashkua, ai ia kishte dalë të fshihte dobësitë e tij. Do të ishte shumë e rrezikshme për atë të qëndronte me të, tha ia: njerëzit e tjerë do të ishin në gjendje të kuptonin në çast se çfarë kishin bërë ata. “Shko më mirë vetëm”, - i tha asaj.

Ajo nuk kundërshtoi dhe pasi i dha një nojmë, u kthye brenda. Ai e pa teksa u ngjit te sporteli i zyrës së regjistrimit dhe kur nxori paratë nga xhepi, ajo nuk tregoi ndonjë stres të dukshëm. Ai e dëgjoi teksa po jepte emrin dhe moshën – të dyja ishin të rreme. Këto bishtnime nuk ishin gjëra që ai i kishte planifikuar më parë.

“Gjinekologjia”, - e dëgjoi të thoshte.

Kjo fjalë e bëri të rrëqethej. Ai pikasi një lodhje në zërin e saj. Teksa largohej nga sporteli, ajo u kthye ta shihte dhe kartela mjekësore i fërgëllonte në dorë ndërsa ngjiste shkallët.

Djali e vëzhgoi derisa silueta e saj u zhduk shkallëve; vetëm atëherë e ktheu vështrimin gjatë. Ai ndjeu se po i prishej humori dhe po i vështirësohej frymëmarrja. Tek po priste, shikonte i shpërqendruar njerëzit në rrugë, pastaj u hodhi një sy pacientëve teksa zbrisnin shkallët. Ende asnjë shenjë prej saj. E kaploi tmerri, një frikë se sekreti i tij po zbulohej atje sipër. Ky mendim iu bë gjithnjë e më real, derisa nuk

(Vijon në faqen 23)

Ilustrimi i librave ka ekzistuar në një formë a një tjetër që nga lindja e fjalës së shkruar. Tradita që ka formësuar ilustrimin modern të librave e ka origjinën në letërsinë perëndimore dhe daton që nga librat me bllok të shekullit XV, ku teksti i një libri gdhendej në të njëjtin bllok me figurën. Këto vepra ishin një hapje e natyrshme nga format më të vjetra të dorëshkrimeve të ndriçuara. Siç shihet më së shumti në *Biblia Pauperum* (“Bibla e të varfërve”), ato i ngjanin disi romaneve grafike mesjetare.

Më konkretisht, praktika e botimit të letërsisë për të rritur të shoqëruar me imazhe përfaqësuese lidhet ngushtë me letërsinë perëndimore dhe shekujve XVIII dhe XIX, dhe me ngritjen e romanit si formë letrare. Me rastin e dyqindvjetorit të lindjes së Charles Dickens-it, Melanie McDonagh shkruante në *The Independent* për marrëdhënien e tij të ngushtë bashkëpunuese me ilustruesit: “...ai u jepte atyre një përmbledhje të ngjarjes përpara se të shkruante tekstin dhe i mbikëqyrte vizatimet për t’u siguruar se përputheshin saktësisht me përfytyrimet e tij.” Ilustruesi më i njohur i Dickens-it, H.K. Browne (me emrin letrar “Phiz”), punonte nën udhëzimet e drejtpërdrejta të autorit për paraqitjen e saktë të personazheve dhe kompozimin e ilustrimeve. Kjo bënte që interpretimi vizual i një personazhi nga Phiz të bëhej po aq i rëndësishëm sa përshtkrimi i Dickens-it – në mos edhe më shumë.

Sigurisht, tendencat si në botimin e librave ashtu edhe në artin pamor ndryshuan ndjeshëm gjatë shekullit XX. Praktika e shoqërimit të letërsisë për të rritur me përfaqësime vizuale pësoi rënie të theksuar, dhe ilustrimi i librave u lidh gjithnjë e më shumë me letërsinë për fëmijë dhe me shkrimet “të ulëta” ose popullore (siç ishte rasti me *Classics Illustrated*). Në të njëjtën kohë, edhe arti figurativ u shmang në botën e artit si i vjetruar dhe tabu. Duchamp-i deklaroi se arti nuk duhet të jetë vetëm retinale, ekzistues vetëm për qëllime estetike dhe kënaqësi pamore, dhe se Manet shënonte kulmin dhe fundin e artit retinak. Hapi i qartë pasues ishte abstraksioni, Dada-ja dhe “vdekja e pikturës.” Por, sigurisht, piktura nuk vdiq kurrë vërtet, dhe një ringjallje e fuqishme e pikturës figurative/përfaqësuese shënoi fundin e shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI.

Ndërsa gjatë mesit të shekullit XX u bë gjithnjë e më e rrallë të gjeje ilustrime që shoqëronin veprat e reja të letërsisë artistike, ilustrimi i librave vazhdoi të evoluonte në forma më pak tradicionale – dhe shpesh më pak të respektuara. Kjo zhvillim mund të shihet qartë në ilustrimet mbresëlënëse dhe të përpunuara me mjeshtëri të Virgil Finlay-t, të realizuara me bojë në revistat “low-brow” të zhanrit sci-fi, për tregime me tituj si *Pushtimi i Hënës së Qelbur* (*The Conquest of the Moon Pool*). Këto punë, plot gjallëri dhe detaj, sjellin në kujtesë gdhendjet e Gustave Doré-së për Danten dhe Miltonin, apo ilustrimet e Harry Clarke për Poe-n.

Në artikullin e McDonagh, botuesi i shtëpisë botuese *Jonathan Cape*, Dan Franklin, i referohet këtyre ndryshimeve në botimin e librave për të rritur dhe përmend mungesën e ilustruesve të mëdhenj si një nga arsytet e rënies së ilustrimit në libra. Komentet e Franklin (“Është e rrallë të gjeshe dikë që di të vizatojë”) pasqyrojnë një qasje tradicionale ndaj ilustrimit të librave, si një formë arti e detajuar në gravurë, që mbizotëronte në shekujt XVIII dhe XIX dhe që kërkonte një mjeshtëri shumë të veçantë të materialeve.

Por kurrë nuk ka pasur mungesë artistësh të zotë për të krijuar ilustrime librash – përkundrazi, ka pasur mungesë

Një histori e shkurtër e ilustrimit të librave

Nga Chris Russell

Përktheu Jola Tasellari

kërkese për ilustrimin tradicional në letërsinë artistike për të rritur. Gjatë gjithë shekullit XX, ekzistojnë me qindra shembuj të ilustruesve të talentuar me aftësi të shkëlqyera në vizatim, sidomos në zhanrin e letërsisë për fëmijë: Chris van Allsburg, David Wiesner, Alenka Sotter, për të përmendur vetëm disa. Letërsia e njohur për fëmijë ofron disa nga shembujt më novatorë dhe mjeshtërorë të ilustrimit të librave në shekullin XX, dhe këto vepra pa dyshim kanë ndikuar breza të tërë artistësh bashkëkohorë.

Kalimi i romaneve grafike nga bota e revistave të lira popullore (“comics”) në sferën e artit dhe letërsisë së respektuar ka ndryshuar ndjeshëm fushën e ilustrimit letrar gjatë 20 viteve të fundit. Kontributi i jashtëzakonshëm i Art Spiegelman-it, si në veprën e tij personale, ashtu edhe në mbështetjen e formës së artit në përgjithësi, ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë transformim. Projekti i tij *WORDLESS!* – një bashkëpunim me muzikantin Philip Johnston, i paraqitur në BAM (Brooklyn Academy of Music) në fillim të vitit 2014 – ofroi një udhëtim nëpër historinë më pak të njohur të tregimit grafik. *LA Times* shkroi:

“Art Spiegelman pothuajse i vetëm i ka nxjerrë librat komikë nga dollapi i lodrave dhe i ka vendosur në raftet e letërsisë.”

Nga ana stilistike, megjithatë, një pjesë e madhe dhe e veprave grafike më novatore të ditëve të sotme mund të futen lehtësisht në kategorinë e “karikaturave”. Kjo nuk do të thotë që atyre u mungon vlera e vërtetë artistike, por se forma e romanit grafik mbetet ende e lidhur ngushtë me traditën e vizatimit të karikaturës dhe artit të librave komikë, ku narrativa shpesh vjen përpara mjeshtërisë në vizatim. Sigurisht, ka shumë përjashtime nga kjo përgjithësim – puna e Joe Sacco-s apo Anders Nilsen-it, për shembull – por ato janë pikërisht kaq: përjashtime.

Nga ana tjetër, do të ishte gjithashtu një gabim të mendohej se mungesa e detajit të imët apo e ilustrimit në stilin e gravurës tradicionale është tregues i një vizatimi të dobët. Vepra si *Persepolis* e Marjane Satrapi-t (Pantheon) paraqesin një grafikë gjoja të thjeshtë; por puna e saj me bojë të zezë të trasha është një maskë e hollë që fsheh një ndjeshmëri të jashtëzakonshme ndaj lëvizjes dhe karakterit emocional.

Botimi letrar bashkëkohor po bëhet



Biblia pauperum (latinisht për “Bibla e të varfërve”) ishte një traditë e Biblave të ilustruara me figura, që mendohet të ketë nisur ndoshta me Ansgarin, dhe që u bë një formë e zakonshme e librit me blloqe të shtypur në Mesjetën e Vonë, për të vizualizuar përputhjet tipologjike mes Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re. Kjo traditë përfaqëson një thjeshtim të mëtejshëm të Bible moralisée, e cila ishte e ngjashme por më e gjatë dhe më tekstuale. Si ajo, edhe Biblia pauperum zakonisht ishte në gjuhën popullore lokale dhe jo në latinisht.

gjithnjë e më i hapur ndaj formave grafike novatore, siç shihet në romanet grafike të shtëpisë botuese *Pantheon*, si *Building Stories* e Chris Ware dhe *Here* e Richard McGuire. Më së fundmi, *Drawing Blood* nga Molly Crabapple (Harper Collins) paraqet një martesë të veçantë ndërmjet gazetarisë narrative/memuaristikës dhe ilustrimit të realizuar me mjeshtëri në teknikë të përzier. Vepra e Crabapple-s – si në stil ashtu edhe në qasjen ndaj gazetarisë – sjell ndër mend një tjetër përjashtim të madh nga mungesa e ilustrimit letrar në gjysmën e dytë të shekullit XX: ilustrimet e Ralph Steadman-it për Hunter S. Thompson.

Pavarësisht pranisë së shtuar të formave grafike eksperimentale në botimin letrar, përfshirja e artit pamor brenda teksteve letrare mbetet zakonisht e kufizuar në botimet e reja të veprave klasike – ose të paktën të atyre që janë tashmë pjesë e kanonit letrar. *The Folio Society* boton edicione të mrekullueshme të një vargu të tillë librash, që nga *Tregimet e Njëmijë e Një Netëve* deri te *Ndërsa po jepja shpirt* (*As I Lay Dying*) dhe *Fëmijët e Mesnatës* (*Midnight's Children*), të gjitha të shoqëruara me ilustrime të reja nga artistë bashkëkohorë.

Ndërkohë, *Scout Books*, një shtypshkronjë e vogël fletorësh me qendër në Portland, Oregon, ka një seri tregimesh klasike në formë xhepi, të shoqëruara me ilustrime të reja – si për shembull ilustrimet fantastike në stil komik të François Vigneault për tregimin e Ambrose Bierce-it *Një ndodhi në urën Owl Creek* (*An Occurrence at Owl Creek Bridge*).

Ka përjashtime të herëpashershme, si romani i periudhës me stil novator i Lawrence Norfolk, *John Saturnall's Feast* (Grove Press), i cili përfshin ilustrime të bukura në teknikën e gdhendjes në dru nga Andrew Davidson, të vendosura në një format klasik “bookplate”, të përshtatshëm për kohën e vendosjes së ngjarjeve në shekullin XVII. Por edhe këto ilustrime tradicionale – megjithëse përjashtime – janë të “sigurta” në kontekstin e fiksionit historik.

Pra, pse letërsia bashkëkohore për të rritur nuk shoqërohet më shpesh me ilustrime novatore?

Kjo pyetje mbetet në qendër të një debati estetik dhe tregtar: nga njëra anë, vazhdon të ekzistojë një ndarje kulturore midis artit “serioz” letrar dhe vizualitetit grafik, që shpesh shihet si jo i denjë për tekstet “elitare”. Nga ana tjetër, vetë industria e botimeve – përballë kostove të larta dhe rrezikut financiar – heziton të eksperimentojë me formate që perceptohen si “të pazakonta” për tregun e letërsisë për të rritur. Mungesa e traditës bashkëkohore dhe pritshmëria për një “seriozitet” formal gjithashtu luajnë rol në këtë shmangie të vazhdueshme.

Përgjigjja më e dukshme është se si shkrimtarët ashtu edhe botuesit kanë frikë se ilustrimet mund të dëmtojnë aftësinë e lexuesit për t’u përfshirë me librin. Kjo është një frikë që Dickens-i e kuptonte shumë mirë dhe ndaj së cilës ishte jashtëzakonisht i kujdesshëm, duke mbajtur një kontroll të rreptë mbi ilustruesit e tij. Ky rezik bëhet veçanërisht i ndjeshëm kur teksti i bashkëngjiten imazhe përfaqësuese të personazheve të një tregimi. Disa vepra letrare mund të bëhen të pandashme nga imazhet e tyre – mjafton të kujtojmë pikturat e gjalla të N.C. Wyeth për *Ishullin e Thesarit*.

Siç shkruante Sam Sachs në një artikull për *The New Yorker* në vitin 2013: “Ndoshta nuk kemi nevojë për ilustrime të personazheve në *Housekeeping* të Marilynne Robinson, pasi fuqia e këtij libri lidhet me muzikën e gjuhës. Por a nuk do të ishte leximi i *Gravity's Rainbow* të Pynchon-it edhe më i kënaqshëm, nëse do

të kishim një portret fantastik të Tyrone Slothrop-it duke luftuar një oktapod gjigand me një shishe vere bosh?”

Shfaqja e librave elektronikë dhe botimit dixhital ka rizgjuar te bibliofilët interesin për librin si një objekt fizik bukurie. Vendosja përballë e ilustrimit dhe tekstit letrar, si dhe bashkëpunimet novatore mes artistëve dhe shkrimtarëve, ndodhin edhe sot – më shpesh në libra të prodhuar me mjeshtëri, që vetë janë “objekte të bukurisë” të prekshme. Seria *Cahier* nga *Sylph Editions* është një shembull model i kësaj qasjeje; siç thuhet në faqen e tyre zyrtare: “Theksi vihet mbi vepra në të cilat imazhi dhe teksti bashkëjetojnë, të konceptuara si një i vetëm. Çdo vepër prodhohet me përpikëri, me të njëjtën kujdesje ndaj përmbytjes dhe ndaj formës.”

Ilustrimet surrealistike në teknikë të përzier të Bianca Stone që shoqërojnë *Antigonick* të Anne Carson (New Directions) e dëshmojnë qartazi se bashkëvendosja e ilustrimit pranë një vepre letrare – dhe bashkëpunimi mes artistit dhe autorit – mund të realizohet ende në mënyrë të freskët dhe bashkëkohore, me ilustrim modern që përputhet me gjuhën dhe shpirtin e tekstit.

E ardhmja e ilustrimit të librave është ndoshta më e hapur ndaj interpretimit dhe eksperimentimit se kurrë më parë, me hapësirë të bollshme për risitë nga botuesit – veçanërisht kur e kuptojmë se bashkëpunimi midis shkrimtarëve dhe artistëve nuk është i lidhur domosdoshmërisht me formatin tradicional. Si gjithnjë, megjithatë, konsiderata më e rëndësishme për ilustrimin bashkëkohor të librave mbetet ndoshta e njëjta që ka udhëhequr shembujt klasikë: vepra artistike duhet të shtojë diçka ndaj tekstit – jo ta ngatërrojë, ta komplikojë apo ta shpërqendrojë.

Për një artist, përvoja unike e krijimit të veprës në funksion të vizionit të dikujt tjetër është një ushtrim përulësie. Në shoqërinë bashkëkohore perëndimore, arti zakonisht shihet si një shprehje e vetme e individit – gjë që natyrshëm mund të marrë përmasa egoiste apo vetëqendrore.

Nga përvoja ime personale si ilustrues, gjithmonë më ka pëlqyer të përfshihej në vizionin e dikujt tjetër dhe sfida për t’i bërë drejtësi atij vizioni. Gjashtëmbëdhjetë ilustrimet me bojë të zezë që shfaqen në botimin në format paperback të *Aquarium* nga David Vann (Grove Press) janë përshtatur nga fotografitë me ngjyra që shoqëronin tekstin në edicionin e parë me kapak të fortë. Fotografitë origjinale në ngjyra ishin shumë të detajuara dhe përfshinin sfondin natyror të oqeanit përreth secilit peshk.

Por për mua, kjo nuk ishte një proces i thatë i riprodhimit të një imazhi nga një fotografi – ishte një mundësi për të eksperimentuar me vijën, teksturën dhe kompozimin. Vendosa që këto “portrete” të peshqe do të dukeshin më pak të ngarkuara pa sfondin e plotë, dhe sfida më e madhe ishte të përcaktoja se sa duhej të përfshija. Ilustrimi i vetëm nga të gjashtëmbëdhjetët që përmban të gjithë sfondin është ai i peshkut-kloun, sepse ndjeva se ai do të ishte i paplotë pa anemonet (shih imazhin kryesor më sipër).

Fillimisht, kisha ndër mend të realizoja ilustrimet duke përdorur teknikën e *scratchboard*-it, për t’u dhënë vizatimeve një cilësi të zymtë, pothuajse si ilustrimet shkencore. Por detajet e shumta në të bardhë dhe sasia e madhe e bojës së zezë në sfond do të ishte e pamundur



Harry Clarke, ilustratim për librin e Edgar Poe (1923)

të riprodhoheshin në mënyrë efektive në një botim në paperback. Prandaj kalova te boja e zezë dhe pena, çka më lejoi një ndjesi më spontane dhe më gjestuale. *Chris Russell, ilustrim origjinal në scratchboard (mola mola) për *Aquarium*

Kjo ishte një fushë ku, në nivel praktik të prodhimit, duhej të isha fleksibël në qasjen time ndaj ilustrimeve. Në varësi të nevojave specifike të librit, apo udhëzimeve nga autori dhe ekipi botues, një ilustrues ka një gamë të gjerë kontributesh krijuese. Kjo, për mua, është pjesa më interesante dhe sfiduese e gjithë procesit: të përcaktosh se çfarë është e hapur ndaj interpretimit dhe eksperimentimit dhe çfarë kërkohet saktësisht për t’ia përshtatur artin tekstit.

Edhe pse vizatimet për *Aquarium* ishin në njëfarë mënyre shumë të drejtpërdrejta, për mua elementi krijues buronte nga vetë mediumi – ndjesia e bojës, dhe zgjedhjet e vogla të gjestit. Duke iu nënshtruar rolit tradicional të ilustruesit të librave, në një format po ashtu tradicional siç është ilustrimi në stilin *bookplate*, arrita të gjej një mënyrë për të aplikuar format, idetë dhe stilin tim personal.

Mund të shpresoj vetëm që kjo lloj përvoje bashkëpunuese të bëhet gjithnjë e më i zakonshëm për kolegët e mi ilustrues, ndërsa botuesit letrarë vijnë në zgjerimin e tyre për atë që është e mundur për librin si objekt...

(Vijon nga faqja 21)

mundi të qëndronte as edhe një çast më shumë në spital. Kaloi rrugën dhe pa e ndalur hapin kur arriti në anën tjetër, vazhdoi drejt një dyqani.

Aty shiteshin pajisje shtëpiake esenciale dhe prapa banakut qëndronte një grua e re lapangjoze, me një çehre të lodhur. Në cepin tjetër dy burra po prisnin fletë qelqi. Ai u afrua të shihte, njëkohësisht duke hedhur herë pas here një vështrim nga spitali matanë rrugës. Burrat tymosnin teksa punonin dhe pirgje të vogla hiri ishin grumbulluar mbi xhamin e gjelbër të errët. Fytyrat e tyre pa shprehje e ngrysën edhe më shumë atë. Teksa maja prej diamanti e pajisjes prerëse rrëshqiti mbi xham, u shfaq një gërvishtje e bardhë dhe një zhurmë çjerrëse tingëlloi në veshët e tij.

Pas pak vajza u shfaq në rrugën përballë. Ajo qëndronte pranë një rrapi, e përhumbur. Ai e pa kalimthi përmes vitrinës së pluhurosur të dyqanit dhe nuk doli jashtë derisa vërtetoi se atë nuk po e ndiqte njeri. Ajo e pa tek kalonte rrugën dhe i dha një buzëqeshje të trishtuar ndërsa ai iu afrua.

“Jam shtatzënë”, - tha ajo qetësisht.

Djali mbeti si pemë. Shpresa e madhe që ai kishte ushqyer tashmë ishte shkërmoqur plotësisht. Ai e shikoi vajzën e pikëlluar. “Çfarë do të bëjmë?”

“Nuk e di”, - murmuriti ajo.

“Çfarë të bëjmë?” - përsëdyti ai.

“Le të mos mendojmë për këtë”, - tha ajo përdëllueshëm. - “Le të hedhim një sy nëpër dyqanë”.

Ai tundi kokën. “Nuk ma ka ëndja”.

Ajo nuk tha asgjë dhe thjesht shikoi qarkullimin rrugor që lëvizte lart e poshtë nëpër rrugë. Njerëzit vinin në drejtim të tyre në trotuar, duke qeshur me të madhe. Pasi ata kaluan, ajo e provoi sërish. “Le të hedhim një sy nëpër dyqanë”.

“Nuk dua”, - përsëriti ai.

Ata qëndruan atje për ca kohë dhe më në fund, djali tha mefshtas: “Le të kthehemi.”

Vajza pohoi me kokë.

Kështu ata u kthyen nga rruga që kishin ardhur. Përpara se të shkonin shumë larg, vajza ndaloi para një vitrine. Ajo e tërhoqi djalin për mënge. “Le të hedhim një sy në këtë dyqan”, - tha.

Pasi ngurroi pak, djali hyri me të. Ata qëndruan për njëfarë kohe përpara një fundi të bardhë dakroni. Vajza nuk mund t’ia shqiste sytë. “Më pëlqen shumë ky fund”, - i tha djalit.

Zëri i saj tanimë kishte hedhur rrënjë kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeçe. Gjatë rreth dhjetë viteve që pasuan, zëri i saj do të më mbetej në vesh pothuajse çdo ditë, dhe ky tingull i stërnjohur kishte gërryer gjithë pasionin tim. Dhe kështu, teksa mugëtira binte dhe unë vështroja gruan time e cila ishte ulur përballë meje, ndihesha gjithnjë e më i lëshuar. Ajo ende po thurte shallin ngjyrëqielli dhe fytyra e saj ishte e njëjta fytyrë e njëhershme, përveçqë kishte humbur disi elasticitetin. Rudhat e saj ishin thelluar nën shikimet e mia dhe tashmë i njihja në pëllëmbë të dorës. Ajo kishte filluar të mbante vesh.

“E kuptoj se çfarë do të thuash, madje pa e hapur gojën. Në orën njëmbëdhjetë e gjysmë çdo mëngjes dhe në orën pesë çdo pasdite e di që do të jesh në shtëpi së shpejti. Në një turmë prej njëqind grash, mund t’i njoh sakaq hapat e tu. Dhe sa të përket ty, a nuk jam edhe unë po aq i parashikueshëm?”

Ajo ndaloi së thururi dhe më shikoi mendueshëm.

“Kështu që asnjëri nga ne nuk mund ta surprizojë tjetrin”, - vazhdova unë. - “E gjitha që mund të bëjmë është që t’i falim njëri-tjetrit pak kënaqësi, por atë lloj kënaqësie që është e arritshme kudo në qytet”.

Tani ajo filloi të fliste. “E kuptoj çfarë po thua”.

“Je e sigurt?” Nuk dija si t’i përgjigjesha, kështu që kjo ishte e gjitha që më erdhi të thosha.

“E kuptoj”, - përsëdyti. Lotët filluan t’i shkisnin në fytyrë. “Do të më lësh”, - tha ajo.

Nuk u përpoqa ta mohoja. “Kjo ngjan shumë e papjekur”, - ishte e gjitha që thashë.

“Do të më lësh”, - tha ajo përsëri. Më shumë lot.

“Nuk është mënyra e duhur për ta thënë”, - thashë unë. - “Le të mendojmë për të gjitha gjërat që kemi bërë së bashku”.

“A është kjo hera e fundit?” - pyeti ajo.

I bëra bisht pyetjes. “Nga të fillojmë?” - vazhdova.

“A është kjo hera e fundit?” - përsëdyti ajo.

“Si thua t’ia fillojmë nga ajo vjeshtë, në vitin 1977?” - thashë unë. - “Ne morëm atë autobus rrapëllitës gjatë gjithë atyre njëzet kilometrave për të zbuluar nëse ishte shtatzënë. Çfarë rrëzalli isha atë ditë!”

“Jo, nuk ishte”, - tha ajo.

“Mos u përpiq të më bësh të ndihem më mirë. Isha vërtet një rrëzall”.

“Jo, nuk ishte”, - përsëriti ajo. - “Gjatë gjithë kohës që të kam njohur, vetëm një herë je treguar rrëzall”.

“Kur ka ndodhur kjo?”

“Tani”.



Hablot K. Brown, ilustrim për David Copperfield, 1850

Së shpejti!

